Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 4 (84). PRILL 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

AURORA GROUP
PROJEKTIM - ZBATIM
koha kalon, cilësia mbetet
Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

PROPOZIMI

Viti i madh i trimërisë dibrane

Nga **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 7

BOTIME

Përqasje kritike për librin "Trokitje në portat e Dibrës"

Nga **MENTOR HOXHA** - FAQE 12

HISTORI

'Historia e Dibrës', një kontribut polivlerash

Nga **FAIK XHANI** - FAQE 18

PORTRET

Prof.dr. Veli Zogu, një histori suksesi...

Nga **HYSEN LIKDISHA** - FAQE 16

2000 qytetarë firmosin:

Duam Rrugën e Arbërit shpejt dhe me standarde

Personalitete nga fusha e artit, kulturës, shkencës, ekonomisë, medies, politikës e kanë firmosur peticionin, duke dëshmuar kështu se kjo çështje është shumë e rëndësishme për zhvillimin e vendit.



Ishte shumë e lehtë të firmosnin 2000 të parët, por tani është shumë më e lehtë që numri të rritet. Së bashku do ta kemi më të lehtë ta rrisim numrin e nënshkruesve. Sepse nuk bëhet fjalë për çështje personale, por për një çështje kombëtare, për një çështje që na përket të gjithëve. Bëhet fjalë për zhvillimin e vendit dhe integrimin e rajonit. Nuk bëhet fjalë për të sotmen dhe as për të shkuarën. Por për të ardhmen e fëmijëve tanë në një vend të zhvilluar dhe europian. Rruga do t'i sjellë vendit një ritëm zhvillimi të padëgjuar më parë dhe vetëm atëherë do kujtohemi se sa e vlefshme ishte firma jonë sot.

Mbi 2000 qytetare kanë firmosur peticionin, i cili do qëndrojë i hapur në faqen Change.org deri në zgjidhjen përfundimtare të ndërtimit të Rrugës së Arbërit. Përvec online, e kanë firmosur peticionin edhe qindra qytetarë. Formulari printohet nga faqja në internet e gazetës dhe sillet me postë në redaksi.

cyan magenta yellow black 1

Njerëz të fusha e artit, kulturës, shkencës, ekonomisë, medies, politikës e kanë firmosur peticionin, duke dëshmuar kështu se kjo çështje është shumë e rëndësishme për zhvillimin e vendit.

RRUGA E ARBËRIT: Vazhdon nënshkrimi

Mbi 2000 qytetare kanë firmosur peticionin, i cili do qëndrojë i hapur në faqen Change.org deri në zgjidhjen përfundimtare të ndërtimit të Rrugës së Arbërit. Përvec online, e kanë firmosur peticionin edhe qindra qytetarë. Formulari printohet nga faqja në internet e gazetës dhe sillet me postë në redaksi.

Megjithëse fushata elektorale po afron dhe qeveria dhe partitë politike po e rikthejnë edhe njëherë çështjen e Rrugës së Arbërit në debat të ditës, mbi 2000 qytetarë e kanë firmosur peticionin dhe të tjerë e kanë nënshkruar atë në letër, duke treguar se kjo çështje është e ndjeshme për opinionin publik dhe sidomos për qytetarët e Dibrës, Burrelit, Tiranës dhe shqiptarëve të Maqedonisë.

Peticioni, i cili ka filluar të firmoset që prej 18 marsit 2013, me nismën e profesorit të Universitetit të Birmingamit, dibranit Gëzim Alpion, në faqen e internetit "Change.org", ka ngjallur interes edhe për mediet jashtë dhe brenda vendit, duke e bërë që peticioni të ketë një mbulim mediatik ndërkombëtar.

Një numër gazetash, revistash dhe stacionesh televizive e kanë përkrahur dhe përcjellë peticionin në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe diasporë: Londër, New York, Athinë, Romë, Bukuresht dhe Toronto.

"Gazeta Ditore" në Kosovë, gazeta "Dielli" në Amerikë, gazeta "Rrënjët" në Romë, revista "Java" në Tiranë, gazetat "Shekulli", "Panorama", "Gazeta Shqiptare", "Nacional Albania" dhe një numër mediesh online në Tiranë dhe diasporë si *fjalaelire.com, voal-online.ch, thealbanian.co.uk, hermesnews.org, 77news.al, fjala.info, di-tv.com* etj., e kanë përcjellë me shumë seriozitet lajmin, duke u bërë thirrje njëkohësisht lexuesve dhe shikuesve të tyre që ta nënshkruajnë atë.

Gjithashtu, këto dy muaj, qindra faqe në rrjetet sociale, si në *Facebook, Twitter, Linkedin* etj, i kanë bërë jehonë peticionit, duke e shoqëruar edhe me komentet pozitive për avantazhet ekonomike dhe sociale që sjell përfundimi sa më shpejt i saj. Faqja në FB *'Peshkopi, Diber, Albania', 'Dibra TV'* dhe qindra faqe personale te qytetarëve të ndryshëm, kanë bërë thirrje publike herë pas here për ta nënshkruar peticionin. Statuset dhe profilet e tyre janë mbushur me pamje nga peticioni, duke dëshmuar kështu se shpresa dhe besimi se rruga do të përfundojë sa më shpejt, është akoma e gjallë.

Paralelisht me nënshkrimet kanë filluar edhe firmosja e peticionit me dorë nga qytetarë të zakonshëm, mbështetës të rrugës, brenda vendit dhe jashtë. Në redaksi kanë ardhur formularët e parë të firmosur nga Tirana dhe dhjetëra miq kanë konfirmuar se janë plotësuar, firmat e të cilëve vazhdojnë të firmosen nga qytetarë të ndryshëm që nuk kanë mundësi të kenë hyrje në internet.

Në këtë formular janë dhënë të gjitha udhëzimet për mënyrën se si mund ta bëjë çdokush këtë kontribut të vogël, jo vetëm për Dibrën, duke i dhënë një mbështetje masive dhe duke synuar që qeveria që do të dalë pas zgjedhjeve të qershorit, ta shikoje me arsyen ekonomike dhe sociale, domosdoshmërinë e ndërtimit sa më parë të rrugës.



Pamje nga faqja e parë në FB e 'Peshkopi, Diber, Albania'

KUSH E KA FIRMOSUR?

Peticionin online e kanë firmosur qytetarë të zakonshëm, kryesisht që e ndjekin vendlindjen nëpërmjet "lajmeve" që sjell interneti, por edhe personalitete të fushave të ndryshme të artit, kulturës, shkencës, ekonomisë, politikanë etj.

"Jam 21 vjeç dhe kam të paktën që kur isha 9 vjeç që e dëgjoj dhe stërdëgjoj si çështje, por aha pa rezultat. Me herët duhet të jetë folur patjetër po nuk mbaj mend, dhe këtë e mbaj mend sepse në 9-vjetorin tim dëgjoja që shpërngulja në Tiranë po vinte sepse "Ato nuk kanë ndërmend ta bëjnë rrugën e Arbërit", dhe mesa duket të drejte paska pasur babai im që e thoshte gjithnjë. Në fakt, ku do kish më bukur sesa realizimi i një vepre të tillë me përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare. Sa larg ish Kosova, sa afër është tani pas rrugës. Nuk thonë kot, që rrugët dhe infrastruktura janë hapi i parë në zhvillimin e një vendi. Dhe rruga e Arbërit, do ishte hapi i parë në zhvillimin e Veriut të Shqipërisë!", shkruan Dorieta Gjura nga Gjermania.

Ndërsa Agron Mataj nga Australia shkruan se "ndërtimi i rrugës së Arbrit do të bëhet një rrugë e shkelur, shumë e rëndësishme për ekonominë lokale dhe do të përmirësojë infrastrukturën e asaj pjese të Europës". "Rruga është jeta... është përgjegjësia e qeverisë shqiptare që t'ju japë një mundësi atyre njerëzve për të jetuar", citon Raimonda Nelku nga Tirana.

Po ashtu, në faqen online kanë firmosur edhe personalitete të kulturës, medies, politikës dhe me gjerë. Ndër të parë kanë qenë edhe diplomatët si Bashkim Pitarka, Albert Rakipi, Sulejman Tomcini, Bashkim Rama, Besnik Mustafaj, Elez Biberaj, Afrim Krasniqi etj. Nuk kanë munguar edhe personalitete nga fusha e artit dhe gazetarisë, si botuesja Flutura Açka, shkrimtarët Bardhyl Xhama, Kopi Kyçyku, Kolec Traboini, Ramiz Gjini etj, kompozitorët Thoma Simaku e Akil Koçi

NDIQ HAPAT E MËPOSHTËME PËR TË FIRMOSUR SAKTË:

1 - KLIKO NË FAQEN E WEB SI MË POSHTË:

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

2- Lart, djathtas shfaqen kuadratet bosh.
Shkruaj Emrin, Mbiemrin, Adresën e emailit dhe Qytetin tuaj. Pastaj klikon "**Sign**".
Pas kësaj, ju do të merrni një mesazh falënderimi dhe konfirmimi që emri juaj u rregjistrua.

Për të gjithë miqtë tuaj që nuk kanë mundwsi hyrje nw web,
sharko formularin dhe plotwsoje me dorw.
Për hollësi mund të vizitoni faqen e gazetës në Web: <**www.rrugaearberit.com**>
ose në Facebook<**facebook.com/gezim.alpion**> ose<**facebook.com/rruga.arberit**>

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 4 (84). 1 - 30 Prill 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë, Haki Pernezha, Abdurahim Ashiku, Mustafa Tola, Islam Çenga, Dali Tërshalla, se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Gëzim ALPION
Abdurahim ASHIKU
Rexhep TORTE
Esmeralda ILNICA
Mentor HOXHA
Rrezehana HYSA
Gafur ZOTO
Agron SELA
Bardhyl AGASI
Ilmi DERVISHI
Faik XHANI
Ahmet KAMBERI
Hysen LIKDISHA
Baftjar GAZIDEDE
Dragush TOTOZANI
Naim PLAKU
Petrit FETAHU
Selman MZIU
Afrim KAROSHI
Dali NOKA
Destan RAMA

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

peticioni

Formulari zyrtar që po firmoset lidhur me peticionin për Rrugën e Arbërit. Formularin mund ta merrni nga faqja e internetit e gazetës WWW.RRUGAEARBERIT.COM ose pranë redaksisë së gazetës. Pasi ta plotësoni, qoftë edhe me një firmë të vetme, mund ta nisni në adresën e gazetës.

Peticion drejtuar Qeverisë Shqiptare pas zgjedhjeve të 2013-ës

NDËRTONI SA MË SHPEJT DHE ME STANDARDE RRUGËN E ARBËRIT

Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Petitioning The Albanian Government after 2013 general elections

COMPLETE THE CONSTRUCTION OF THE ARBËRI ROAD

Dibra is one of the most underdeveloped regions in Albania. The Arbëri Road will connect Dibra with the rest of the country giving a much needed boost to the local economy. The road will also become a new vital route between Tirana and Macedonia thus improving considerably the infrastructure in this part of the Balkans.

Nr.	Emri	Mbiemri	Qyteti	Shteti	Adresa e Emailit / Tel.	Firma

Petition by
GËZIM ALPION
Birmingham, United Kingdom
www.change.org

Shënim: Ata që e kanë firmosur peticionin ONLINE ne change.org, NUK DUHET ta nenshkruajnë atë në letër!

Pas plotësimit, peticionin mund ta postoni me postë në adresën:
Gazeta "Rruga e Arbërit", Rr. "Zenel Baboci", Pall. "Ferar", Tirana- Albania.
Ata që banojnë në Tiranë mund ta sjellin dorazi në redaksinë e gazetës "Rruga e Arbërit", çdo ditë nga e hëna deri të shtunën nga ora 9:00 deri 14:00
Për komente ose pyetje shkruani në email: **<gezim.alpion@hotmail.co.uk>** ose **<rrugaearberit@gmail.com>**
Për hollësi mund të konsultoheni me faqen e internetit **www.rrugaearberit.com**
Tel: **069** 20 68 603 / **067** 30 73 265 / **068** 65 08 441

Kjo pjesë plotësohet nga stafi i peticonit:

Nr. Prot. _____ Data e mbërritjes së formularit. _____. Nr. i faqes pas protokollimit _____ Fillon me nr. rendor _____ Mbaron me Nr. rendor. _____



Ishte shumë e lehtë të firmosnin 2000 të parët, por tani është shumë më e lehtë që numri të rritet. Së bashku do ta kemi më të lehtë ta rrisim numrin e nënshkruesve. Sepse nuk bëhet fjalë për çështje personale, por për një çështje kombëtare, për një çështje që na përket të gjithëve. Bëhet fjalë për zhvillimin e vendit dhe integrimin e rajonit. Nuk bëhet fjalë për të sotmen dhe as për të shkuarën. Por për të ardhmen e fëmijëve tanë në një vend të zhvilluar dhe europian. Rruga do t'i sjellë vendit një ritëm zhvillimi të padëgjuar më parë dhe vetëm atëherë do kujtohemi se sa e vlefshme ishte firma jonë sot.

me banim në Angli, gazetarët Armir Shkurti, Urim Bajrami, Arben Muka, Ilva Tare, Ernest Bunguri, Defrim Methasani, Ilirjan Agolli etj, mjekët Ahmet Kamberi, Ali Tonuzi etj. Gjithashtu, peticionin e kanë nënshkruar edhe dy drejtuesit e shoqatave dibranë në Tiranë, Prof.dr. Nuri Abdiu, kryetar i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë dhe Dr. Faruk Borova, kryetarë i Bashkësisë Dibrane, të cilët njëkohësisht kanë dhënë gjithë mbështetjen e tyre për vazhdimësinë e peticionit.

Emrat e përzgjedhur më sipër janë krejt të rastësishëm prej shkruesit të këtyre radhëve, me qëllimin për të identifikuar një përkrahje maksimale dhe të gjithanshme të peticionit.

"Jam dakord me peticionin, shkruan Agron Tufa. E mbështes fort. Për më tepër me çmerit fakti, se në Parlamentin shqiptar gjithë këto vite ka pasë nga 7-8 deputetë dhe asnjëherë mandati i këtyre deputetëve nuk është ngritur për çështjen e Rrugës së Arbrit. Turp! Jam skeptik për peticionet, se ato zor se e ndryshojnë botën, por e mbështes atë, si formë të gjatë të pakënaqësisë së tejzgjatur", mbyll shënimin ai.

Shkrimtari Faruk Myrtaj shkruan: "Sepse është një rrugë. Nismë e një shqiptari që personalisht jeton tërësisht i integruar në Europë por që, me ndjesinë e vendlindjes së marrë natyrshëm me vete, shpreson t'u gjendet afër dhe tu kujtoj bashkatdhetarëve, me shpresë edhe politikaneve, se veç rrugët, çdonjëra prej tyre, rrugët për në Qendër, rrugët për në qytet, mundësia për të vizituar e shkuar diku sa me më shpejt, janë mbajtje gjallë e kujtesës së kësaj zone krejt të patjetër, mundësi ekzistence të mëtejshme, arterie zhvillimi, por edhe e vetmja mënyrë integrimi".

Besnik Mustafaj, ish ministër i Jashtëm, shkruan se "kjo rrugë sigurisht, që është me rëndësi jetike për dibranët që jetojnë në Dibër, por është e rëndësishme edhe për gjithë Shqipërinë. Kjo rrugë do i jepte Dibrës rëndësinë që meriton në krejt ekonominë tonë kombëtarë. Po ashtu, kjo rrugë do i afronte me Tiranën, Durrësin, Shëngjinin e Vlorën një pjesë të ndjeshme të krahinave shqiptare të Maqedonisë". "Askush s'mund ta kuptojë zhvillimin global duke përjashtuar ndërtimin e Rrugës së Arbërit", - shkruan mjeku Ilir Tasha. Ndërsa gazetari i Zërit të Amerikës, Ilirjan Agolli shkruan se "kjo është rruga që të çon tek Heroi Kombëtar Skënderbeu... Ai atje lindur dhe Kastrioti duhet të jetë qendër pelegrinazhi për shqiptarët. Ndërtimi i rrugës sa më parë do ta lehtësojë këtë pelegrinazh patriotik dhe turistik të shqiptarëve..." Ndërsa kryetari i një shoqatës "Dëshnica" të Permetit, Gëzim Voda, shkruan: "Nuk është Rrugë e Dibrës, është rruga që krijon hapësirën në lindje për Tiranën, është rruga për gjithë shqiptarët...".

Qindra komente të tjera, të cilat mund ti lexoni në faqet e tjera, shprehin vullnetin dhe dëshirën, e cila duhet të bëhet realitet. Sa më parë, aq më mirë, sepse kjo nuk po bëhet me qëllimin për të përmirësuar jetën e një zonë, por sepse rruga, siç thotë Blin Shala nga Gjakova, është "For our people" - "Për njerëzit tanë".

KUSH DUHET TA FIRMOSË?

Më entuziastët e peticioni shkruanin në fillim të nismës, së peticioni do të ketë më shumë se dhjetë mijë firma, por pas dy muajsh, shohim se shumë njerëz po ngurojnë ta bëjnë këtë. Një pjesë e tyre po thonë se rruga po ecën dhe peticioni nuk është i nevojshëm. Një pjesë tjetër skeptikësh thonë se qeveritarët e këtij vendi nuk mendojnë për zhvillimin e vendit dhe kështu që preferojnë të mbeten të paangazhuar. Ndërsa një grup i tretë kanë frikë nga përdorimi politik i peticionit dhe kështu që mendojnë të mos e nënshkruajnë atë. Këto grupime po i ndajmë sipas disa reagimeve shumë të paktë të atyre që kanë marrë guximin të kthejnë përgjigje se pse nuk po e nënshkruajnë peticionin, por që janë shumë të paktë në numër.

Nismëtarët e peticionit kanë theksuar se "ky nuk është peticion politik dhe nuk do të përdoret nga asnjë forcë politike në Shqipëri për qëllime fushate. Peticioni përfaqëson zërin e dibranëve të thjeshtë, të cilët do t'i kërkojnë qeverisë që do të dalë nga zgjedhjet e qershorit përfundimin sa më shpejt dhe me standarde të Rrugës së Arbërit".

Nismëtarët, gjithashtu, kanë bërë të qartë se peticioni do ti dorëzohet qeverisë që do dalë nga zgjedhjet dhe nuk do të përfundojë me mbarimin e zgjedhjeve. Përkundrazi, një aksion më të madh civil, peticioni do ta marrë pas mandatimit të qeverisë së re, pavarësisht se cili grupim politik do t'i fitojë zgjedhjet.

Drejtuesit e partive politike, pa përjashtim, sidomos dy forcat kryesore, e kanë premtuar dhe vazhdojnë ta premtojnë përfundimin e rrugës. Kështu që anëtarët e tyre duhet ta firmosin pa hezitim peticionit. Për dy arsye: së pari se partitë e tyre po e premtojnë dhe ata duhet të dëshmojnë me këtë se kanë besim të udhëheqësit e tyre që i mbajnë premtimet dhe, së dyti, për të dëshmuar se edhe në opozitë, do ta kenë si kërkesë të vazhdueshme, ose anasjelltas.

Një nga qëllimet kryesore të peticionit është edhe kërkesa për një përmirësim të standardeve të rrugës, duke e parë atë jo si një lidhje të Tiranës me Dibrën, edhe atë të Madhen, por si një arterie kryesore e Shqipërisë së nesërme europiane.

* * *

Ishte shumë e lehtë të firmosnin 2000 të parët, por tani është shumë më lehtë që numri të rritet. Së bashku do ta kemi më të lehtë ta rrisim numrin e nënshkruesve. Sepse nuk bëhet fjalë për çështje personale, por për një çështje kombëtare, për një çështje që na përket të gjithëve. Bëhet fjalë për zhvillimin e vendit dhe integrimin e rajonit. Nuk bëhet fjalë për të sotmen dhe as për të shkuarën. Por për të ardhmen e fëmijëve tanë në një vend të zhvilluar dhe europian. Rruga do t'i sjellë vendit një ritëm zhvillimi të padëgjuar më parë dhe vetëm atëherë do kujtohemi se sa e vlefshme ishte firma jonë sot.

Të gjithë ata që nuk e kanë shënuar emrin e tyre, mund ta bëjnë tani! Asnjëherë nuk është vonë. Sa më shumë që të bëhemi, aq më shumë do dëgjohet zëri yt.

Bujar Karoshi

Rruga e Arbërit nr. 84

Dibra e ka të nevojshme të lidhet me pjesë të ndryshme të Shqipërisë që t'i jepet mundësia e zhvillimit të vendit.

- Eduart Kurti

opinione

Rruga e Arbërit është rruga e integrimit

Mjaft qytetarë që kanë firmosur peticionin për rrugën e Arbërit, kanë nënshkruar edhe mendimet e tyre se pse ndërtimi i saj është i rëndësishëm për ta. Opinionet janë ta hapura në faqen e web "change.org" dhe shumë prej tyre janë në gjuhën angleze. Opinionet do bëhen publike numër pas numri, duke mbledhur kështu argumentat që do botohen në një botim të posaçëm, që do t'i bashkëngjitet peticionit.

Redaksia do të mirëpresë në vazhdim edhe opinione e studime specialistësh, me argumenta të tjera "Pro" ndërtimit të rrugës dhe avantazhet që ajo sjell për ekonominë kombëtare.

Yllka Cemena, DIBER, MACEDONIA: Për perspektivën e gjithë rajonit Maqedoni-Shqipëri-Kosovë

Misir Nesimi, PESHKOPI, ALBANIA: Rrugë

Teo Teo, TIRANA, ALBANIA: Sepse është vendi im.

Gerta Caushi, DIBRA, ALBANIA: Sepse falë asaj rruge udhëtimi do të jetë më i shkurtër dhe më i qetë.

Gazmir Mazari, TIRANA, ALBANIA: Unë e shoh rrugën si një faktor kyç në zhvillimin e Dibrës në çdo aspekt si në atë ekonomik dhe në anë të tjera, siç mund të jetë emancipimi.

Arjeta Allamani, DURRES, ALBANIA: Është një gjë e mirë për vendin tim. Pse jo?

Geri Allamani, DURRËS, ALBANIA: Sepse duhet të jetë e zhvilluar

Brigeni Ndoja, DURRËS, ALBANIA: Kjo është e rëndësishme për mua sepse ndihmon në zhvillimin e Shqipërisë.

Donald Kryemadhi, TIRANA, ALBANIA: Jam nga Peshkopia dhe nuk dua ta marr me bezdi idenë se dua të shkoj në vendin tim të lindjes dhe ku jam rritur.

Ledian Zerba, DURRËS, ALBANIA: Sepse hap mundësi të reja për zhvillimin ekonomik, të transportit dhe të tregëtisë.

Ervis Qojdeshi, LONDON, UNITED KINGDOM: Çdo Rrugë në një vend në të cilin mungojnë është e rëndësishme.

Blin Shala, GJAKOVE, KOSOVO: Për njerëzit tanë.

Landa Abazi, BASINGSTOGE, UNITED KINGDOM: E mbështes këtë peticion dhe shpresoj të bëhet diçka serioze për Rrugën e Arbërit. Jam e lindur në atë vend dhe kam kaluar një pjesë të bukur të jetës time. Edhe pse nuk vazhdoj të jetoj më atje, do të dëshiroja ta vizitoja më shumë rrethin e Dibrës me gjithë bukuritë natyrore që i ka dhënë Zoti.

Allaman Hoxha, TIRANA, ALBANIA: Jam edhe unë plotësisht dakord për të dhënë kontributin tim sado i vogël që mund të jetë, që të arrijmë 2000 aplikues në lidhje me peticionin e Rrugës së Arbërit.

Blini Korumi, DIBER, MACEDONIA: Kjo është rruga drejt bashkimit të të gjitha trojeve shqiptare.

Nexhat Korumi, DIBER, MACEDONIA: Sepse jetoj në rrethinat e Dibrës.

Bujar Plloshtani, SKOPJE, MACEDONIA: Për të sensibilizuar shoqërinë.

Luan Kaba, PESHKOPI, ALBANIA: Rruga e Arbërit realisht është RILINDJA e Dibrës

Bedri Tahiri, GALICë- DRENICë, ALBANIA: Është e një rëndësie të veçantë, ngase lidh krahinën më luftarake, vendlindjen e Skënderbeut me kryeqytetin.

Mujo Buçpapaj, TIRANA, ALBANIA: Votoj që të ndërtohet "Rruga e Arbërit"

Leonard Merdini, PESHKOPI, ALBANIA: Jam një student dhe do të jetë ndihmë për të lëvizur lirshëm e për të vizituar prindërit më shpesh.

Ali Senjefi, TIRANA, ALBANIA: Zhvillimin e vendit tim.

Elton Cani, TIRANE, ALBANIA: Jam nga Dibra e nëse dua të shkoj në vendlindje, me merr pesë orë udhëtimi të paktën dhe është një humbje kohe... do të ndihmojë marrëdhëniet mes dy vendeve... do të ndihmojë banorët e zonës të kenë më shumë mirëqënie ekonomike, dhe do të ndihmojë edhe turizmin malor.

Denis Melani, PESHKOPI, ALBANIA: Është arteria që i takon trevës së dibrës

Argëtim Marku, MISSISSAUGA, CANADA: Ka shumë arsye pse Rruga e Arbërit duhet bërë: - Së pari ajo do të bëjë një lidhje më të shpejtë dhe më të sigurtë të Dibrës me kryeqytetin, që më pas do sjell të mira ekonomike, kulturore, shkencore etj. - Së dyti, do kthej besimin e dibranëve në vetvete, besimin që akoma janë njerëz të zgjuar. Shumë shpejt pas kësaj shumë dibranë, që kanë filluar të lëshojnë rrënjë në vendet e huaja, do të fillojnë të mendojnë për një kthim të përhershëm në atdhe. - E treta dhe më e rëndësishmja për shqiptarët matanë kufirit, për Dibrën e Madhe dhe rrethinën, është që do t'i bëjë të kthejnë sytë nga Shqipëria dhe jo nga Shkupi apo gjetkë. Shumëkush, me të drejtë, do shtojë edhe njëmijë arsye të tjera. Këto ishin të miat. Qeveria e re nuk duhet lutur për këtë, ajo e ka për detyre ta realizojë atë, që dje. Faleminderit z. Alpino për këtë iniciativë. - Sinqerisht, Argëtimi

Afrim Spahiu, PRISTINA, KOSOVO, ALBANIA: Dibër

Aurora Spahiu, NY, NY: Jam nga Peshkopia dhe e vizitoj shumë shpesh qytetin.

Melsi Carar, ITALY: Jam nga Peshkopia. Jam nga Bulqiza. Jam nga Maqellara. Unë jam Dibran.

Armela Beqiri, TIRANA, ALBANIA: Për një zhvillim të ekonomisë dhe kulturës së pasur dibrane.

Ardit Halili, TIRANA, ALBANIA: Sepse do të më japë një mundësi të shkoj më shpejt në vendlindjen time...

Agroland Rama, TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arberit, Martaneshi

Ahmet Shehu, TIRANA, ALBANIA: Pro rrugës së Arbërit.

Adrian Spahiu, GERMANY: Dibra këtu e 2200 vjet më pare njihej si qendër e rëndësishme biznesi në gjithë Ballkanin në një pjesë të Europës por dhe në Azi. Në ditët e sotme nuk ka asgjë-në më elementare 'Infrastrukturën' sinqerisht për të ardhur keq nga këta politikanë të fëlliqur. Temë me vend!

Vera Ndrecaj, CARDIFF, UNITED KINGDOM: Sepse është një vend shumë i bukur, me njerëz të ngrohtë dhe mikpritës që e meritojnë të jenë pjesë e zhvillimit.

Arbana Taraneshi, DIBER, MACEDONIA: Sepse rruga don të thotë zhvillim dhe Dibra e meriton.

Elida Motro-Iljazi, TIRANA, ALBANIA: Është një prioritet kombëtar.

Adnan Abrashi, PRIZREN, SERBIA: E nevojshme për lidhjen e kombit në përgjithësi.

Sabaudin Varvarica, ITALY: Pasi ripërmasimi i raportit qendër-periferi lokale do krijonte hapësira të reja komunikimi e do mundësonte rinjohjen (e munguar) ndërshqiptare.

Artan Ficorri, LONDON, UNITED KINGDOM: Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Flamur Vojvoda, MITROVICA, ALBANIA: Dibra është një nga zonat me pak të zhvilluara të Shqipërisë. Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me pjesën tjetër të vendit duke i dhënë një zhvillim të nevojshëm të ekonomisë lokale. Rruga do të jetë gjithashtu një nyje e rëndësishme lidhje mes Tiranës dhe Maqedonisë, duke përmirësuar kështu në mënyrë të konsiderueshme infrastrukturën e kësaj pjese të Ballkanit.

Ajet Nuro, MONTREAL, CANADA: Rrugët dhe qarkullimi i lirë janë mjeti kryesor në zhvillimin e një kombi. Shpresojmë se qeveria që do dal nga zgjedhjet e 23 qershorit ta ketë në mendje një gjë të tillë.

Tonin Uka, NAPLES, ALBANIA: Sepse është rruga më e rëndësishme e gjithë trojeve Shqiptare.

Eduart Kurti, TIRANE, ALBANIA: Është vendlindja ime Peshkopia dhe Dibra e ka të nevojshme të lidhet me pjesë të ndryshme të Shqipërisë që t'i jepet mundësia e zhvillimit të vendit .

Besmir Cajka, DIBER, ALBANIA: Sepse mund të shikoj prindërit e mi çdo ditë e jo një herë në muaj.

Sashenka Ndreka, PESHKOPI, ALBANIA: Mendoj se një ndër arsyet që rrethi i Dibrës nuk mund t'ia tregojë botës pasuritë që mbart, është infrastruktura. Mendoj që me ndërtimin e rrugës së Arbrit do bënim një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit kulturor dhe ekonomik.

Faruk Myrtaj, TORONTO, CANADA: Sepse është një rrugë. Nismë e një shqiptari që personalisht jeton tërësisht i integruar në Europë por që, me ndjesinë e vendlindjes së marrë natyrshëm me vete, shpreson t'u gjendet afër dhe tu kujtoj bashkatdhetarëve, me shpresë edhe politikanevë, se veç rrugët, çdonjëra prej tyre, rrugët për në Qendër, rrugët për në qytet, mundësia për të vizituar e shkuar diku sa me më shpejt, janë mbajtje gjallë e kujtesës së kësaj zone krejt të patjetër, mundësi ekzistence të mëtejshme, arterie zhvillimi, por edhe e vetmja mënyrë integrimi.

Lulëzim Visha, DURRËS, ALBANIA: Rruga e Arbërit është e një rëndësi të veçantë

Urim Visha, BEDFORD, UNITED KINGDOM: Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën dhe shqiptarët e Maqedonisë me pjesën tjetër të Shqipërisë.

Selim Terziu, CARDIFF, UNITED KINGDOM: Është vitale për interesat e banorëve të Dibrës. Është turp i madh që s'është ndërtuar akoma.

Kudret Feruku, PESHKOPI, ALBANIA: Janë të shumta arsyet,që rruga e Arbrit duhet të ndërtohet.

Ilirjan Agolli, TIRANA, ALBANIA, ALBANIA: Kjo është rruga që të çon tek Heroi Kombëtar Skënderbeu... Ai atje lindur dhe komuna Kastriot duhet të jetë qendër pelegrinazhi për shqiptarët. Ndërtimi i rrugës sa më parë do ta lehtësojë këtë peligrinazh patriotik dhe turistik të shqiptarëve...

Kastriot Cipi, TIRANA, ALBANIA: Të gjithë biem dakord se Rruga e Kombit është deri më tani hapi më i rëndësishëm në projektin e bashkimit kombëtar të shqiptarëve. Por nëse është kështu, hapi tjetër duhet të jetë patjetër Rruga e Arbrit, e cila jo vetëm eliminon përfundimisht izolimin e zonave verilindore, por hap portën e Shqipërisë (dhe Adriatikut) për një milion shqiptarët e Maqedonisë.

Mirela Strazimiri, Vieth BLOOMINGTON, IL: Infrastruktura ndihmon në zhvillimin e zonës dhe atë kombëtar.

Erblin Ismaili, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse unë udhëtoj shpesh nga Tirana në Peshkopi dhe anasjelltas, dhe me rrugën aktuale është shumë e vështirë dhe e mërzitshme

Ferdi Fida, PESHKOPI, ALBANIA: Ne fitojmë një copë rrugë, Shqipëria fiton një zonë të tërë për turizmin malor për të cilin ka shumë nevojë. Fëmijët dhe të gjithë nuk do ta tregojnë me gisht në hartë Malin e Korabit, por do ta tregojnë edhe me detaje pasi ta vizitojnë. Do të shohin bukurinë e bjeshkës së Hynoskës, në hyrje të qytetit të Peshkopisë. Është shumë afër, afro 7 km nga rruga kryesore (Nacionale), e pabesueshme !!! Vetëm RRUGA E ARBRIT do të bëjë të mundur të shijoni bukurite ë natyrës tonë, bujarinë e Dibrës!

Redon Mehmeti, PESHKOPI, ALBANIA: Ndërtimi rrugës

Ornes Gjoka, TIRANE, ALBANIA: Kjo rrugë është shumë e nevojshme për të gjithë ne që nuk jetojme më në Dibër, dhe për ato që jetojnë gjithashtu. Do të shtohet fluksi i njerëzve për të shkuar në vendlindje dhe i vendasve për të plotësuar nevojat familjare në kryeqytet, që sjell një rritje të konsiderueshme të ekonomisë. Do të sillte një ndryshim goxha të konsiderueshëm ne mbajtjen pastër të ajrit, duke qenë se makinat do të kalojnë në rrugë të mira dhe do të kenë më pak probleme. Do të pakësohet numri i aksidenteve që vjen si pasojë e kthesave të shumta dhe malit të thepisur që gjendet nën rrugën aktuale. Ju lutem na ndihmoni se më shpejtë të jetojmë jetën tonë të ndërlidhur.

Klevis Selmani, PESHKOPI, ALBANIA: Rruga e Arbërit

Rexhep Lala, DEBAR, MACEDONIA :)

Blerta Spahiu, TIRANA, ALBANIA: Që të shkoj në qytetin tim.

Xhelal Shehi, MAQELLARË, ALBANIA: Përfundimi i kësaj rruge do të mundësojë lidhjen e Dibrës me metropolin.

Kreshnik Belba, ELBASAN, ALBANIA: Për Shqipëri e për shqiptarë

Kaloshi Pellum, PERUGIA, ITALY: Duam Rrugën....sna intereson kush vjen në pushtet ..por të mbarojnë Rrugën...boll me mashtrime edhe me fjalë të bukura ..1 javë para zgjedhjeve ...por fajet i kemi në dibranët që u japim vota ..e nuk ju presim Rrugën që të mos vini fare deri të bëni rrugën...kshu se kshu ..spo na bëni punë kur vini të paktën e dimë ...por nuk lëmë mashtruesa e hajduta të na shkelin tokën tonë e të na mashtrojnë ..në vendin tonë.... booll boooll me > Rrena duam Rrugen

Reonalda Maze, SARANDA, ALBANIA: Eshtë e rëndësishme për mua sepse sepse është e rëndësishme edhe për dibranët. Ata kanë të drejtë të ndjehen të barabarte me ne të tjerët.

Shefki Lleshi, DEBAR, MACEDONIA: Bashkim i shqiptarisë nëpërmjet udhëve.

A.S., TIRANA, ALBANIA: Sepse rruga do të na jepte një mundësi për të udhëtuar në vende të tjera të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Do të shërbente edhe për qëllime ekonomike.

Ada Trushi, ELBASAN, ALBANIA: gjithcka

Shukri Krejfca, DEBAR, MACEDONIA: Dua sa me shpejt të ndërtohet rruga e Arbërit ju lutem

Mendim Merdini, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse jam demokrat zotit Berisha i japim

koment

të shqiptarëve



votat dhe venë ke tuneli i Elbasanit, nuk është e arsyeshme kjo sa për të dhënë votat. Dikush duhet të dëgjojë për këtë rrugë dhe për ne Dibranët që jemi të izoluar në çdo aspekt mes të cilëve bëj pjesë edhe unze, kjo rrugë është shumë e rëndësishme për qarqet kryesore të Dibrës vogël dhe të Madhe për shqiptarët jashtë kufirit të Maqedonisë dhe në do na ndihmonte dhe do na lehtësonte jetën kjo rrugë ka shume probleme me gropa kthesa të vërteta që shkaktojnë aksidente të mëdhaja me tragjedi drejtuesit e mjeteve e kanë shumë të vështirë të udhëtojnë në rrugën e Arbërit shkakton dëmtime të mëdhaja në automjetet/ taksit e tyre përveç disa pjesëve të ndërtuara si pjesë e rrugës së Arbrit, në shumicën e saj ky aks është jashtë çdo standardi, Peshkopi-Shupenze dhe Klos-Burrel e cila është me gropa të mëdhaja që shkaktojnë humbje kontrolli në automjete. Prej vitesh përmendet e ashtuquajtura rruga e Arbërit, e cila do të shkurtonte distancat dhe do të krijonte mundësi zhvillimi për gjithë zonën.

Linda Bali, PESHKOPI, ALBANIA: Është e rëndësishme sepse unë vizitoj familjen dhe miqtë shpesh dhe rruga e tanishme është në gjendje të mjerueshme. Kur udhëtoj nga Tirana në Peshkopi sëmurem nëpër gropa e kthesa të forta.

Avni Suroçaj, BRUXELLES, BELGIUM: Kjo është një urë lidhëse mes Dibrës dhe rajonet e tjera.

Fatjon Lami, TIRANA, ALBANIA: Për shkak se ajo sjell zhvillimin e turizmit në Shqipëri.

Defrim Deda, TIRANË, SHQIPËRI, ALBANIA: Dibra është vatër kulture që ka furnizuar historikisht gjithë Shqipërinë me ide të mëdha, prej këtu rrjedh se Dibra banohet nga njerëz me mjaft intelekt dhe që mundësia për t'u lidhur me qytete të tjera në mënyrë sa më të lehtë, do i jepte një hov të madh zhvillimit të Dibrës dhe, pse jo, njëkohësisht edhe zhvillimit të qyteteve të tjera me të cilët do të ketë me shumë shkëmbime të mundësuara prej Rrugës së Arbrit.

Izet Ramku, PESHKOPI, ALBANIA: Është një "mur" që duhet të kalohet..Një "mur" që po na mban te izoluar me pjesën tjetër të Shqipërisë për kaq shumë kohë... Duke mos përmendur rëndësinë e turizmit malor dhe atë të zhvillimit kulturor apo ekonomik do thoja që kjo rrugë është e vetmja shpresë për ne...

Sali Kadriu, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme për arsye se dëshiroj që edhe Dibra të zhvillohet ashtu siç janë të zhvilluar edhe rajonet e tjera

Abdullah Meha, MITROVICA, ALBANIA: Është pjesë e "Rrugës së Kombit" në shumë mënyra.

Ana Suroçi, BULQIZË, ALBANIA: Pavarësisht se gjeografikisht banorët e rrethit të Dibrës janë shumë afër kryeqytetit atyre ju nevojiten aktualisht më shumë 4 orë udhëtim për t'u lidhur me kryeqytetin, përfundimi i kësaj rrugë do t'i ndihmonte shume ata. is this important to you? (Optional)

Servet Rriçku, TIRANA, ALBANIA: Takoj njerëzit e mi .

Anthi Kala, TIRANA, ALBANIA: Sepse e meritojnë Dibranet! :)

Serxho Rriçku, TIRANA, ALBANIA: më pëlqen shumë të shkoj në vendlindje

Ledjo Rriçku, TIRANA, ALBANIA: rrugëtoj shpesh drejt vendlindjes

Regi Cibaku, TIRANA, ALBANIA: Sepse kjo rrugë do të jetë më e rehatshme sesa rruga egzistuese për familjen time kur udhëtojmë për në Dibër e Peshkopi.

Ardit Kamberi, TIRANE, ALBANIA: Zhvillohet Verilindja e Shqipërisë, dhe një rrugë historike....

Andrw Schumann, RZESZOW, POLAND: Unë i mbështes idetë për zhvillimin e infrastrukturës së Shqipërisë si në pjesën tjetër të vendeve të Europës Qendrore.

ERLIND REÇI, PESHKOPI, ALBANIA: Kemi nevojë për këtë rrugë.

Elizabeta Tershalla, SARANDË, ALBANIA: ndërtojeni Rrugën e Arbrit.

Agron Tufa, TIRANA, ALBANIA: Jam dakord me peticionin. E mbështes fort. Për më tepër me çmerit fakti, se në Parlamentin shqiptar gjithë këto vite ka pasë nga 7-8 deputetë dhe asnjëherë mandati i këtyre deputetëve nuk është ngritur për çështjen e Rrugës së Arbrit. Turp! Jam skeptik për peticionet, se ato zor se e ndryshojnë botën, por e mbështes atë, si formë të gjatë të paknaqësisë së tejzgjatur.

Zija Vranezi, PESHKOPI, ALBANIA: Kjo rrugë është e rëndësishme jo vetëm për mua por për të gjithë shqiptarët, sepse ju jep shpresë njerëzve që do të komunikojnë e lëvizin përmes kësaj rruge.

Alda Manaj, FIER,ALBANIA, ALBANIA: Fier

Benard Cullhaj, TIRANA, ALBANIA: Nëse ndërtohet kjo rrugë, do të jetë shumë e bukur...

Armanda Leka, TIRANA, ALBANIA: zhvillimi i Shqipërisë

Zeneli Baftjar, ITALY: Mendoj që qeveria nuk duhet ta shikojë Dibrën me syrin e njerkës. Dhe për më shumë, nuk është vetëm Dibra që pret si sytë këtë rrugë. Me nderime Baftjar Zeneli.

Miranda Spahiu, TIRANA, ALBANIA: Unë jam me origjinë nga Dibra dhe nuk dëshiroj që rruga të vazhdojë të më largojë nga origjina ime, rruga e cila do të thotë zhvillim e mirëqenie për të gjithë ne e a më tepër për ata njerëz të mrekullueshëm që jetojnë në tokën e tyre.

Taxhedin Rexhepi, TETOVO, MACEDONIA: Rruga do të jetë një trase e rëndësishme mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, duke përmirësuar kështu në mënyrë të dukshme infrastrukturën e kësaj pjese të Ballkanit.

Altin Skepi, PESHKOPI, ALBANIA: Në qofte se realizohet ky projekt, do ketë një vlerë shumë të madhe për Dibrën! Suksese

Saimir Damazeti, ITALY: Sepse është vendlindja ime.

Almir Jajaga, DIBER, MACEDONIA: Rruga e Arbërit është një by-pass për Dibra

Gazmir Dauti, DURRËS, ALBANIA: për përfitimin e vendit tonë.

Brikel Bajrami, TIRANE, ALBANIA: Sepse kam gjyshin dhe gjyshen në Dibër...

Dritan Bocku, DEBAR, MACEDONIA: Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën ne kryeqendrën Tiranën, Aeroportin Nënë Tereza , Durrësin etj

Francesk Fusha, ITALY: Pyetja "Pse kjo është e rëndësishme për ty, për mendimin time është banale, por le ta lëmë anash funksionimin e sitit të internetit në të cilin firmoset ky peticion. Mendimi im është që Rruga e Arbërit jo vetëm është detyre morale, duke pasur parasysh origjinën, por në të njëjtën kohë është themelore dhe për sa i përket mëdhenjve ndërkombëtare, për të cilat ndërtimi i korridoreve është element themelor për bashkimin e komuniteteve që jetojnë jashtë kufijve të një shteti. Është pra detyrë e Jona si komb/shtet që të krijojmë këtë lidhje mes Shqipërisë dhe komunitetit tonë në Maqedoni, që, për nga numri i popullsisë, nuk është për t'u anashkaluar. Faktorë të tjerë janë të panumërt, si ato ekonomik apo element të tjerë që vlerësohen dhe marrin hove nga ndërtimi i korridoreve të tilla! Uroj që një çështje e tillë të mos vihet në diskutim, por të zbatohet sa më parë! Sinqerisht, Françesk Fusha.

Besmir Neza, TIRANA, ALBANIA: Absolutisht që është shumë e nevojshme, pasi sjell një jetë të re në ato krahina.

Besnik Mustafaj, TIRANA, ALBANIA: Kjo rrugë sigurisht që është me rëndësi jetike për dibranët që jetojnë në Dibër, por është e rëndësishme edhe për gjithë Shqipërinë. Kjo rrugë do i jepte Dibrës rëndësinë që meriton në krejt ekonominë tonë kombëtarë. Po ashtu, kjo rrugë do i afronte me Tiranën, Durrësin, Shëngjinin e Vlorën një pjesë të ndjeshme të krahinave shqiptare të Maqedonisë.

Betim Lleshi, DIBER, AUSTRIA: Sepse Dibra është vendlindja ime dhe besoj që ky korridor do të ndihmojë zhvillimin e kësaj pjese të Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Arjan Markeçi, DURRES, ALBANIA: Sepse do ketë më shumë zhvillim ekonomik, turistik dhe kulturor dhe arsimor, gjithashtu shkurton distancën nga qytetet e tjera.

Argjend Kaba, DIBER, AUSTRIA: Rrugët bashkojnë njerëzit dhe mundësojnë zhvillimin ekonomik-mirëqenien.

Genci Lleshi, PESHKOPI, ALBANIA: Nuk është e rëndësishme vetëm për mua po për të gjithë shqiptarët!

Ilir Tasha, TIRANA, ALBANIA: Askush s'mund ta kuptojë zhvillimin global duke përjashtuar ndërtimin e Rrugës së Arbrit.

Ervis Luraku, PARMA, ITALY: Është shumë e rëndësishme për mua

Trim Gorenca, DEBAR, MACEDONIA: rruga e Arbërit

Ali Kurti, LONDON, UNITED KINGDOM: Dua të shkoj me Ferrarin andej, ndaj...

Unë i mbështes idetë për zhvillimin e infrastrukturës së Shqipërisë si në pjesën tjetër të vendeve të Europës Qendrore.
Andrw Schumann,
RZESZOW, POLAND

Rruga e Arbërit është shumë rëndësishme për të gjithë vendin tonë dhe ajo duhet bërë patjetër ajo rrugë është mirësia për të çuar Shqipërinë për para..
Vition Kaba, *LONDON, UNITED KINGDOM.*

Fatjon Dema, DIBËR, MACEDONIA: Kjo është një dëshirë e madhe e jona, sepse qyteti ka shumë shpresë te ky projekt. Shpresoj që do të realizohet. Faleminderit.

Dalip Duka, DEBAR, MACEDONIA: Është e rëndësishme për gjithë qytetarët e Shqipërisë...

Arben Jata, TIRANA, ALBANIA: Vendi ku është lindur mamaja ime.

Mevlud Zeneli, PESHKOPI, ALBANIA: Nëse bëhet fjalë për rëndësi, pikërisht kjo rrugë është ajo që do t'i japë vlerat dhe rëndësinë e duhur Peshkopisë sime.

Bilbil Pitarka, CHIUSI SCALO, ITALY: Pikësëpari "zhvillim" pastaj është një detyrim ndaj dibranëve... Duhet me plas ndonjë bombë që ta kuptojnë këto qeveritar??? Por për votat janë gati të të japin dhe gjënë më të shtrenjtë... Turp...

Iljas Ciku, ITALY: Dibra e malet e saj...

Jona Faction, PESHKOPI, ALBANIA: Të jetosh një një vend që merr frymë vetëm për mbijetesë është mbytëse....përfaqësojë një brez që nuk ka nevojë për fjalë por për vepra....Një brez që zhgënjehet dita ditës...e shpreson mbi ëndrra të vrara...sepse vetëm këtë të ofron Dibra sot.

Bajram Sallaku, BULQIZE, ALBANIA: Jam dakort me nismen. PD duhet të nisë urgjentisht Rrugën e Arbërit dhe ta mbarojë atë në një kohë sa më shkurtër pasi dhe Dibra i ka dhënë votëbesim kësaj force politike nga dy dekada

Aba Lleshi, STATEN ISLAND, NY: Dibra është vendlindja ime, dhe kur vij në Shqipëri kam dëshirë të kem mundësinë të udhëtoj në mënyrë efektive dhe të shpejtë pa u preokupuar për kohë të humbur apo të marr vendimin për të mos udhëtuar në veri për shkak të infrastrukturës së varfër...

Getuar Elezaj, ITALY: të jem si populli i Dibrës mos të votoj fare në zgjedhje... të çohen të gjithë në këmbë... t'i harrojnë votat qeveritarët tanë, janë mësuar duke gënjyer për një thes mielli... asnjeri mos të shkojë në votime.... por s'ka ashtu njerëzish... Ja ca bhete me këto debate: Sherefedin Shehu theksoi se Rama e ka kundërshtuar këtë rrugë në çdo moment dhe ka bllokuar progresin. E vërteta është se Rama i detyroi deputetët e tij të votojnë kundër financimit te kësaj rruge 3 herë rresht, dhe hera e fundit vetëm para 3 muajsh dhe ka përdorur çdo mundësi për të bllokuar progresin për qytetaret me kusht që të marrë diçka për vete. Çfarë pret nga këta politikanë shqiptarë... janë mësuar duke gënjyer e vjedhur... janë mësuar duke ju dhënë një thes mielli një fukarai... por ata të gënjejnë njerëzit që jetojnë jashtë vendit nëpër Evropë, ne nuk mund të na gënjejnë, se i dimë gjërat se si zhvillohet vendi si janë të mirat edhe të këqijat.... të fillojë rruga e Arbërit se e lan Dibrën në mjerimin më të madh... i vetmi qytet qe nuk ka një çezmë ujti në bulevard. I vetmi qytet që është gropa

(Vijon në faqen 6)

Faksimile e peticionit të nënshkruar nga qytetarë në Tiranë, sjellë në redaksi nga Ilmi Dervishi



Peticion drejtuar Qeverisë Shqiptare pas zgjedhjeve të 2013-ës
NDËRTONI SA MË SHPEJT DHE ME STANDARDE RRUGËN E ARBËRIT

Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Petitioning The Albanian Government after 2013 general elections
COMPLETE THE CONSTRUCTION OF THE ARBËRI ROAD

Dibra is one of the most underdeveloped regions in Albania. The Arbëri Road will connect Dibra with the rest of the country giving a much needed boost to the local economy. The road will also become a new vital route between Tirana and Macedonia thus improving considerably the infrastructure in this part of the Balkans.

Nr.	Emri	Mbiemri	Qyteti	Shteti	Adresa e Emailit / Tel.	Firma
1	Riza	Gjeta	Bulgize	Shqipta	0692255213	
2	Sabit	Thika	Tirane	Shqiptar	0682469554	
3	Ismet	Baci	Tirane	Shqiptar	068904545426	
4	Edgar	gjeta	Bulgize	shqiptar	06921 95094	
5	Rihane	Gjeta	Bulgize	Shqiptar	06957 45994	
6	Shkelqim	Shkjefni	Peshkopi	11 11	0684359883	
7	Xhemaq	Dani	Peshkopi	-11-	068 22 75726	
8	Mehmet	Skera	Tirane	-11-	0686893234	

Petition by GËZIM ALPION, Birmingham, United Kingdom, www.change.org

Shënim: Ata që e kanë firmosur peticionin ONLINE në change.org, NUK DUHET ta nënshkruajnë atë në letër!

Pas plotësimit, peticionin mund ta postoni me poste në adresën:
Gazeta "Rruga e Arbërit", Rr. "Zenel Baboci", Pall. "Ferar", Tirana- Albania.
Ata që banojnë në Tiranë mund ta sjellin dorazi në redaksinë e gazetës "Rruga e Arbërit", çdo ditë nga e hëna deri të shtunën nga ora 9:00 deri 14:00
Për komente ose pyetje shkruani në email: **<gezim.alpion@hotmail.co.uk>** ose **<rrugaearberit@gmail.com>**
Për hollësi mund të konsultoheni me faqen e internetit **www.rrugaearberit.com**
Tel: **069** 20 68 603 / **067** 30 73 265 / **068** 65 08 441

Kjo pjesë plotësohet nga stafi i peticionit:
Nr. Prot. 001 Data e mbërritjes së formularit 12/04/2013 Nr. i faqes pas protokollimit 1 Fillon me nr. rendor 1 Mbaron me Nr. rendor 8

Rruga e Arbërit është rruga e integrimit të shqiptarëve

gropa rrugët e asfaltuara që në kohën e Enver Hoxhës... s'të merr malli me vajtur në ditët vetëm nga infrastruktura e mjeruar.

Ermal Halili, LONDON, UNITED KINGDOM: Sepse është vendlindja ime ...

Bledar Bitri, TIRANA, ALBANIA: Është vendlindja ime.

Vition Kaba, LONDON, UNITED KINGDOM: Rruga e Arbërit është shumë rëndësishme për të gjithë vendin tonë dhe ajo duhet bërë patjetër ajo rrugë është mirësia për të çuar Shqipërinë për para..

A.Xhilaga, ALBANIA: Është vendlindja e prindërve të mi dhe është një vend i mrekullueshëm me njerëz të mrekullueshëm. Ata meritojnë më të mirën.

Alketa Fisniku, TIRANA, ALBANIA: për vendlindjen time

A.Kaca, ALBANIA: E meriton plotësisht edhe Rruga e Arbërit, titullin "Rruga e Kombit". Do ishte një lidhje shumë e shkurtër e shqiptarëve brenda dhe jashtë kufirit dhe do sillte një zhvillim të madh për zonën ku kalon, si edhe për gjithë Shqipërinë.

Gëzim Voda, PËRMET, ALBANIA: Nuk është Rrugë e Dibrës, është rruga që krijon hapësirën në lindje për Tiranën, është rruga për gjithë shqiptarët...

Hamza Reçi, TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arbrit, një nga korridoret më të rëndësishme të vendit, krijon mundësitë e një zhvillimi të shpejtë të territoreve nëpër të cilët ajo kalon. Ajo lidh zonat e Maqedonisë, me ato të Shqipërisë, në një kohë thuajse 5 herë më të shpejtë se ajo ekzistuese, duke ulur kostot e transportit dhe në të njëjtën kohë një komunikim tepër efikas të Komuniteve me Tiranën dhe portet e Durrësit, Shëngjinit dhe Vlorës. Është e domosdoshme për vete faktin sepse krijon një zhvillim dinamik dhe të qëndrueshëm të rajonit.

Ibrahim MILUSHI, TIRANA, ALBANIA: Unë nuk jam dibran, por jam shqiptar që e dua me gjithë shpirt kombin dhe vendin tim. Për Dibrën dhe dibranët kam respekt të veçantë, por firmosjen e këtij peticioni e bëj nga pozicioni i një intelektuali shqiptar dhe nga pozicioni i njohje shumë të gjerë (për shkak të profesionit) që kam për trojet shqiptare dhe potencialet e tyre ekonomike. Rruga e Arbërit ka rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin ekonomik të trojeve shqiptare pasi vënë në lëvizje pasuri minerale dhe vlera turistike dhe shumë potenciale të tjera me impakt të jashtëzakonshëm në zhvillimin e vendit. Në pikëpamje strategjike, ky korridor, ka rëndësi të jashtëzakonshme për realizimin e aspiratave kombëtare. Rruga e Arbërit është një vepër me rëndësi të veçantë kombëtare dhe si e tillë duhet të përfaqësojë një përparësi kombëtare.

Arsen Ashiku, ITALY: Sepse unë jam i lindur në veriun e Shqipërisë dhe kjo rrugë është për qytetin tim të lindjes.

Klodi Kuka, TIRANA, ALBANIA: Sepse Kjo rrugë do të sjellë jo vetëm një zhvillim ekonomiko-kulturor por dhe ne do mund të jemi më pranë vendlindjes.

Rubin Shehu, TIRANA, ALBANIA: Është udhëtim shumë i mirë, por makina ime s'është dakord :(

HAZIR PERGJEGJI, MALMÖ, SWDEN: Vendlindja ime, vendi ku më ka rënë koka.

Brunilda Beluli, ROMANO DI LOMBARDIA, ITALY: Sepse origjina ime është Dibra dhe më merr malli të vizitoj atë vend dhe nuk ekziston arsye në botë që rruga e Arbrit me aq pak kilometra të mos rregullohet! Është turp që në 2013 Shqipëria ka rrugë pothuajse të pakalueshme!

Besmir Luca, TIRANA, ALBANIA: Duhet që Dibra të mos ngelë prapa në kohë për shkak të zhvillimit të ngadaltë ekonomik të saj...

Bardhul Marku, DIBER, MK, MACEDONIA: E pres me padurim ditën kur Rruga e Arbërit do bëhet realitet, me shpresë se kjo do të mundësojë ringjalljen e Dibrës (se madhe) në Maqedoni. Mbesim me shpresë të madhe se qeveria e ardhshme shqiptare do të bëjë realitet këtë ëndërr të kahmotshme të shqiptarëve në të dy anët e kufirit.

Saimir Torba, TIRANE, ALBANIA: Sepse jam Dibran

Ariton Buxhaku, DEBAR, MACEDONIA: Ekonomia, Transporti, Infrastruktura.

Elvin Kuca, COVENTRY, UNITED KINGDOM: Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Altin Borova, DEBAR, MACEDONIA: Ekonomia.

Rilind Pocesta, DEBAR, MACEDONIA: Dibra është e rëndësishme për mua.

Kujtim Lika, ZERQAN, ALBANIA: Të përfundohet sa më shpejtë kjo rrugë, dhe sipas standardeve europiane, pasi do të luante një rol kyç në zhvillimin e kësaj krahine me mjaft vlera historike dhe shumë të tjera të paeksploruara.

Anduela Kaja, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme për të gjithë shqiptarët.

Ave Peposhi, TIRANA, ALBANIA: Dibra është një qytet i rëndësishëm i lënë mënjanë.

Aziz Banishta, MALMÖ, SWEDEN: Jam dibran nga Dibra e Madhe të përshendes dhe të uroj punë të mbar. Nuk je vetëm mbrapa na ke shtat malet e Dibrës të fala.

Omer Cami, DIBER,MAQEDONI, MACEDONIA: perspektiva e vetme.

Albana Dani, ITALY: është e rëndësishme për mua që rruga të mbarohet, është më mirë të shkosh në shtëpi për dy orë sesa për pesë orë. Faleminderit për gjithçka.

Evzi Skara, DIBRA E MADHE, MACEDONIA: Kjo rrugë apo korridor ka një rëndësi shumë dimensionale sepse i kthehet dinjiteti ekonomiko-social kësaj krahine e cila dikur me pa të drejtë u nda nga Europa dhe e cila mbijetoi nga dinjiteti i lartë moral. Sot është momenti që kjo padrejtësi të tejkalohet dhe sa më parë të përfundon rruga e Arbërit si projekt Kombëtar - Rajonal.

Rigona Perlica, TIRANA, ALBANIA: Sepse është vendlindja ime.

Tiron Jajaga, DIBER E MADHE, MACEDONIA: Është me rëndësi jo vetëm për mua po për çdo qënie e cila në vete mban të paktën një qelizë Dibrani

Blerta Dika, DEBAR, MACEDONIA: sepse Dibra është vendlindja ime.

Pajtim Mashkulli, DIBRA, MACEDONIA: Tani është koha!

Rilind Hasa, DIBER, MAQEDONI, MACEDONIA: Ruga e Arbërit të jetë realitet sa më parë.

Gazmend Lala, ITALY: Sepse jam nga Dibra dhe mendoj që rruga është shumë e rëndësishme për rajonin e Dibrës dhe zhvillimin e saj.

Elona Dika, VAXJO, SWEDEN: Sepse është gjithçka që kanë të rinjtë andej.

Suela Meneri, TIRANA, ALBANIA: Ndaj të njëjtin mendim me Dr. Alption përsa i përket ndjeshmërisë së kësaj çështje.

Ardit Nerguti, TIRANA, ALBANIA: Dibra është vendlindja ime.

Alpin Ollogu, DEBAR, MACEDONIA: Rruga e Arberit!

Vullnet Lleshi, DEBAR, MACEDONIA: Progres

Edmond Bodi, CAMBRIDGE, UNITED KINGDOM: Për të zhvilluar këtë zonë të veriut të Shqipërisë, sepse Shqipëria është nga vendet më të varfra të rajonit...

Ledian Piperku, ITALY: Kjo është rruga e vendlindjes sime...

Drilon Murrja, PESHKOPI, ALBANIA: Për mua është shumë e rëndësishme ndërtimi i rrugës së Arbërit sepse në radhë të parë shkurton distancën. Pastaj në radhe të dytë Dibra do të njohë një zhvillim më të madh ekonomik dhe kulturor. FALEMINDERIT

Irena Roci, ISTANBUL, TURKEY: Sepse "Rruga do të jetë një trase e rëndësishme mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, duke përmirësuar kështu në mënyrë të dukshme infrastrukturën e kësaj pjese të Ballkanit."

Lediana Muça, LIEGE, BELGIUM: Jam lindur në këtë qytet. Është e rëndësishme që qyteti të paktën ka një rrugë dhe ndoshta më shumëm gjëra të mira do të vijnë prej kësaj.

Gadaf Demaj, Београд, SERBIA: Patjetër që ekonomikisht të do ketë zhvillim se pa infrastrukturë nuk ka ecje përpara.

Grisilda Shkurta, PESHKOPI, ALBANIA: Për të ndryshuar diçka për mirë.

Genti Bardhi, TIRANE, ALBANIA: Për fat të keq te gjithë e dinë se është një rrugë shumë e rëndësishme. Po të gjithë parti politike mendojnë vetëm kur janë zgjedhje: (rregulloj aty ku ata duan dhe nuk janë fare për ndihmën e popullit. Të gjithë njësoj janë, kanë në mendje të tyre vetëm të pasurohen dhe jo të ndihmojnë njerëzit ... kjo është politika e Shqipërisë.

Elton Pitarka, KAMEZ, ALBANIA: Është shumë e rëndësishme për zhvillimin e një ndër trevave më të rëndësishme të kombit shqiptar, vendi më i pazhvilluar ekonomikisht sot në Shqipëri. Kjo rrugë do t'i jepte një hov të madh ekonomisë së Dibrës.

Giuseppe Cppalonga, TRENTO, ITALY: E kam parë rrugën dhe kam udhëtuar në të; shumë miq vijnë prej andej.

Leonard Muka, PESHKOPIA, ALBANIA: Sepse kjo rrugë do sjellë një ndryshim rrënjësor në zhvillimin ekonomik të Dibrës .

Linda Baci, ARLINGTON, TX: Jam nga Dibra.

Rezehana Karameti, DEBAR, MACEDONIA: Rruga do të jetë një trase e rëndësishme mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, duke përmirësuar kështu në mënyrë të dukshme infrastrukturën e kësaj pjese të Ballkanit.

Arben Piperku, DEBAR, MACEDONIA: Rruga e Arbërit

Barbara Meçaj, TIRANË, ALBANIA: Dua më të mirën për çdo qytet të Shqipërisë.

Albion Balliu, PESHKOPI, ALBANIA: Do ishte gjeja me e mire për të gjithë Dibranet.

Nejo Kadrija, LONDON, UNITED KINGDOM: Të lidhet kombi dhe të bëhet një I BASHKUAR në një shtet

Florin Buci, KOS, GREECE: Rruga e Arbërit duhet të ishte e para që duhet të ishte ndërtuar në Shqipëri por zvarritjet janë politike i ftoj që këtë peticion ta firmosin jo vetëm dibranët po të gjithë shqiptarët Dibra ka dhënë edhe ka shumë për të dhënë akoma me bukuritë e sajë natyrale mali mund të jetë një prioritet shumë i mirë turistik që të ndihmohet kjo zonë që është lënë në varfëri të madhe .Ta firmosim këtë peticion pa pikëpamje politike për të mirën e këtij qyteti flm.

Alembert Smaci, SPAIN: Është diçka që duhet bërë ose më saktë, duhej të ishte bërë kohë më përpara.

Ina Shehu, DIKU, ALBANIA: Unë jetoj andej.

Blerina Lika, TRECATE, ITALY: Arsyeja pse e nënshkruaj apo e firmosi dhe jam pro ndërtimit të kësaj rruge, sepse do i jepje një zhvillim zonave që kjo rrugë kalon por do lidhte edhe qytetet e Shqipëri sidomos ato të veri Perëndimit me qytetet e Maqedonisë në një mënyrë më të shpejt, dhe do ketë ma vlera një rrugë e tillë e cila ka një histori shekullore d.m.th. antike.

Kenji Yamada, CONCORD, CA: Udhëtimi zgjat nga pesë deri në tetë orë për të arritur në Tiranë nga Peshkopia në rrugën aktuale. E njëjta largësi e drejtpërdrejtë në Kaliforni ku jetoj unë zgjat një orë. Premtimet e të dyja partive kryesore kanë mbetur të paplotësuara për mjaft kohë.

Gent Pocesta, DIBER, MACEDONIA: Sepse jam banor i Dibrës në Maqedoni dhe e vlerësoj Rrugën e Arbrit si një infrastrukturë e rëndësishme që lidh shqiptarët e Maqedonisë me ata të Shqipërisë.

Igli Tomcini, DIBER, ALBANIA: Është e rëndësishme për të gjithë qytetarët e Dibrës.

Engjell Hamzaj, DIBRA, ALBANIA: Dibër

Blerta Bunguri, TIRANE, ALBANIA: Punësim.

Erisa S., TIRANA, ALBANIA: Kjo rrugë është e rëndësishme për shqiptarët dhe jetike për dibranët.

Ermir Omeri, DURRES, ALBANIA: Mbarojeni rrugën.

Flori Gjunkshi, TIRANA, ALBANIA: Zhvillim ekonomik dhe social i Dibrës dhe banorëve të mrekullueshëm të saj.

Safet Kuliqi, KOSOVO SKENDERAJ, SERBIA: Uroj që qeveria ta ketë parasysh këtë Peticion dhe të fillojë me rregullimin e kësaj rrugë.

Naum Prifti, LONG ISLAND CITY, NY: Sepse Rruga e Arbrit është shumë e dobishme për Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Përgatiti për botim dhe përktheu nga anglishtja: **AFRIM KAROSHI**

SHËNIM I REDAKSISË: Komentet janë të pacensuruara. Redaksia ka ndërhyrë në komente vetëm për korrigjime drejtshkrimore. Gjithashtu, në këtë permbledhje janë përfshira vetëm komentet e shënuara në faqen e peticionit në change.org.

Me rastin e 100 vjetorit, 22 shtatorit 1913, fitores historike dibrane

Viti i madh i trimërisë dibrane, shtator 1913

Në vend të një letre të hapur për drejtuesit e bashkive dhe komunave, këtej dhe andej kufirit shqiptaro-shqiptar, DY DIBRAVE...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Sapo kaluam një vit të madh, vitin jubilar të 100 vjetorit të Pavarësisë Kombëtare. E festuam, e përkujtuam ashtu siç dimë ta festojmë e kujtojmë ne shqiptarët. Nuk dua të hedh dritë mbi këtë, ngjyra gri i shkon më mirë. Veçse një gjë ma drithëroi trupin dhe nuk më vjen pa e thënë. Njëqind vjetorit të Pavarësisë i munguan dy njerëz të mëdhenj, Bajram Curri dhe Elez Isufi, gjeneralët më të mëdhenj populllorë historikë pas Gjergj Kastriotit- Skënderbeut. Nuk dëgjova të flitej për ta, të ngrihej ndonjë lapidar apo monument në vendet ku ata kishin luftuar në ditët më të vështira të popullit shqiptar, ditët e pas Londrës - Korrik – 1913, ditët e pas Konferencës së Paqes – Janar 1919. Arsyet pse ata mbetën jashtë Vlorës 2012, jashtë 100 Vjetorit të Pavarësisë njeri (Bajram Curri) me titullin e lartë "Hero i Popullit" dhe tjetri (Eles Isufi) me "Urdhrin për veprimtari patriotike Klasi II, (dekorime të kohës komuniste) ndërkohë që ata me forcat e veta malësore po mbronin kufijtë lindorë të Shqipërisë nga serbi, duhet ti kërkojmë tek Bulevardi Zogu I dhe monumenti në krye të tij. Arsyet pse Haxhi Vehbi Dibra (Agolli), Ismail Strazimiri, Dom Nikoll Kaçorri, Jusuf Xhelili e të tjerë mbetën vetëm me urdhrin "Për veprimtari patriotike" Klasi III të akorduar në 50 – Vjetorin e Pavarësisë (1962), nga koha komuniste, duhen kërkuar më tepër poshtë (në vendlindje dhe vendtrimëritë e tyre) se sa lart.

Nuk do të ndalem në këtë as edhe në aspekte të tjera të historisë së Dibrës. Më mirë se i ka shkruar Kristo Frashëri në "Historia e Dibrës" vështirë se do të gjendet historian dibran ti përshkruaj e dokumentojë.

Dëshiroj që për 100 vjetorin e kryengritjes së madhe populllore të shtatorit 1913, në pozicionin e gazetarit, ti hedh një sy njërit prej blloqeve të jetës time (me vete edhe në mërgim), shënimet e nxjerra nga disa gazeta të kohës kur mu desh të kumtoja në një sesion historik në kuadrin e 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Shpresoj që këto shënime (dhe të tjera që do të përcjell nga mërgimi ku jam ngujuar tash 17 vjet) ti vlejnë thirrjes sime qytetare për përkujtimin me madhështi të Kryengritjes së Madhe Populllore Dibrane të 22 Shtatorit 1913, ngritjes së monumenteve përkujtimore në Dibër të Madhe dhe në mbarë Dibrën, vlerësimit të "gjeneralëve" të mëdhenj populllorë por edhe të "ushtarëve" populllorë pesë prej të cilëve "Përlindja e Shqipëniës" – Organ për me Mbrojtur të Drejtave Kombëtare i Qeverisë së Ismail Qemalit i cilësonte "... dëshmorë për lirimin e atdheut të vet, të cilëve historia meriton t' i shkruajë emnat e tyne për një kujtim të përjetshëm..."

Kristo Frashëri shkruan se "...më 22 shtator 1913...malësorët së bashku me fusharakët sulmuan në mënyrë të rrufeshme Shehrin, i cili mbrohej nga katër batalione serbe. Sulmi qe aq i rreptë sa ushtria e armikut u shpartallua brenda disa orëve...Me hyrjen e kryengritësve në Shehër, të gjithë dibranët e burgosur u liruan. Në qytetin e çliruar të Dibrës, u ngrit flamuri kombëtar shqiptar..." (Kristo Frashëri, "Historia e Dibrës" f.339)

22 Shtatori 1913 mbetet një ditë e shënuar për Dibrën dhe dibranët.



Vit' i I, N. 25. Një numër 20 pare. E Shtunë 9/22 Vjesht' e III, 1913.

PERLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJT[illegible]T KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Drejtuar i përgjegjshëm: D. BERATTI.

DREJTIMI: "PERLINDJA E SHQIPËNIËS" VLONË

PAJTIMI: NË SHQIPËNI. PERJASHTA:

PROPOZIM NGA DR. SELMAN MZIU

THIRRJE PËR BASHKËRENDIM

Të shtrenjtët dibranë, nga do që jeni, në çdo kënd të Dibrës dhe të rruzullit të dheut.

I shtyrë nga thirrja përkushtuese e dokumentuese e gazetarit Abdurahim Ashiku, të cilin duhet ta mbështesim të gjithë për idetë e shtruara dhe propozimet për organizimin e festimin e 100 vjetorit të KRYENGRITJES DIBRANE KUNDER SERBEVE, ju bëj thirrje:

1- Hartimi i programeve të organeve shtetërore e shoqatave të ndryshme nga qendra në bazë, të dy DIBRAVE Të PANDARA për veprimtari, kulturore, artistike, botuese etj.

2- Shtypi dibran, gazetat "Rruga e Arbërit", "Dibra" dhe të gjitha organet e tjera në Shqipëri e jashtë vendit, t'iu japin përparësi botimit të materialeve të ndryshme mbi historinë e këtyre ngjarjeve.

3- Muzetë në Peshkopi e Dibër të Madhe, të gjejmë burime investimi që ato të të mund të kontribuojnë më shumë në sistemin e tyre, mbledhjen e materialeve të ndryshme, botime, sesione shkencore etj.

4- Kompozitorë, muzikantë, shkrimtarë, gazetarë, historianë skulptorë, të bashkërendojmë veprimet tona të përbashkëta për të ndriçuar këtë periudhë të vrullshme historike, me forma e mënyra të larmishme, brenda vendit dhe jashtë tij.

5- Investitorë të shumtë dibranë ngado që janë të ndihmojnë me investime në fushën e botimeve, skulpturës, muzikës, pikturës etj. Vetëm kështu shprehet patriotizmi dhe çimentohen uniteti i brezave në trevën dibrane.

6- Shoqatat të bashkëpunojnë në veprimtaritë e ndryshme, të marrin iniciativa të kategorive të ndryshme për të kontribuar në festimin sa më dinjitoz të këtij 100 vjetori.

Dibra duhet të bashkohet e tëra, me natyrën dhe njerëzit që të krijojë një atmosferë të tillë feste, veprimtarishë patriotike, me ane të shtypit, radiove, televizionit, internetit e gjithçkaje të mundshme për të kremtuar madhërishëm 100 vjetorin e kryengritjes së madhe kundër serbëve.

Firence, 27 prill 2013

22 Shtatori i vitit 1913 shënon 100 vjet larg dhe afër Tij.

Po cila ishte jehona e Kryengritje Populllore Dibrane për të mbrojtur kufijtë e vet historikë, për të mos lejuar prerjen për palce të trojeve shqiptare, për të mos lejuar që "qendra gjeografike shqiptare" të mbetej nën pushtues barbarë?

"Përlindja e Shqipëniës" në numrin 15, Vjeshtë e parë 1913, nën titullin "Luftimet e shqiptarëve kundër serbianëve" shkruan:

"...Ka prej disa ditësh, që kur malësortë përgatiteshin kundër serbëve. T'ardhur në ato male plot famë e nder, për t'i shporrur s'andejmi egërsirat që jetojnë në mes t'Evropës qytetore; kur para katër ditësh i bien befas armikut, e dëbojnë nga toka shqiptare këtej Drinit, nga katundi Zirqanit dhe një tjetër tufë luftarësh, i bie nga pas. Më të nesërmen malësorët i rrasen Dibrës brenda. ..

Me gëzim të madh luftëtarët tanë ngritën flamurin e Shqipëniës në vendet që zaptuan. Qytetet qeverisen prej një komisie populllore, të cilat janë formulum prej myslimanësh e të krishterësh... Ma parë se të vijnë luftëtarët në Dibrë, ushtria sërbe burgosi tetëdhjetë veta nga parësia e vendit, me qëllim që t'i vrasin me të nesërmen. Kur i rradhuan me i pumbos, i arritën malësorët, andaj s'munden me i vra të gjithë por veç pesë shpirt.

Këta janë ata që ranë dëshmorë për lirimin e atdheut të vet, të cilëve historia meriton t'i shkruajë emnat e tyne për një kujtim të përjetshëm: Sheh Hyseni, Sadullah Strezimiri, Ramiz Beu, Karafil beu, Numan Efendiu. U ndritët shpirti." Ajo që të bën përshtypje është se "telegrafi i Vlorës" në shërbim të gazetës "Përlindja e Shqipëniës" dhe të Qeverisë së Ismail Qemalit ka qenë aq pranë Kryengritjes Populllore Dibrane sa përbën vlerësimin maksimal për këtë ngjarje të madhe. Por jo vetëm "Telegrafi i Vlorës por edhe "Telegrafi i Evropës", madje edhe ai i përtej Atlantikut.

Gazetat "Giornale d'Italia", "Wiener Alge meine Zeitung", "Neue Freie Presse" "Lirija e Shqiperisë", "Atdheu", "Taraboshi", "Dielli", "Shqypnia e re"... japin në numra radhazi tablo të gjera të trimërisë së dibranëve, citojnë me emër e mbiemër, me adresë qytetesh e fshatrash, njerëz të popullit në rezistencën e madhe për të mos lejuar që serbi të bëhet zot shtëpie në tokën e Kastriotëve.

Herë tjetër do tu shkoj shënimeve të mija deri në fund në adresa të plota për studiues të kësaj periudhe. Kësaj radhe po ndalem vetëm tek të "pestët", "...ata që ranë dëshmorë për lirimin e atdheut të vet, të cilëve historia meriton t'i shkruajë emnat e tyne për një kujtim të përjetshëm". Emrat e " Sheh Hysenit, Sadullah Strezimirit, Ramiz Beut, Karafil Beu dhe Numan Efendiut" janë të njohur në Dibër, kanë pasardhës, djem e vajza, nipër e mbesa, stërnipër e stërmbesa, në qytetin e Dibrës së Madhe, në Peshkopi, në Tiranë, në Evropë e Përtejoqeanit. Njeri prej tyre (që njoh unë) Sheh Hysejni, la pas tre djem e tri vajza gjakun e të cilëve e gjen sot të shpërndarë në një pemë të madhe gjenealogjike në Tiranë, Durrës dhe Evropë në fiset Shehu, Zeraliu, Jareci... Emra të tjerë, me gjithë mjetet tepër të varfra të komunikimit me shtypin e kohës, kanë arritur të bëjnë vend faqeve të gazetave të Evropës mbarë, të flenë në dosje diplomatësh e në blloqe shënimesh udhëtarësh, ndër ta edhe të Zotit dhe Zonjën Kenedi në udhëtimin e tyre nëpër Gollobordë...

Të pestët (emrat e të cilëve shkruhen me respekt në shumë gazeta të tjera) - Sheh Hyseni, Sadullah Strezimiri, Ramiz Beu, Karafil Beu dhe Numan Efendiu janë pushkatuar në "këshlla" siç i thonë dibranët, në kazermat serbe ku ishin burgosur. Dihen emrat, dihet edhe vendi, për ndonjërin (siç më ka treguar i biri) dihet edhe vendvarrimi.

Për ta (dhe të tjerë) në anën tjetër të kufirit shqiptaro-shqiptar, në Dibër të Madhe, para viteve '90-të nuk mund të flitej pa pas fatin e tyre, burgosjen (më e vogla) apo pushkatimin.

Sot ka ardhur koha jo vetëm të flitet por edhe të bërtitet.

Sot ka ardhur koha që për "të pestët" të ngrihet një monument pikërisht në vendin ku derdhën gjakun.

Sot "Vorret e Shehitëve" në Ceren duhet të rregullohen e në një obelisk me sfond Korabin të shkruhen tridhjetë e ca emrat që përmenden në një gazetë pak muaj pas pushkatimit barbar të tyre...

Sot ka ardhur koha që në Dibër dhe zonat e tjera tej kufirit shqiptaro-shqiptar të ngrihen obeliskë me emrat e njerëzve që ranë në fushën e betejës, që u martirizuan barbarisht, u dhunuan, u grabitën, u detyruan të ikin nga vendlindja për tu vendosur në Tiranë, Elbasan, Peshkopi, Turqi e larg e larg në kontinentin amerikan...

Kohë më e mirë për vlerësimin e njerëzve që shkruan trimërinë dibrane në vitet 1912-1922, në ruajtje dhe mbrojtje të truallit të të parëve se sa 22 shtatori i vitit 2013, NJËQIND VJETORI I KRYENGRITJES POPULLORE DIBRANE KUNDËR SERBIT, nuk vjen më.

E gjykova ta paralajmëroj 100 VJETORIN, thjesht si dibran që e do vendlindjen dhe vendrritjen e vet, si gazetar në mërgim që i digjet shpirti për Dibrën. Mbase të dy Dibrat e kanë menduar dhe kanë bërë programe për veprimtari dhe vlerësime të figurave që bënë histori njëqind vjet më parë. Do të gëzohesha të isha i pranishëm dhe të jetoja emocione ashtu siç i jetova më 13 dhjetor të vitit 1982 kur kumtova në Konferencën Shkencore-Historike "Mbi luftën çlirimtare të Dibrës në vitet 1912-1921" si pjesë e Lëvizjes Kombëtare për Lirinë e Pavarësinë e Shqipërisë me temën "KRYENGRITJA E DIBRANËVE - SHTATOR 1913, NË SHTYPIN E KOHËS".

Në qoftë se zgjedhjet (për pushtetin vendor në Dibër të Madhe e më gjerë dhe për pushtetin qendror në Shqipëri) e kanë anashkaluar vëmendjen nga 100 Vjetori i Dibrës, dua të them se nuk është vonë që ti marrim kohës së mbetur minutat e çmuara dhe ti ngremë një përmendore të madhe trimërisë dibrane në dhjetëvjeçarin e dytë të shekullit të kaluar.

Dëshiroj që këto radhë ti lexojnë drejtuesit vendorë në Dibër të Madhe, Strugë, Gostivar etj. ku është shkruar në kujtesën njerëzore historia e kohës, dëshiroj që drejtuesit e bashkisë së Peshkopisë dhe Bulqizës dhe drejtuesit e komunave nga Golloborda në Luzni, Reç, Dardhë, Lurë, Sllovë, Kala të Dodës etj. të ulen e të programojnë përkujtimin e 100 Vjetorit të fitores së Dibrës me një madhështi që nuk është parë kurrë.

Shpresoj shumë në vullnetin dhe dëshirën e madhe të dibranëve, në atdhetarizmin e tyre, vlerë e madhe trashëguese ndër shekuj.

Athinë, 22 prill 2013

Rruga e Arbërit nr. 84

opinion



Pak bëjmë për vendlindjen

Nga **Mr.PETRIT FETAHU**

Dibra po zbrazet, ikin të rinjtë, ikin të shkolluarit, të diturit, dhe vargu i mërgimtarëve si vjen bëhet më i gjatë dhe i pafund, ndërsa i të ardhurve të tjerë si vjen edhe shtohet, sa një ditë Dibra s'do të jetë e dibranëve. Por Dibra i përket dibranëve dhe dibranët janë ata që duhet ta ruajnë, ta mbrojnë e ta ndërtojnë, se përndryshe një ditë me këtë rrjedhë s'do t'u takojë atyre.

Dibra është e mbërthyer nga kriza ekonomike, politike, sociale, arsimore, individuale dhe kolektive që ja kanë humbur shkëlqimin e dikurshëm, rahatinë, gjallërinë e të impresionimit, por edhe begatinë e mëparshme. Andaj thuhej: "Të digjej Stambolli, Dibra e ndërtonte", dikur e madhe, qendër zhvillimit, e tregtisë midis Lindjes dhe Perëndimit, përkrah rrugës Via Ignacia, me punishte artizanale, shajakbëres, qilimendës, me hane dhe bujtina, me fshatra të ngritura qark, ku ndëgjohej fyelli, arnite vlonin nga prashitësit, korrëtarët e kosëtarët, ku derdhej lum bylmeti dhe hapeshin zemrat ne odat e mikpritjes, qendër kulture, arsimi e emancipimi, i zgjimit, që dha mjaft intelektualë me zë, krijues si Haki Stërmillin, Faik Ballanca, Haki Sharofin e shumë të tjerë, sot është katandisur keq. Toka u tha, kanalet u shkatërruan ndërsa pompat u vodhën. Ajo po varfërohet, po i len rrugëve apo po i përzë intelektualët, të shkolluarit, magjistrat, pasi si ka mbetur uzinë, si ka mbetur fabrikë, që dikur oxhaqet e tyre e mbulonin qiellin me blozë e rrugët pushtoheshin me zhurmën e atyre që i mbushnin punëtoritë. Mengjesi më hapet me heshtjen dëshpëruese të sheshit të boshatisur, tek-tuk lëviz ndonjë për të shërbyer si kamarier në ndonjë bufe, ndërsa diploma me nota me të larta është pluhërosur në qyler, ngase askush s'mund t'u sigurojë një page qoftë edhe minimale. Ndaj sot ikin të rinjtë, ikin të shkolluarit, ikin kuadrat, zbrazin qytetin dhe e lënë pa të ardhme, pa perspektive, pa jetë, vine të tjerët të huaj që s'na përkasin ne. Ikjet janë të përditshme, saqë është u krijuar një Dibër tjetër në mërgatë. Dhe sot lagje tëra pësuan transformime demografike, nga dhjetë dyer, shtatë 7 janë të tyre e në të ardhmen s'do të ketë asnjë prej nesh. Ndaj një mendimtar ka thënë: "Një komb humb kur ai nuk reagon ndaj fanfares, dekadenca është vdekja e trumbetës"(Cioran)

Dibra është plandosur keq, e ka mbështjellë jeta e rëndë shoqërore, varfëria, papunësia, emigrimi, dhe kriza kombëtare, sa ka humbur frymëmarrjen, impenjimi, reagimet e angazhimet e dikurshme, ka ra ne apati dhe gjumë. S'është ajo Dibër e dikurshme e zërit të ngritur, e zërit të Nëntë Maleve, që s'duronte kurrë shtypje, s'duronte padrejtësi, s'duronte shfrytëzim, nëpëkëmjen e të drejtave nacionale, por me ngulm e mbronte flamurin, siç thotë një këngë e këtyre anëve "në ballin tand shqipja e flamuri". Dibra e Kongresit të e vititi 1909, e Salë Markes, Lam Dacit, Sait Najdenit, Josif Bagerit dhe e shumë të tjerëve, atë e ka kapluar indiferenca, servilizmi, interesi, korrupsioni, pangopësia, është bërë i epshëm për kolltuk dhe pasuri. Devijimet janë gjithandej dhe në çdo sferë shoqërore. Punësimi bëhet sipas librezave partiake apo lidhjeve të ndryshme fisnore apo përmes mbushjes të xhepave, zënë karrige apo edhe pozita individë pa aftësi profesionale, me shkollim të mesëm, me diplomë të marrë shkel e shko, aq më keq raste të tilla kemi edhe në arsim, në degët e universitetin të qytetit që është shndërruan në prone të personi me kudra të pakualifikuara, që do ta mbajnë peng zhvillimin dhe prosperitetin e këtij qyteti, duke anashkaluar ata persona të talentuar me kualitet e bagazh arsimor e shkencor, intelektualë të mirëfilltë, magjistra, doktorë, me vizion që do të kontribuonin dukshëm pë t'i dhënë kahje zhvillimit dhe për ta nxjerrë nga kriza mbërthyese, ndaj duhet të vine persona të aftë, kualitativ, me strategji, me synim dhe vizion, me patos atdhetar, me energji të reja, me tipare moraleetike dhe jo destruktivët, qe kanë para një pseudo, jo vazalët dhe hafijet, ata që hynin e dilnin në "godinën e zezë" apo i lagnin "shpesh këmbët në Dri".

Ndaj Dibra po zbrazet, ikin të rinjtë, ikin të shkolluarit, të diturit, dhe vargu i mërgimtarëve si vjen bëhet më i gjatë dhe i pafund, ndërsa i të ardhurve të tjerë si vjen edhe shtohet, sa një ditë Dibra s'do të jetë e dibranëve. Por Dibra i përket dibranëve dhe dibranët janë ata që duhet ta ruajnë, ta mbrojnë e ta ndërtojnë, se përndryshe një ditë me këtë rrjedhë s'do t'u takojë atyre.

Politikanët vijnë e shkojnë. Sa vine zgjedhjet nga tribunat derdhen premtimet, saqë e bëjnë qytetin "bahçe me lule", ndërsa banorëve ua hapin parajsën, por sa ikin dhe marrin votat mandej s'ven dorë askush për asgjë. Premtimet i merr era, tablot e zymta mbesin të njejta. Po ai gjimnaz me barakë të skaduar të ndërtuar nga italianët pas tërmetit, po ato rrugë me gropa, po ajo etje për ujë në kohë vape etj. Dikur zëri politik i tij shkonte gjer në Stamboll dhe Beograd dhe e trondiste tërë Ballkanin, sot ai është i heshtur, i pafuqishëm dhe mospërfillës, jo për fajin e veshëve të shurdhuar, por për fajin e dibranëve që janë të heshtur, zëri u është shterur, ndërsa guximi u është mekur.

Dibra kishte edhe dy deputetë, asgjë s'i sollën qytetit. Dibra kishte ministrin e transportit, asnjë metër rrugë as zgjeroi e as shtroi me asfalt. Përsëri asnjë zë nuk dëgjohet për Dibrën në parlamentin e ftohët. Dibrën politika e pandërgjegjshme dhe apatike e ndau në dy zona zgjedhore, një pjesë të votojë për qytetin, tjetra për Strugën. Kështu anomali dhe absurditetet s'gjejmë askund në botë, iu muar Zhupa dhe krahina u ngushtua, s'është ajo e mëparshmja që shtrihej gjer në Mavrovë. Tash më s'i ka mbetur të ketë edhe deputet në parlament. Gjygjit të Dibrës që shqyrtonte shumë lëndë edhe ato penale, iu hoq e drejta edhe e shumë shumë proceseve gjykuese, kaluan në kompetencat e gjyqit të Gostivarit, edhe një pjesë e ingerencave iu muarr nga enti i financave dhe kaluan në Tetovë, ndërsa EVN i zbrazi zyrat e nëpunësve, pasi i transferoi në Strugë, dërsa elektricistët i dërgoi në asistencë. Spitali ka mbetur pa specialistë. Dibranët janë të detyruar për ndërhyrje të vogla të marrin rrugën për Shkup apo Tiranë. Kështu sot Dibra më tepër i përngjan një fshati se sa qyteti. Gjithashtu edhe pushteti nuk është i interesuar të investojë. Tërë projektet e huaja shkojnë në qytetet e banuara nga maqedonasit, saqë po të bësh një krahasim midis tyre dhe Dibrës kane diferencë si dita me natën, s'është bërë asnjë investim. Qëllimisht Dibra është lënë si gangrene nga pushtetarët, që popullata të shpërngulet e qyteti të zbrazet nga shqiptatët. Kjo argumentohet edhe me fjalë të thëna nga Kryemistri Gruevski se "shqiptarët jo lojal le te shkojnë në Shqipëri". Këtë më tepër do ta realizojë në këto anë të shkëpusë lidhjen territoriale dhe shpirtërore të shqiptarëve jashtë shtetit amë. Kjo dëshmon se shovinzmi është i fuqishëm dhe agresiv, aq më tepër ngase dikur ky qytet ishte barut e flakë, që e dridhte tërë Evropën, ndaj don të gllabërojë çdo gjë që është shqiptare, por me një formë të ngadalshme, perfide dhe hipokrite, ndërsa partitë shqiptare janë mjaft indiferente, tolerante dhe pasive ndaj kësaj politike konstante dhe imanente, kur preken interesat kombëtare, si zvogëlimi i dimensioneve të flamurit tone kombëtar, të përdorimit të gjuhës shqipe si gjuhë shtetërore, të punësimit, ndarjes të investimeve dhe të projekteve etj. Që kërkon krejtësisht të krijohen raporte të tjera midis dy palëve ngase Marrëveshja e gjer tanishme nuk dha asnjë rezultat, edhe pse nga demokratizimi i shoqërisë kanë kaluar më tepër se njëzet vjet. Ndaj angazhimi dhe kontributi i dibranit duhet te jetë më aktiv, nëse tradita historike dhe intelektuale i krijon një prioritet të tillë.

Shkruaj opinionin tënd!

ME KURAJO DHE GUXIM!

jep ndihmën tënde në përhapjen e së vërtetës

email: rrugaearberit@gmail.com

Përkujtohet 100-vjetori i Haxhi Lleshit

Nga **ESMERALDA ILNICA**

Ka qenë kryetari i shtetit shqiptar që ka mbajtur më gjatë këtë post, nga viti 1912 e deri më sot dhe vështirë se do të ndodhë më një jetëgjatësi e tillë karriere. Për gati 30 vjet (1 gusht 1953 - 21 nëntor 1982), Haxhi Lleshi ishte në krye të Presidiumit të Kuvendit Popullor, por dje nuk u kujtua vetëm si politikan. Në 100-vjetorin e lindjes, familja ishte kujdesur që të organizonte një aktivitet modest në kujtim të tij, por situata doli nga kontrolli. Për mirë! Me të ftuar e të paftuar, salla e katit të dytë të Qendrës Kulturore të Ushtrisë në Tiranë u tejmbush nga pjesëmarrësit, shumë prej të cilëve mbetën në këmbë apo jashtë dyerve duke ndjekur me vështirësi ceremoninë. Herë pas here kishte ndërhyrje euforike me thirrjet "Përjetë Haxhi Lleshi!", "Rroftë Haxhi Lleshi!", "Haxhi Lleshi hero" etj, ndërsa duartrokitjet vijonin gjatë dhe të përsëritura. Dikush puthte fotografinë e tij e dikush tjetër e mbante shtrënguar fort në kraharor. Secili prej tyre kishte për të treguar një histori personale me Haxhi Lleshin, duke ia bërë paksa të vështirë moderimin e aktivitetit studiuesit Demir Osmani. Në morinë e këtyre lëvizjeve dhe nën tingujt e muzikës me motive dibrane, që është edhe vendlindja e Haxhi Lleshit, një personazh i njohur u drejtua në podium duke ngjallur kureshtje të madhe, por edhe heshtje në sallë. Ishte Sabit Brokaj, i cili në cilësinë e mjekut të "Bllokut" që ka ndjekur patologjinë e sëmundjes së Haxhi Lleshit, foli për ish-kreun e shtetit jo vetëm si pacient, por edhe si mik të tij. "Ndryshe nga të gjithë ish-funksionarët e tjerë të lartë, Haxhiu ka qenë i vetmi që më përcillte personalisht deri te porta e jashtme e vilës", tha ai, duke "i çuar në ajër" pjesëmarrësit, që u ngritën në këmbë për ta nderuar. Për gati 4 orë, situata vijoi e njëjtë me fjalime dhe duartrokitje, ndërsa ashtu si entuziazmi, binin në sy edhe eksponentë të politikës e figura të tjera publike. Socialistët Gramoz Ruçi dhe Shkëlqim Cani ishin ulur ngjitur në rreshtin e dytë të karrigeve, ndërsa pak më tutje pikasje ish-kreun e SHIK-ut, Fatos Klosi. Ish-ministri i Shëndetësisë, Mustafa Xhani, ishte në anën tjetër të sallës, por në cilësinë e familjarit, pasi ai është bashkëshorti i vajzës së Haxhi Lleshit. Ish-kreu i Presidiumit Popullor ndërroi jetë në vitin 1998.

Veteranët e LANÇ-it qanin si fëmijë kur përmendej emri i Haxhi Lleshit, edhe pse rrëfimet e kohës së luftës i mbushin me fraza trimërie. Në emër të tyre, kryetari i Komitetit Kombëtar të Veteranëve tregoi për Haxhi Lleshin si pjesëmarrës aktiv dhe një nga drejtuesit kryesorë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Më pas, ai bëri një rezyme të shkurtër për atë si ministër i Brendshëm i Shqipërisë, me mandat nga 22 tetori i vitit 1944 gjer më 10 janar të vitit 1946, si pjesë e kabinetit të Enver Hoxhës (22 tetor 1944 gjer më 10 janar 1946). "Ka qenë ministër i Brendshëm i Shqipërisë nga 11 janari i vitit 1946 gjer më 18 mars të vitit 1946. Më pas, president i Shqipërisë (Presidiumit të Kuvendit) prej 1 gushtit 1953 deri më 21 nëntor 1982", tha Rustem Peçi, duke shtuar më pas sqarimet për çdo post të tij. Por më me detaje foli dr. Laurant Bica, duke lexuar një studim të plotë me titull "Rreth figurës së Haxhi Lleshit". Ndërsa për origjinën e ish-kryetarit të Presidiumit Popullor mbajti referim i afërmi Bashkim Lleshi, duke treguar për prindërit dhe familjen e Haxhi Lleshit. Fjalimet ndoqën njëri-tjetrin të "dirigjuara" nga Demir Osmani, studiuesi dhe patrioti i Haxhi Lleshit, ndërsa në podium u shfaqën me radhë miq bashkëkohës dhe historianë, si: Zeqi Agolli, Sul Domi, Xheladin Krefca, Hilë Lushaku etj. Ata theksuan se Haxhi Lleshi ka qenë një nga tre njerëzit më të fuqishëm të regjimit komunist, krahas Enver Hoxhës dhe



Mehmet Shehut dhe vunë në dukje se ai ka mbajtur këto dekorata e medalje: Medaljen e Kujtimit; Medaljen e Çlirimit; Urdhrin "Ylli i Kuq"; Medaljen e Trimërisë; Medaljen "10-vjetori i ushtrisë"; Urdhrin "Ylli Partizan" i klasit të parë; Urdhrin e Trimërisë; Urdhrin e Flamurit; Urdhrin e Lirisë të klasit të dytë; Urdhrin e Lirisë të klasit të parë (më 1 maj 1958 kur festoi 45-vjetorin e lindjes); Urdhrin e Lirisë të klasit të parë (me dekret nr.7337, datë 13.11.1989); Titullin "Hero i Popullit", me vendimin nr.142, datë 27.4.1963, të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, akorduar me rastin e 50-vjetorit të lindjes etj. Po kështu, ai është dekoruar nga Velimir Stojniç me medaljen "Ylli Partizan", në vitin 1947, të cilën Lleshi e ka quajtur shenjë vëllazërimi midis dy popujve kundër të njëjtëve armiq. Haxhi Lleshi është zgjedhur kandidat në Komitetin Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë në kongresin e parë të saj dhe është rizgjedhur kandidat edhe në kongresin e dytë, ndërsa në kongresin e tretë të Partisë së Punës është zgjedhur anëtar i Komitetit Qendror të Partisë dhe në vijim është zgjedhur në këtë funksion edhe në kongreset pasardhëse të saj. Figura e tij plotësohet më tej si i zgjedhur deputet i Kuvendit Popullor në të gjitha legjislaturat e tij. Haxhi Lleshi është liruar nga detyra e lartë e kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor më 21 nëntor 1982, afërsisht 30 vjet pas marrjes së detyrës, ndonëse në kremtimin e 60-vjetorit të lindjes Enver Hoxha i pati premtuar: "...Ju do të qëndroni përjetësisht në detyrën e kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor". Pas kësaj rezymeje, të pranishmit bënë një apel për qeveritarët "që të mos ngurojnë, por t'u bëjnë nder institucioneve duke pagëzuar rrugë, objekte apo institucione me emrin e nderuar 'Haxhi Lleshi'".

PËRSHËNDETJE NË EMËR TË FAMILJES NGA RESHITI, DJALI I HAXHI LLESHIT:

Reshit Lleshi ka qenë tejet emocional në kujtimin e të atit, me të cilin jetoi i ndarë që në vitin 1976. Edhe pse u dërgua në internim në Mollas të Elbasanit, së bashku me të ëmën, Haxhiren, në 100-vjetorin e lindjes së babait u përpoq të thoshte pak fjalë në kujtim të tij. "Falënderoj Rustem Peçin dhe të gjithë të ftuarit e të pranishmit në këtë aktivitet përkujtimor në nder të babait tim. Më 7 prill 1939 erdhën në shtëpinë tonë krahu i djathtë i Ahmet Zogut, Abaz Kupi, Murat Basha, Murat Kaloshi, Shaqir Dema etj., me qëllim bashkimin për luftë dhe çlirimin nga pushtuesit fashistë. Abas Kupi për miqësinë e vjetër që kishim në vitet 1941-1942 na strehoi së bashku me nënën timë në Krujë; Haxhiu u martua me Haxhirenë nga fisi Jegeni, që njiheshin qysh në vitet '30 të shkullit të kaluar. Por në vitin 1951, kur ndodhi "bomba në Ambasadën sovjetike", mes njëzet e dy të pushkatuarve, ishin edhe dy vëllezërit e Haxhires, Myftar e Gafur Jegeni (36 dhe 43 vjeç). Që të dy kishin mbaruar Akademinë Ushtarake në Itali dhe, më 7 prill 1939, patën marrë pjesë, bashkë me Abaz Kupin, në rezistencën kundër pushtimit fashist. Kjo ishte edhe pjesa që u përpoq të tregojë Reshiti në ceremoninë e 100-vjetorit, por pa mundur dot vijimin. Pas kësaj tragjedie, Haxhi Lleshi pranoi që bashkëshortja Haxhire dhe i biri, Reshiti, të internoheshin në Mollas të Elbasanit. Haxhirja ndërroi jetë më 17 tetor 1985, kurse Haxhi Lleshi më 1 janar 1998.

TRE DREJTUESIT E PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR

Me përfundimin e Luftës II Botërore dhe çlirimin e Shqipërisë më 1944-n, u zhvilluan zgjedhjet e para parlamentare në dhjetor të vitit 1945 dhe funksioni i kryetarit të Shtetit u kalua në organ kolegjial, si Presidium i Kuvendit Popullor. Gjatë periudhës kohore 11 janar 1946 – 12 dhjetor 1990, kur përfundon regjimi njëpartiak e diktatura komuniste, funksionet e kryetarit të Shtetit u kryen nga Omer Nishani (10 janar 1946 - 1 gusht 1953), Haxhi Lleshi (1 gusht 1953 - 21 nëntor 1982) dhe Ramiz Alia (22 nëntor 1982 – 22 shkurt 1991).

KONTRIBUTI NË LANÇ

Haxhi Lleshi ka dhënë kontribut në historinë e krijimit të Partisë Komuniste, si dhe të disa brigadave partizane: Brigada IV Sulmuese, në bashkëpunim me Teki Kolanecin, komandant i çetës së parë partizane të Korçës, të Gorë-Oparit dhe Raqi Qirinxhiun; Brigada V Sulmuese, krijuar më datë 15 janar 1944, në Sheper të Zagorisë, të cilës i dërgoi me korrier përshëndetjen në emër të Shtabit të Përgjithshëm; brigada VII Sulmuese, më 17 mars 1944, në Vlushë, ku pati përkrah Bedri Spahiun, Ymer Dishnicën e Medar Shtyllën në çastin kur i ka dorëzuar flamurin luftarak komandantit të brigadës, Gjin Markut. Ai la emrin e tij edhe në përurimin e Brigadës XII Sulmuese, në Sukë të Përmetit, më 18 maj 1944, duke qenë i deleguar i Shtabit të Përgjithshëm.



KARRIERA SI PRESIDENT

Haxhi Lleshi njihet firmëtar në dekretet e periudhës 1953-1982, në stimujt e titujt e nderit të njerëzve të shquar, dëshmorëve e njerëzve të dalluar në punë, në letërkëmbimet protokollare e në çdo përvjetor të festave kombëtare me kryetarë shtetesh. Ai ka nënshkruar aktet e gjykatave për dënimet kapitale dhe miratimet e lënies apo fitimit të nënshtetësisë shqiptare. Në pleqërinë e tij të thellë Haxhi Lleshi nuk ishte një person që ngeli jashtë vëmendjes politike, ndonëse kishte vite i pensionuar, por në shkurt 1991 Ramiz Alia e përzgjodhi atë midis shumë të tjerëve në të ashtuquajturin "këshill presidencial". Më 31 mars 1991, veterani Haxhi Lleshi u zgjodh deputet në emër të Komitetit të Veteranëve. U burgos në vitin 1996, për t'u amnistuar e liruar rreth një vit më pas. Ndërroi jetë në vitin 1998.

HILË LUSHAKU: NJOHJA ME DOKUMENTE

Hilë Lushaku është një nga studiuesit e historisë së Policisë shqiptare me disa libra, por që i ka kushtuar veçanërisht një botim Haxhi Lleshit. Gjatë ceremonisë së të shtunës për 100- vjetorin e lindjes së Haxhi Lleshit, ai tregoi në monitor dokumentet që kishin të bënin me jetën dhe veprën e ish-kreut të Presidiumit Popullor. "Janë të shumta dokumentet që dëshmojnë se Haxhi Lleshi antizogist e antifashist u kthye nga emigracioni në Dibër në mars 1941 dhe iu bashkua idealit kombëtar për çlirim. Dokumentet italiane dhe historiku i Dibrës provojnë se natën e 4 prillit 1941, me 300 burra të armatosur, Haxhi Lleshi sulmoi forcat ushtarake italiane të divizionit "Firence", të cilëve u rrëmbyen shumë armë, municione, ushqime e veshmbathje. Aktiviteti atdhetar i tij në vitet 1941-1942, për të mbjellë farën e bashkimit e të besës në krahinën e Dibrës, provohet me dokumente të botuara prej komunistëve, legalistëve apo edhe kujtimeve të bajraktarëve, ku pohohen takimet me Abaz Kupin, Fiqiri Dinen, Hysni Demën, Muharrem Bajraktarin, Hysen Selmanin etj. Roli i tij prej luftëtari i çështjes kombëtare është dokumentuar në historikun e disa rretheve, si Mati, Korça, Berati, Skrapari", tha ai, duke theksuar se përkujtimi në nder të Haxhi Lleshit nuk duhet fokusuar vetëm te kontributi i tij si president, por edhe si luftëtar i lirisë.

Rruga e Arbërit nr. 84

portret



Nderim për Bajram Alush Stojkun

Nga **NAIM PLAKU**

Bajram Stojku është djali i Alushit për të cilin flet e shkruan historia. Ishte vetëm 10 vjeç, kur me sy të përlotur përcolli në varr babain e tij të dashur që u vra nga dora tradhtare e mizore atë korrik të ndezur të vitit 1944. Jetoi dhe u rrit me krenarinë e babës dhe të familjes së tij, përkrah vëllait të madh, Haxhiut, dhe Ahmetit që zbriste nga malet partizan i ri me pishtarin e lirisë në dorë. U brumos që i ri me tiparet e një karakteri të fortë e të qëndrueshëm, djalosh i besës dhe punëtor i palodhur, i urtë dhe i dashur, që, jo për hatër, do ta kishte pasë gjithkush zili ta kishte në krahë të tij.

Edhe unë e ndjej veten shumë të lumtur e të gëzuar, por edhe të emocionuar e krenar që vargut të emrave shumë të nderuar që mban në gjirin e tij qyteti im i dashur, Peshkopia, i shtohet sot edhe një emër tjetër, një bir i denjë që lindi e u burrërua në këto kalldrëme të gurta, që shndrit e kulmon në gjerdanin e lashtë të traditave të mrekullueshme dibrane. Jeta e tij i ngjan një luleje që çeli e gjallëroi në degët e një lisi të moçëm shekullor, me rrënjë të thella e të ngulura në tabanin e kësaj toke të përgjakur, me degë të gjëra e të shtruara, përherë në gjelbërim. Pra një emër i njohur jo vetëm në qytetin e Peshkopisë por dhe jashtë tij Bajram Alush Stojku, me vendimin e këshillit bashkiak shpallet "Qytetar Nderi" i këtij qyteti që u lind, u burrërua dhe derdhi djersë vite me radhë po për këtë qytet e për këto banorë që po e vlerësojnë sot.

Pa dashur të futem në përshkrimin me hollësi të jetës së tij, e shoh të nevojshme të përmend pak gjëra nga ato, që, siç themi ne, edhe po të duash t'i fshijsh, nuk i heq dot. Bajrami Stojku është djali i Alushit për të cilin flet e shkruan historia. Ishte vetëm 10 vjeç, kur me sy të përlotur përcolli në varr babain e tij të dashur që u vra nga dora tradhtare e mizore atë korrik të ndezur të vitit 1944. Jetoi dhe u rrit me krenarinë e babës dhe të familjes së tij, përkrah vëllait të madh, Haxhiut, dhe Ahmetit që zbriste nga malet partizan i ri me pishtarin e lirisë në dorë. U brumos që i ri me tiparet e një karakteri të fortë e të qëndrueshëm, djalosh i besës dhe punëtor i palodhur, i urtë dhe i dashur, që, jo për hatër, do ta kishte pasë gjithkush zili ta kishte në krahë të tij. Vitet e para shërbeu kamerier në krah të Cen Mangës. Por, shpejt do të ndryshonte rrjedha e jetës.

Në vitin 1952 vjen në Peshkopi një e drejtë studimi për një kurs profesional elektricist pranë shkollës FZO dhe fill pas mbarimit të saj, punon në NIL-Prodhime në Peshkopi, ndër të parat ndërmarrje aso kohe në qytetin tonë, deri më 13 nëntor 1953, kur u thirr për të kryer shërbimin ushtarak, të cilin e mbaroi pas 30 muajsh, ku, veç stërvitjes ushtarake, pati rastin të specializohet edhe si teknik në riaktivizim armatimesh në një ofiçinë ushtarake. Emrohet në punë në NISH-Elektrik, por shpejt kërkohet për nevoja pune si mjeshtër armatimesh në repartet ushtarake, detyrë të cilën e kreu me devotshmëri deri në vitin 1959, ku ju dha rasti të ndjekë rregullisht mësimet pranë shkollës së mesme "Harry Fulltz" në Tiranë, në degën elektrike dhe diplomohet teknik i mesëm. Këtë profesion, Bajrami do ta dashurojë me plot pasion tërë jetën, sepse dhe jeta e tij, më së shumti, qe e lidhur me këtë profesion të nderuar dhe për kontributin e tij të çmuar që dha në këtë drejtim i është mirënjohës tërë Dibra. Nga teknik, gjithmonë i vlerësuar për merita pune, bëhet brigadier e më pas përgjegjës i repartit elektrik. Së bashku me Abdulla Iskurtin kryejnë punimet në H/C e Gjoricës dhe instalimet e rrjetit elektrik në disa fshatra të zonës së Shupenzës deri në vitin 1964. Është autor i elektrifikimit të fshatrave në komunat Zerqan, Muhurr, Tuçep, Bulqizë, etj, duke realizuar në kohëe cilësi elekterifikimin e tyre në bashkëpunim të ngushtë me mjeshtrit Xhelil Çorja e Miftar Xhediku. Për veçoritë, mundësitë dhe vështirësitë që pati elektrifikimi i Bulevardit është një tjetër meritë e Bajram Stojkut, sepse ai ndihmoi në zgjidhjen e shumë problemeve profesionale. U shtri sistemi kabllor nëntokësor, unikal në mbarë vendin, që në vitin 1967, i cili po u reziston dhe sot nevojave të qytetit. Së bashku me grupin elektromekanik që punonte me të, duke shfrytëzuar mundësitë e ndërmarrjes dhe të prodhimit tjetër vendas u realizua prodhimi i shtyllave të neonit, i llampave dhe pajisjeve të tjeraqë të bëhej i mundur ndriçimi i kësaj shetitorje në përshtatje me blirin shoqërues dhe me parametrat estetik të kohës. Në zhdukjen e pasojave të tërmetit që goditi Dibrën më 1967 duhej patjetër dora dhe mendja e specialistëve në të gjitha fushat. Edhe këtu shkëlqeu përvoja e pasur e përkushtimi në punë i z. Bajram Stojku, që të ecnin me vrullin dhe tempin që kërkonte momenti. Nderohet me "Medaljen e punës". Në vitin 1967 emërohet drejtor i NISH-elektrikut.Kemi parasysh se jemi në një nga periudhat më të vështira në këtë sektor. Do të kryhej elektrifikimi i vendit, pra dhe i mbarë Dibrës, e cila, për terrenin e saj që kishte, ekonomive të shpërndara e larg qendrave të banuara, pa rrugë e mjete pune, pa kuadro e specialistë, një punë së voluminoze, aq dhe e vështirë e me problem të shumëta teknike.Aksioni filloi në Bulqizë më1 mars 1968. Duhej dhe një planifikim i përshtatshëm, një organizim dhe përgatitje e përsosur. Do të ndërtoheshin 220 kabina elektrike, do të shtrihej rrjeti elektrik nëçdo shtëpi, do të përballohej gjithçka me punën e krahut.Aksioni përfundoi me sukses më25 Tetor 1970, një vit përpara afatit të vendosur.Dekorohet me "Urdhërin për shërbime të shquara shtetërore e shoqërore të Klasit të Parë". Ky sukses i merituar e vuri Bajramin përsëri përpara provave të papritura duke e vlerësuar e gjykuar si më të përshtatshmin për të dalë nga situata ekonomitë që nuk ecnin. Duke patur besim edhe tek përvoja, dinamizmi, dhe energjitë e tij, sidomos, për ndershmëinë dhe përkushtimin total që e karakterizonte në punë, Bajramit i besojnë drejtimin e kooperativës bujqësore të Kalasë së Dodës, e cila ndodhej në një situatë teje të vështirë. Nga 4 prilli i vitit 1975 për tre vjet Bajrami punoi në kondita tepër të vështira në një nga ekonomitë më problematike që kishte rrethi ynë në atë kohë. Gjithkujt do t'i kujtohen ato dy-tri fjalët e para me të cilat e nisi punën: "Unë nuk kam ardhur këtu tek ju për lekë. Nuk kam ardhur as si punëtor. Unë kam ardhur mes jush të punojmë krahëpërkrah. Po punuat ju, unë jam i nderuar. Po nuk i ecëm në hile njeritjetrit, jemi në rrugë të mbarë...Ndryshe, mua dhe ju Zoti na dhashtë hajrin"!. Kështu e nisi ai punën dhe vitin e dytë e të tretë duke shfrytëzuar dhe punë për të tretët si pastrim bjeshke, sistemim tokash, pastrim pyjor, dhe veçanërisht kontratën e lidhur me Ndërmarjen Artistike "Migjeni" në Tiranë për rrënjë shqope e mareje u rrit vlera e ditës së punës me 30 – 35 lekë. 500 burra nga kjo kooperativë punonin për llogari të kësaj kontrate në jug të Shqipërisë për katër muajt e dimrit dhe vetëm për katër muaj futeshin në arkën e kooperativës mbi 40 milion lekë. Kështu që në dy vitet e fundit kooperativa shpërndau 100 lekë për ditë pune dhe u shlyen të gjitha kreditë bankare.

Kooperativa arriti të marrë për çdo 100 dele 100 qingja, në grurë u morën rendimentet e fushës, mbi 20 kv/ha, në këtë vend ku kishin humbur shpresat për një prodhim e një jetë më të mirë, puna e Bajramit me popullin e bëri realitet. Halil Robi, sot pensionist e banues në Laprakë kur i thamë se Bajram Stojku është dekoruar nga Këshilli bashkiak me titullin "Qytetar Nderi i Peshkopisë" u shpreh: "Një vendim plotësisht i drejtë, nje meritë që i ka takuar herët Bajramit.Ai jo vetëm për qytetin e Peshkopisë që e lindi, rriti dhe burrëroi por ka bërë për të gjithë Dibrën.Dhe unë ruaj kujtimet më të bukura për Bajram Stojkun.E kam njohur qysh herët, në ato vite kur jo vetëm në Dibër por në të gjithë Shqipërinë kishte filluar elektrifikimi i plotë i vendit. E kam njohur mirë dhe kur erdhi kryetar kooperative në Kala të Dodës dhe ku vetëm vitin e parë në saj të punës drejtuese të Bajram Stojkut kjo kooperativë u rendit ndër më të mirat në rreth". Jo vetëm Halili por për Bajramin ka shumë veta që duan të flasin e të trëegojnë kujtimet e tyre. Fill pas Kalasë së Dodës transferohet në parkun Automobilistik të qytetit, sepse edhe në këtë sektor ishin shfaqur probleme të shumëta. Këtu e filloi punën më 4 shtator 1976 si drejtor i një parku që ishte katandisur në një grumbull hekurishtesh dhe me shumë mangësi. Iu desh të ngrihej dhe një herë në këmbë dhe t'i thotë vetes: -"A ke më fuqi, bre burrë?! Hajde, t'ia nisim dhe njëherë"!

E filloi punën përsëri me përkushtim e vendosmëri, duke u mbështetur fort tek mekanikët e shoferët. Përparësi i dha krijimit të kushteve të punëtorëve, specializimeve të mekanikëve, vendosjes në drejtim të specialistëve më të aftë e punëtorë të talentuar, duke nxitur e zhvilluar inisiativat e novacionet, si e vetmja rrugë për të rigjeneruar e riaftësuar pjesët e këmbimit. Futi riparimet e mesme e kapitale nga vetë punonjësit e parkut, u vendos që kur automjeti të futej në ofiçinë, shoferi të punonte bashkë me mekanikët, gjë që rriste përgjegjësinë jo vetëm të mekanikut por edhe të shoferit. Për riparimet e lehta u krijuan pika riparimi në Bulqizë e Klos. U konsolidua mendimi se çdo punonjës ishte përgjegjës nëllogoren e tij për mbarëvajtjen e punëve të shumta që përballonte ky park.Më 1979 dekorohet me "Urdhërin për Shërbime të Shquara të Klasit të Parë" – për rezultate të larta në punë. Kërkoi të largohej nga Parku, sepse e ndjente veten të lodhurdhe filloi punën që i ofruan si shef i eksionit të Ekonomisë Komunale në Komitetin Ekzekutiv të KP të Rrethit Dibër dhe i ra në hise të niste përsëri një punë të përgjegjshme: atë të furnizimit të fshatrave të Dibrës me ujë të pijshëm, një aksion tjetër mbarëpopullor. E veçanta në këtë detyrë është se u emërua komandant pa ushtarë, ushtarët do të mblidheshin nga ai në të gjithë sektorët ekonomik të rrethit. Kështu që u krijua një brigadë dhe filloi puna për furnizimin me ujë nga Kalaja e Dodës, Sllova, Vlesha dhe deri në Kastriot, Qendër, zona e Maqellarës dhe e Shupenzës, mbi 120 fshatra. U projektuan dhe u ndërtuan dy ujësjellësa rajonalë, njëri për 21 fshatra dhe tjetri për 40 fshatra, pa asnjë ndërmarje e pa asnjë punonjës. Dekorohet përsëri aksioni më 198 me "Urdhërin e Flamurit të Kuq të Punës të Klasit të Parë".

Veprimtaria e Bajram Alush Stojkut siç shihet është mjaft e gjërë dhe, e parë në një këndvështrim tjetër, është dhe shumëdimensionale. Në një kuadrat të hapur e të gjërë që ngërthen brenda tij tërë Dibrën, kemi një pinjoll të denjë të një dere bujare e trime, një fëmijë të mbarë, një nxënës të vullnetshëm, një punëtor fisnik e të palodhur, një specialist, dritëprodhues e dritëdhënës, një drejtues me një optikë të gjërë krijuese, drejtor i vemendshëm në ekonomitë industriale dhe në ato bujqësore, njëshofer, mekanik, hidraulik, e ku ta di unë. Janë tepër të larmishme punët që nisi e bitisi me mbarësi, janë po kaq të larmishëme fushat e jetës ku punoi me përkushtim. Por, në këtë kuadrat të gjërë spikat një dritë vezulluese: ndershmëria për t'i shërbyer popullit, vullneti dhe këmbëngulja për të thyer çdo barrierë, për të mposhtur çdo vështirësi, për t'i mbajtur duar e këmbë të pastra,aq më shumë fytyrën e tij të nderuar dibrane, siç ia lindi nëna...



Kulla e Sale Markes ne fshatin Bohmove. Foto: R. Torte

Para disa vitesh hartuan një letër të cilën ua dërguan bashkëfshatarëve të tyre në SHBA, si formë apeli për të grumbulluar paratë e nevojshme për asfaltimin e kësaj rruge. Për fat të keq efekti i kësaj letre nuk e arriti qëllimin e dëshiruar.

Frekuentimi më I shpeshtë I këtij fshati do të realizojë edhe idetë e ndërtimit të shtëpive të reja dhe sidomos restaurimin e Kullës së Salë Markes. Kjo do të dëshmojë se ish banorët e këtij fshati do ta gjallërojnë vendlindjen e tyre, sepse me këtë do të hapen edhe fronte të reja pune në këtë kohë të krizës ekonomike globale dhe të papunësisë së madhe.

Fshatit Bohmovë i kthehet gjallëria

Nga **Rexhep TORTE**

Është kënaqësi të shohësh si gumëzhinë në këto ditë pranverore Fusha e Dibrës së Madhe dhe rruga tashmë e asfaltuar për në fshatin Bohmovë nga buqit që janë duke punuar tokat e tyre bujqësore. Këtë e mundësoi asfaltimi i kësaj rruge gjatë verës së vitit të kaluar, me çka është mundësuar arritja e kthimi i shpejtë e komod me automjete dhe me mekanizimin buqësor. Asfaltimi i kësaj rruge u bë me paratë e akorduara nga Banka Evropiane për Rinkostruim dhe Zhvillim të Bujqësisë mbi bazën e projektit me të cilin aplikoi pushteti vendor. Vlerë e kësaj rruge kushtoi 220 mijë euro.

Mersim Marku, kryetar i Gjyqit Themelor në Dibër të Madhe dhe bashkëfshatari i tij Haki Marku tregojnë se para disa vitesh hartuan në emër të Fisit Marku një letër të cilën ua dërguan bashkëfshatarëve të tyre në SHBA, si formë apeli për të grumbulluar paratë e nevojshme për asfaltimin e kësaj rruge. Për fat të keq efekti i kësaj letre nuk e arriti qëllimin e dëshiruar.

Në këtë letër thuhej ," Kemi gjakun, trungun, gjenezën, emrin familjar, historinë familjare. Edhe në ditët tona gëzojmë respekt në "Nëntë Malet e Dibrës". Kemi detyrë njerëzore e familjare që këtë fshat tonin me vlerë historike për familjen dhe kombin, ta bëjmë të pavdekshëm. Me ndihmën edhe tuajën dëshirojmë që fshatin Bohmovë ta shndërrojmë në fshat të zhvilluar e turistik për familjet tona, për tërë qytetin dhe për gjeneratat e ardhshme. Me kontribut të përbashkët dëshirojmë tu dalim zot vlerave tona familjare. Jeta është e shkurtër ndërsa me vepra madhore emri bëhet i pavdekshëm. Shembull më i mirë për këtë është vllau ynë Vehbi Marku amanetin e të cilit e kryen djemtë e tij në vitin 1975, duke e ndërtuar çezmën te livadhet pranë varrezave të të parëve tanë, ndërsa Jonuz Marku investoi në rregullimin e Varrit të Hasimes. Në livadhet në të hyrë të fshatit, tashmë tradicionalisht vijnë në ekskursion nxënësit e shkollave, grumbullohen qindra persona të të gjitha moshave të familjeve, familjet të Fisit Marku, për të kremtuar së bashku edhe Ditën e Verës, Shëngjergjin, 1 Majin, me tingujt e muzikës, me këngë e valle dhe aktivitete sportive. Kjo nismë e jona mbështetet edhe nga Fisi Dema i fshatit Shushicë, nëpërmjet aktiviteteve të Bajram dhe Besnik Dema, në fshatin Taranik nëpërmjet Beqir Markes, Sami Markes, dhe familjeve dibrane Mullarexha, Çikri dhe Ame e të tjera, në aferi të tokave të të cilëve kalon kjo rrugë". Edhe pas dërgimit të kësaj letre paratë për asfaltimin e kësaj rruge nuk u grumbulluan nga mërgimtarët e këtij fshati.

BUKURITË MAGJEPËSE TË FSHATIT

Fshati Bohmovë, i bukur por i braktisur ndodhet përbri kufirit me Shqipërinë buzë lumit Drini i Zi.

Rruga aktuale nga Dibra e Madhe gjer në Bohmovë gjer tani nuk ishte e asfaltuar. Atë e mirëmbanin vetë banorët e këtij fshati me aksione vullnetare duke e shtruar me zhavor. Mbi fshat ndodhen varrezat ku mes tyre dominojnë Varri i Mirë dhe Varri i Salë Markes, i figurës së shquar të këtij fshati dhe i Dibrës e më gjerë. Poshtë dhe rreth varrezave shtrihen zabelet, livadhet dhe fusha pjellore. Ajo që të bie në sy janë bukuritë magjepsëse të këtij fshati, plot bukuri dhe burime ujore. Të sheh syri shumë shtëpi të shkatërruara dhe disa që ende i sfidojnë kohës. Mes tyre është edhe Kulla e Salë Markes.

Në kohën e lulëzimit të tij fshati Bohmovë kishte me dhjetëra shtëpi, shkollën dhe xhaminë e fshatit.

Ajo që të mahnit duke shëtitur nëpër këtë fshat është infrastruktura e tij e dikurshme, që pasqyrohet nëpërmjet kanalit për ujitjen e ngastrave, çezmet, puset në oborret e shtëpive, rrugët me kalldrëme dhe oborret e shtëpive të shtruara me kalldrëme. Siç tregojnë ish banorët e këtij fshati, rrugët dhe oborret e shtruara me kalldrëme shndritnin nga pastërtia.

SALË MARKJA, SIÇ E QUANIN NDRYSHE "DHELPRA E KUQE"

Salë Markja (1789-1869), është figurë emblematike e Fisit Marku, e fshatit Bohmovë që ishte edhe çifliku i tij, figurë e Krahinës së Dibrës me karakter kombëtar, është një nga figurat qendrore e lëvizjes kombëtare shqiptare kundër pushtimit osman. Për urtësinë, dinjitetin, guximin dhe veprimtarinë e tij në Nëntë Malet e Dibrës, populli ia dha nofkën "Dhelpra e Kuqe". Për kontributin e tij në dobi të atdheut, Shteti Shqiptar në vitin 1993 e dekoroi me "Urdhrin për veprimtari patriotike të Klasit II", me motivacionin "Si luftëtar e udhëheqës popullor që dha kontribut të shquar në luftën kundër pushtuesve osmanë". Salë Markja u dallua edhe për karakterin e tij human dhe aftësinë e rregullimit infrastrukturor të fshatit Bohmovë, duke ndërtuar që në atë kohë edhe kanalin ujitës të gjatë 7 kilometra, për ta sjellë ujin nga Drini i Zi deri në fshatin e tij.

FSHATI SHPRESON TË GJALLËROJË

Shpërngulja e banorëve të fshatit Bohmovë filloi në vitet 50 të shekullit të 20-të. Kjo u bë për arsye ekonomike, të rënies së zhvillimit bujqësor, të papunësisë, vajtjes për të punuar në Dibër dhe për shkak të rrëshqitjes së tokës pas ndërtimit të Liqenit artificial të Dibrës së Madhe në vitin 1969. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës do ta ringjall këtë fshat të begatë, sepse shumë ish banorë mendojnë të kultivojnë bletë, të merren me bagëti dhe punimin e tokave pjellore të pasura me burime ujore. Ndërtimi dhe asfaltimi i kësaj rruge do të shërbejë edhe si arterie lidhëse e një pjese të Kojnarës së Re, Fushës së Dibrës së Madhe, Trapit të Dacit, fshatrave Taranik e Shushicë. Kjo do të mundësojë arritje më të lehtë dhe më të shpejtë te të gjitha tokat e punueshme, punimin më efektiv të këtyre tokave dhe vjeljen dhe sjelljen në shtëpi të prodhimeve bujqësore që shquhen për nga cilësia dhe sasia, sepse rruga gjithnjë është promotor i zhvillimit. Mersimi dhe Hakiu si edhe tërë ish banorët e këtij fshati janë tepër të enthuziasmuar pas asfaltimit të kësaj rruge gjer në të hyrë të fshatit, sepse tani janë krijuar të gjitha kushtet dhe mundësitë për ti punuar dhe për tu kujdesur për tokat dhe zabelet e këtij fshati të braktisur. Frekuentimi më I shpeshtë I këtij fshati do të realizojë edhe idetë e ndërtimit të shtëpive të reja dhe sidomos restaurimin e Kullës së Salë Markes. Kjo do të dëshmojë se ish banorët e këtij fshati do ta gjallërojnë vendlindjen e tyre, sepse me këtë do të hapen edhe fronte të reja pune në këtë kohë të krizës ekonomike globale dhe të papunësisë së madhe edhe në Dibër të Madhe.

Keni nje histori per te treguar?

Nje ngjarje per te kujtuar?

Nje liber per te promovuar?

Nuk keni nevoje per MIK, as PARA per te paguar...

vetem shkruani ne emailin <rrugaearberit@gmail.com>

Rruga e Arbërit

Studiuesi dhe publicisti Shaqir Skarra publikon librin e tij të nëntë

Përqasje kritike rreth librit "Trokitje në portat e Dibrës"

Nga **Mentor HOXHA**
Master shkencor në "Studime letrare"



Shaqir Skarra
TROKITJE NË PORTAT E DIBRËS

Publistikë
Botimet M&B
Tiranë, 2013.

412 faqe
1000 lekë

ISBN:
978-9928-172-05-1

Kolanës studimore të librave të Shaqir Skarrës, iu bashkangjit së fundmi edhe libri "Trokitje në portat e Dibrës", i sapo dalë në qarkullim. Është një libër me reportazhe, publicistikë, portrete, studime dhe intervista me disa prej figurave të spikatura të Dibrës që autori ka publikuar gjatë kohës si kryeredaktor te gazeta "Rruga e Arbërit". Si autor i nëntë librave të spikatur dhe qindra artikujve, intervistave, reportazheve, skicave dhe tregimeve, të publikuar në harkun kohor të tridhjetë viteve, studiuesi dhe publicisti i njohur Shaqir Skarra, ka krijuar tashmë individualitetin e tij të veçantë krijues dhe mediatik, duke duke iu bashkangjitur aradhës së krijuesve elitarë dibranë, por edhe më gjerë. Në themel të këtij libri është historia dhe kultura e Dibrës. Është panorama e jetës dibrane me arritjet dhe problematikat e saj. Libri është publikuar nga Shtëpia Botuese M&B, redaktuar nga dr. Fejzulla Gjabri, ndërsa reçenca është bërë nga Mentor Hoxha. Ka katërqind e dymbëdhjetë faqe, një format modern me lustër, përbrenda së cilës është një botë e tërë amendimi dhe meditimi, ku trajta lëndore, forma artistike, përkujdesja grafike dhe larushia e gjinive letrare gërshetohen mjeshtërisht me njëratjetrën. Ndërsa futesh në brendësinë e shumëllojëshmërisë së këtij libri interesant, të duket sikur je në bjeshkët e larta të Korabit, apo në lëndinat marramendëse të Lurës apo të Fushës së Pelave, ku jehona e historisë së trevës dibrane, përzihet me aktualitetin e sotëm, ku portretet e protagonistëve aktualë, sikur përpiqen të përjetësojnë apo të ndreqin gabimet e paraardhësve të tyre, në mënyrë që pasardhësit të marrin diçka edhe nga lavdia e tyre. Thënë shkurt, ky libër, është një rrugëtim i paqtë dhe triumfator në analet e historinë dhe të kulturës dibrane, e cila qëndron si një masë amorfe, e pandarë nga historia dhe kultura shqiptare. Është një tribunë ku evokohet tradita, rivajëzohet historia, përqasen ide, përcillen mesazhe, ngrihen probleme, por edhe jepen zgjidhje. Çdo kush që lexon këtë libër ndihet i privilegjuar dhe i magjepsur, jo vetëm nga problematika, por edhe nga shumëllojshmëria letrare, gjuha e përzgjedhur, forma artistike dhe denduria e përftesave stilistike, të përzgjedhura me aq kujdes dhe finesë nga autori në funksion të ndijimshmërisë dhe ndriçueshmërisë së detajit dhe të mesazhit. Trajtën lëndore të këtij libri, autori e ka kaluar më parë nëpër filtrin e tij artistik, për ta ngjyrosur në pigmentin e figurshmërisë artistike, për ta bënrë sa më të bukur dhe sa më tërheqës për lexuesin shqiptar.

Gjinitë e shumta letrare të lëvruara në këtë libër dëshmojnë aftësitë letrare dhe publicistike të autorit. Për secilën gjini ka përdorur një stil të veçantë dhe një gjuhë të përzgjedhur artistike, larg leksikut të gjuhës së përditshme. Kështu, në artikujt studimorë "Dibra", "Shumbati, ose Myzeqeja e Dibrës", si pikë referimi ka patur objektivitetin dhe burimin shkencor. Është larguar në maksimum nga fjalët e tepërta dhe pa vlerë, dhe është fokusuar më shumë tek dokumentet dhe argumentat shkencore të pakundërshtueshme.

Me një stil aristokratik për tu admiruar, autori ka përçfaqur mjeshtërisht objektivitetin e tij artistik edhe në reportazhet brilante mjaft domethënëse: "Nëpër gjurmët e Dinastisë së Kastriotëve", "Rrugëtim mes dibranëve të mi, Tirana tjetër", "Dikur qytet i mjerimit, sot qytet i ndryshimit", "Lura qenka në Laknas", Trokitja në mëhallën e dibranëve", "Aty ku bashkohet Krajka me Gotvinë", "Mes pishave, një kantier i ri", "Gurët e Skënderbeut", "Sa afër qenka Dibra me Tiranën! "Mes mrekullive dhe legjendave të Kalasë së Dodës", "Te ura që bashkon dy rrugë", "Luginës së Tujanit", "Mes emigrantësh shqiptarë në Gjenova", "Drejt Dibrës, si 100 vjet më parë", "Mirëse erdhët në Dibër! "Brigjeve të Drinit, aty ku gjëmon historia", "Nga Selishta buron drita", "Vjeshtë pa gjethe në Peshkopi", "Dasëm dhe festë në Arras", "Stinë dasmash në Peshkopi" etj. Reportazhi ka qenë dhe është shtëpia artistike më e sigurtë dhe më e preferuar e autorit. Këtë shtëpi ai e ka ndërtuar që para tridhjetë vjetësh, të cilën përgjatë viteve e ka mbushur me qindra reportazhe të bukura nga mbarë Shqipëria, të publikuara te "Ushtima e Maleve", "Zëri i Rinisë", "Dibra", "Rruga e Arbërit", etj. Për librin që po flasim ka përzgjedhur vetëm disa prej tyre, ndërsa të tjerat shpreson t'i publikojë në një libër tjetër.

Krahas reportazheve, në faqet e këtij libri, janë përjetësuar edhe mjaft probleme dhe plagë të pashëruara të Dibrës dhe të banorëve të saj, plagë që akoma dhëmbin dhe presin shërim. Ka mesazhe, revoltë, replika, ide si mund të dilet nga situata, denoncime, skica ku pasqyrohet skamja dhe ku dënohën fajtorët, këshilla të mençura dhe personazhe realë që jetojnë midis tragjizmit dhe mjerimit. Të tillë janë artikujt: "Rruga e mbetur më mes të rrugës", "Fjalë dhe vetëm fjalë për Rrugën e Arbërit", "Rruga e Arbërit, apo Rruga e Gjarpërit", "Edhe pak gëzim", "Monumentet e natyrës në Qarkun e Dibrës", "Duhet, apo jo Skvica", "Rruga e Arbërit-përmasa kombëtare e munguar", "Besë në ditë të vështira", "Aty ku rrëmbehen jetë njerëzish", "Rruga e Arbërit-pre e tullumbaceve elektorale", "Si rroj me veshkën e nënës time", "Sa e lirë qenka jeta!", "Bulqiaz vajton përsëri", "Shqip është shkruar në Gegni, zotio Gill", "A duhet të ndërtohet Skavica?!, "Pesënjakët pesëvjecarë".

Në libër gjen mjaft portrete për disa dibranë të njohur jo vetëm në Dibër por në mbarë Shqipërinë. Të tillë janë biznesmeni dhe politikani Rakip Suli, intelektuali, prof. Hasan Çipurri, aktorja Drita Agolli (Strazimiri), intelektualët dhe biznesmenët Musa Rricku, Shaban Bitri, Muhamet Bitri, Ramazan Biba, Faik Bruçi, Liman Hoxha, politikani dhe intelektuali Cezar Ndreu, mësuesja Afroviti Bitri (Kokuri) etj.

Nuk mungojnë as portretet për disa nga figurat më të spikatura të trevës dibrane, të cilët, ndonëse nuk jetojnë më, janë të gjallë në memorien e autorit dhe të dibranëve të tjerë, pasi kanë lënë emrin dhe veprën e tyre të pavdekshme. Ndër ta janë gazetari dhe shkrimtari Bajram Hyseni, rapsodi, koreografi dhe studiuesi, artisti i merituar Haziz Ndreu, prof. Hasan Leka, intelektuali dhe kampioni i mundjes Ramazan Hoxha, intelektuali Agron Kukeli, mësuesit Nderime Methasani, Xhafer Merdini, Allaman Xharri, pilotët Sefedin Tomçini dhe Sabri Toçi dhe i riu 25 vjeçar Mevlan (Landi) Shira dhe Skënder Sulejman Cani.

Aftësitë profesionale autori i ka shfaqur me mjaft sukses edhe në gjininë e intervistave. Me një stil admirues ai ka zhbiruar në jetën intime dhe profesionale të dhjetë personaliteteve dibrane, që aktualisht janë shumë të njohur, madje janë edhe në poste të larta drejtuese. Në rrjetën e tij të peshkimit mediatik kanë rënë kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja, profesori i njohur i gjuhës dhe i letërsisë, Hajri Shehu, sopranoja dhe pedagogia e Akademisë së Arteve Alma Strazimiri, presidenti i Dhomës së Tregëtisë "Shqipëri-Britani e Madhe", Zenel Hoxha, pedagogia e sociologjisë Edlira Haxhiymeri, prefekti i Qarkut të Dibrës Xhafer Seiti, mjekja e njohur dermatologe Monika Fida (Zebi), nënkryetari i Njësisë Bashkiake Nr. 1. Shpëtim Cami, nipi i atdhetarit të flaktë Elez Isufit, Jonuz Ndreu, kryetar i komunës së Shupenzës, Moisi Llani dhe administratori i Kompanisë "Almo Konstruksion"Shaban Bitri.

Libri përmbyllet me disa artikuj kritik dhe promovues të autorit. Midis tyre spikat artikulli "Një libër homazh, një homazh i përbashkët", i cili bën fjalë për promovimin e librit të Naim Plakut "Trëndafila mbi mermer". Artikulli "Kronikë e një dasme të bukur shqiptare" i kushtohet librit "Dasma e Mirës" të Mehmet Dumes, ndërsa "Një libër jo vetëm për të rinjtë" ka për objekt kritik krijimtarinë e shkrimtares së re "Enisa Kananaj".

Si përfundim, mund të themi që libri "Trokitje në portat e Dibrës" është një mozaik shumëngjyrësh i përgatitur me shumë kujdes nga autori, ku secili lexues gjen padyshim diçka nga jeta dhe shijet e tij artistike. Brenda çdo copëze të këtij mozaiku është historia dhe kultura e Dibrës, janë portretet e disa prej figurave të shquara dibrane që kanë vdekur apo janë gjallë, janë dëshirat, dhimbjet, ëndrrat dhe plagët e autorit, dhe shumë gjëra të tjera me vlerë, të cilat autori ka dashur t'ua përcjellë brezave të sotëm dhe brezave që do të vijnë, me bindjen se ata e meritojnë një respekt dhe një dedikim të tillë. Përmes këtij libri autori përçon tek lexuesi dashurinë për vlerat historike-kulturore-artistike dhe njerëzore të Dibrës dhe të dibranëve. Lënda artistike e këtij libri, është përpunuar parakisht në laboratorin artistik të autorit për tu ngjizur më pas në pigmentin letrar. Si gazetar me një përvojë të gjatë në median e shkruar, Shaqir Skarra ka ditur se çfarë t'i jap publikut në lidhje me studimet shkencore dhe veprat letrare dhe publicistike që ka publikuar, të cilat shquhen për shumëllojëshmërinë artistike dhe hulumtimësinë produktive.

Disa libra studimorë të tij, si "Malet e Dibrës" dhe "Gurrat e Korabit" janë bërë objekt studimi edhe nga disa studiues të njohur, si p.sh., nga dr. Rovena Vata, kryetare e degës arsimore në "Qendrën e Studimeve Albanologjike" dhe nga dr. Fejzulla Gjapri, punonjës shkencor në qendrën e veprimtarive folklorike. Dr. Rovena Vata, në artikullin e saj me titull "Miti i malit" përmes gurrës së legjendave popullore, bën një ekspoze shkencore të librit "Gurrat e Korabit" me autor Shaqir Skarrën. Sipas saj, "ky libër na servir legjendat dhe tregimet më të bukura dhe domethënëse njëkohësisht. Pa frikë mund të themi që Shaqir Skarra, jo vetëm, i mblodhi këto pasuri të gurrës së Korabit duke u futur në substratin e lashtë popullor, por edhe arriti të shpjegojë psikologjinë e njerëzve që ndikoheshin dhe vepronin sipas hamendësimeve të gurrës popullore. Përmes letraritetit ky libër solli nene të gjalla nga Kanuni që ilustrohet përmes një figuracioni të goditur mirëfilli letrar, por solli edhe një të ashtuquajtur mbetje arkaike, vjetërsira të kaluara që kërkojnë me ngulm të lënë gjurmë edhe në kohën moderne, por gjatë leximit shohim që ka edhe raste që këto nene kanunore nuk gjejnë vend të lirë dhe kërkojnë me pahir të hyjnë dhe të sundojnë në jetët tona". Kurse dr. Fejzulla Gjabri, nën titullin "Legjendat dhe anekdotat e popullit, të rishkruara në një frymë bashkëkohore", vlerëson në maksimum librin "Malet e Dibrës" të Shaqir Skarrës. "Shaqiri e do vendlindjen, Dibrën. Unë them se ka të drejtë, jo vetëm se të gjithë e duam vendlindjen, por se Dibra ka se çfarë t'i tregojë çdokujt. E privilegjuar tejet nga natyra me bukuritë e saj si pak vende: me lugina që lagen nga degët e Drinit të Zi, që e përshkon nga jugu në veri; me fusha të begata aq pjellore, sa quhen "Myezeqeja dibrane", me maja malesh piktoreske, që duken se lidhen me Korabin' me vende të shenjta e teqe, të cilat e ndajnë dhe e bashkojnë shtatë të tilla, me vende historike, që flasin për kuvende e luftra kundër zaptuesve. Pra, kjo Dibër me strukturë etnopsikike të Nantë Maleve, Shtatë Teqeve, Katër Oxhaqeve, në një farë mënyre gjendet e shkrirë në këtë vëllim", -shkruan ndër të tjera në parathënien e librit "Trokitje në portat e Dibrës", redaktori Fejzulla Gjabri. Megjithë hulumtimet shumëvjeçare dhe botimet studimore për Dibrën dhe për dibranët, Shaqir Skarra, në studimin e tij "Dibra", ndër të tjera shkruan: "Dibra është një nga trevat tona që ka nevojë të studiohet, por gjithnjë larg nga trilllimet e fantazitë, pranë realitetit dhe historisë. Ende është një trevë e virgjër, sado që mjaft studiues vendas dhe të huaj e kanë thënë fjalën e tyre.... Dibra e lashtë e Mesjetës, me një kulturë qytetare ilire, ku ende sot i bëjnë karshillëk kështjellat e famshme peneste. Dibra e Skënderbeut, e Pal Kukës e Pjetër Shinit, e Moisi Golemit dhe e Ismail Strazimirit, të cilët së bashku bënë luftën disa vjeçare kundra hordhive turke, Dibra e gjeneralëve dhe e shtatmadhorëve, e profesorëve të fjalës së mençur dhe e udhëheqësve popullorë, ka akoma shumë për të thënë, pasi në brendësi të historisë dhe të shpirtit të saj, flenë thesare të çmuara dhe të pazbuluara. Flenë heronjtë e rinj, të cilët presin momentin për të shpërthyer një ditë, në të cilët autori ka varur çengelin shpresës, i bindur se Dibra e së ardhmes do të jetë më e bukur dhe më me shumë heronj, të cilët do të vrapojnë jo pas karriges së pushtetit për të ndryshuar jetët e tyre, por për të ndryshuar mirëqenien e vetë Dibrës dhe të qytetarëve të saj. Besimi i autorit te dibranët e besës dhë të sakrificës, duket qartë që në personazhet e pasqyruara në këtë libër, ku bie në sy mosërfshirja e asnjë e deputeti apo të ndonjë kuadri të lartë nga Dibra, ndonëse ka intervistuar jo pak prej tyre gjatë viteve që ka ushtruar dhe vazhdon të ushtrojë profesionin e gazetarit.

cyan magenta yellow black

prezantimi

Fatmir Terziu dibran...



Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Është hera e parë që sot takohem me Fatmir Terziun, që i jap dorën dhe i marr buzëqeshjen që i del nga shpirti, por nuk është hera e parë që e lexoj dhe ngrohem me fjalën e tij në rreshta e në vargje.

Kur e takova, kur u përqafuam, Ai më tha:

Unë jam dibran...

E kisha titulluar diskutimin FATMIR TERZIU MES DIBRANËVE. Më detyroj të bëj një korrigjim. Dashuria që mori nga dibranët e Ostrenit të Madh ku ishte jo thjesht mësues e bëri atë dibran...

Për herë të parë ia kam lexuar shpirtin në gazetën lokale "Ushtima e maleve" kur ai shkruante për mësuesit dhe banorët e Ostrenit të Dibrës.

Nuk do ta kisha njohur në qoftë se nuk do të kishte qenë mes nesh mërgimi, "fjala e lirë", aq e dëshiruar në rini e aq "pranë e larg" në pleqëri.

Fatmir Terziu ishte një ndër qindra mësuesit që i erdhën Dibrës nga e gjithë Shqipëria kur ajo kish më shumë se kurrë nevojë për njerëz të ditur që do ti jepnin dije e kulturë brezit të ri të saj në shkollat e mesme hapur në skajet më të largëta të mbi 1500 kilometrave katrorë të saj, nga Stebleva në Kala të Dodës, Reç. Lurë, Selishtë...

Ishte pjesë e atij brezi që siç më shkruante mësuesi im Gavril Kota nga Përmeti dhe mësuesja ime nga Berati Nigjare Velçani, mësues në Brezhdan të Peshkopisë në vitin 1951...

Gavril Kote...

"Unë tash kam hyrë në vitin e 6-të të pensionit, por nuk mund të harroj mikpritjen e atij populli dibran, respektin dhe dashurinë që ata treguan për ne arsimtarët jabanxhinj. Shumë kujtime të pashlyera më janë fiksuar nga gjithë familjet e Brezhdanit. Mikpritja, bujaria, thjeshtësia, komunikimi reciprok na e lehtësonte detyrën tonë të vështirë por humane...

... Puna e mësuesit i del para sysh gjithsecilit. Është e vetmja rrugë që e kalon gjithkush, është pjesa më e bukur e gjithsecilit..."

Nigjare Velçani

"Lexova me vëmendje shkrimin tuaj me titull " Mësuesit – më të përkushtuarit dhe të harruarit", botuar në gazetën " Zëri i Populllit " të datës 20 qershor 1993. Të them të drejtën ky shkrim më preku thellë në zemër mbasi më ktheu në kujtimet e 44 vjetëve më parë, në moshën time më të re.

Akoma pa mbushur 16 vjeç, pas një kursi metodik pedagogjik, lash Beratin dhe erdha në Peshkopi, fillimisht në fshatin Brezhdan, i cili më ka lënë mbresa të paharruara në kujtesë dhe pastaj në kufi, në fshatin malor të Cerjanit ku e ndjeva veten në shtëpinë time. Pra për herë të parë hyra në jetë, në punë si arsimtare për tu dhënë njohuritë e para të gjuhës sonë të bukur shqipe vocërrakëve aq të etur për dije.."

Ata, dhe shumë mësues të tjerë të atyre viteve që ditën u mësonin shkronjat e abetares fëmijëve dhe natën, nën dritën e pishës dhe kandilit, ua mësonin ato prindërve do të pasoheshin nga mësues të brezit të Fatmir Terziut, tash në një stad të ri dijesh e kulture.

Tek shfletoja koleksionet e "Ushtimës së maleve" në kërkim të jetës sime 55-vjeçare faqeve të shtypit (1957 – 2012), midis firmave të shumta që përbëjnë vlerën e pazëvendësueshme të saj, takova edhe Fatmir Terziun, emër tash i njohur nga ana ime në letërkëmbimet në adresat tona elektronike.

Ashtu si edhe shkrimi im i parë në faqet e gazetës "Sporti popullor" më 8 maj 1957 e shkrimet e tjera në "Zëri i Rinisë" në shkollë të mesme dhe në shkollë të lartë, shkrimet e Fatmir Terziut në "Ushtima e maleve" përbëjnë vlerë të madhe njohëse, vlerë në kohë e hapësirë, hapa të parë modestë faqeve të shtypit, faqeve të librave.

Do ti citoj ashtu si janë shkruar, me thjeshtësinë dhe dashurinë gjer në amshim...

I pari daton më 10 mars 1984. Flet për punët e ditës në Ostren. Flet për Hajredin Koçin dhe brigadën e tij...

I dyti, ai i 21 prillit 1984 ka për titull "Flet puna e shokët", flet për Vera Elezin, mësuesen e shkollës 8-vjeçare "Elez Koçi" Ostren. "Ajo erdhi familjarisht nga rrethi i Durrësit për të punuar vullnetarisht në këtë zonë të thellë malore. Kanë kaluar dy vite shkollore. Rezultatet e kanë shoqëruar gjatë këtyre viteve. Thjeshtësia, sinqeriteti, sjellja korrekte nga ana tjetër e plotësojnë akoma më mirë portretin e saj si një mësuese shembullore..."

Më 2 maj 1984 shkruan për pasurimin e bazës materiale në shkollën e tij. Shkruan për mësuesin e ri Ilir Jorgo, për mësuesit e tjerë-Veli Kajën, Shefik Elezin, Ismail Llagaçin...

Më 9 maj "Tingujt e daulles mblodhën përreth shkollës së mesme bujqësore të bashkuar Ostren grupet artistike të pesë çetave të pionierve të shkollave 8-vjeçare të fshatrave Ostren, Tuçep, Lejçan, Okshtun e Pasinkë." "Këngët e kënduara, thekson Fatmiri, nga Majlinda Muça e Fëllanxa Muça Ostren, Fatime Stojku Lejçan e grupi i Tuçepit u duartrokitën më shumë nga të pranishmit. U pëlqyen kënga e kënduar nga F. Muça kushtuar atdhetarit Eles Koçi, etj.

Më 30 maj 1984 portretizon punonjësit e tregtisë të Ostrenit, skicon portretin e Ramazan Tolës, Mehdi Ibrahimit e Semije Kurtit. Penelatat për portretet e tyre i ka marrë nga "fjalët e popullit". Flet edhe për Luan Koçin dhe Ahmet Koçin, për punë të mirë e mangësi.

Më 2 qershor ndalet tek ndërtuesit, tek ata njerëz që me punë e djersë ndërtojnë vendin, tek ata nipër e stërnipër ndërtuesish duarartë që rrahën rrugët e Ballkanit, që ndërtuan veprat më të bukura të Perandorisë Otomane, tek ata për vlerën e punës të të cilëve një historian i madh i kohës shkruante " Po të digjej Stambolli, Dibra do ta ngrinte të ri nga themelet, ndërsa po të digjej Dibra askush s'do lëvizte vendit". Fatmiri në shkrimin e tij ndalet tek "15 ndërtuesit Gollobordas, që drejtohen nga mjeshtri i talentuar i ndërtimeve Adil Muça që shtojnë veprat e artit në rrugën e re të Ramnagorës që lidh Ostrenin me Shupenzën" . Shkruan për mjeshtrit në ndërtim, për Fatmir Mijën, Fiqiri Koçin, Halit Canin, për shoferët e palodhur Shyqyri Kurti dhe Liman Rena, për tu ndalë tek cilësia e lartë e punës, vlerë e ndërtuesve gollobordase, ndërtues që vetëm Trebishti ka nxjerrë 11 heronj të punës socialiste.

Fatmiri është një njeri që i dhemb kur gjërat ecin ngadalë apo qëndrojnë për vite në vend. Ai është i shqetësuar pse ndërtesa e dyqanit të Ostrenit të Vogël ka tre vjet që nuk ngrihet nga themelet dhe nuk vihet në shërbim të banorëve. Por ajo " S'është e vetmja, ajo ka edhe shoqet e veta, që gëzojnë fatin e saj. Në të hyrë të fshatit ndodhet edhe shkolla 8-vjeçare e planifikuar, por e papërfunduar, ku të 250 nxënësit e këtij fshati, marrin rrugën akoma drejt fshatit Tuçep..."

Përcolla para jush fragmente të jetës dhe krijimtarisë të Fatmir Terziut në një fshat të Dibrës, në Ostren, Ostrenin e Madh siç quhet për ta dalluar nga Ostreni tjetër në anën tjetër të malit, Ostrenin e Vogël, në një krahinë të Dibrës me njerëz të punës e sakrificës, në një karakoll të madh të qëndresës shqiptare në historinë e Shqipërisë. Shkrimet modeste të Fatmir Terziut në gazetën lokale "Ushtima e maleve" më ngjajnë me gurët e grykës së Bunarit të tij, bunar që ai mori ujin e jetës së tij publicistike, letrare duke u bërë një publicist i dëgjuar, një shkrimtar i suksesshëm, një njeri me germa kapitale.

Dhe ajo që shoh tek Fatmir Terziu është se ai vazhdon të gërryej në bunarin e tij të jetës duke nxjerr prej andej ujin e pastër me të cilin selit fjalën, vargun.

Athinë, 28 prill 2013

MËRGIMTARËT DIBRANË SHKËLQEJNË NË FESTIVALIN E KËNGËS POPULLORE SHQIPTARE NË ATHINË





cyan magenta yellow black

Libri "Psikopatologjia klinike", e mjekut psikiatër Sadik H.Lala është një prurje e re, një kontribut i rëndësishëm në fushën e shëndetit mendor

Psikopatologjia klinike, një libër jo vetëm për profesionistët

Nga **DRAGUSH TOTOZANI**

Libri "Psikopatologjia klinike", e mjekut psikiatër Sadik H.Lala është një prurje e re, një kontribut i rëndësishëm në fushën e shëndetit mendor, jo vetëm si më voluminozi ndër punimet e autorëve shqiptarë të fushës, porn ë gamën e gjërë të temave që ngërthen, për mënyrën e ndërthurjes dhe nivelin bashkëkohor të informacionit, për nga cilësia e lartë e punimit, të cilat janë të konkretizuara në referimet e shumta të autorëve me në zë të botës akademike(të hershëm dhe aktualë).Në këtë drejtim duket se autorin e kanë ndihmuar shumë faktorë. Përveçse natyrës së tij këmbëngulëse, studimit të pandërprerë ndër vite, për të shtuar dhe thelluar në mënyrë të vazhdueshme njohuritë e tij, e duke ndihmuar edhe investimi professional i rëndësishëm, veçanërisht për të patur gjithnjë në bibliotekën e tij tekstet e profesionistëve më të shquar dhe bashkëkohorë, që pasqyrojnë tendencat aktuale multi-disiplinare në fushën e shëndetit mendor. Përveç njohjes shumë të mirë të termilogjisë ndërkombëtare profesionale(si autor i fjalorit të psikologjisë), tek ai spikat një njohje e thelluar e koncepteve dhe autorëve, që i ka mundësuar gjithë lirshmërinë e duhur për të përzgjedhur njohuritë dhe autorët më pikantë të fushës.Atë e ka ndihmuar edhe përvoja e tij e mësimdhënies disa vjeçare e në vazhdim në "Albanian University", si lector i jashtëm për lëndën e Psikopatologjisë së avancuar. Në katër kapitujt e parë, ai trajton rjedhshëm rrugën e përshkruar dhe arritjet e deritanishme shkencore lidhur me aktivitetin psikik anormal të njeriut, dhe jep në mënyrë kronologjike shpjegime konçize mbi modelet teorike të psikopatologjive, me një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për të gjithë, jo vetëm për profesionistët. Në të gjithë kapitujt bie në sy përkujdesja për terminologjinë e pastër shqipe sa herë që ka qenë e mundur, aq shumë të dëshiruar në ditët e sotme, kur gjuha shqipe po barbarizohet çdo ditë me terma të panevojshëm edhe në komunikimin e përditshëm, në vend të termave të saktë të gjuhës sonë të pasur, si dhe futja në përdorim nga ana e autorit edhe i shumë termave të panjohur në shqipen profesionale nga literature në gjuhë të huaj.Një tjetër gjë e rëndësishme për t'u vënë në dukje është edhe synimi i autorit për të konkretizuar me ilustrime çdo shenjë dhe simptomë, e cila është veçanërisht e dukshme në kreun e katërt, atë të Psikpatologjisë përshkruese, në të cilin autori përcjell raste të shumta ilustrimesh nga literature botërore por edhe të eksperiencës shqiptare të botuar dhe të publikuar. Autori është shumë autentik në mënyrën e shtjellimit, duke përdorur krahasime të thjeshta dhe të kuptueshme, ndonëse, se si libër shkencor, është e natyrshme që nuk mund të përthithet sa duhet nga ata që nuk njohin konceptet dhe përkufizimet bazë. Natyrisht niveli i librit është i tillë që i tejkalon kërkesat e një student të nivelit bachelcor, dhe më duhet të theksoj, pa mëdyshje se Psikopatologjia Klinike, e Dr.Sadik H.Lalës është i një niveli të lartë shkencor. Ky libër është një material i vlefshëm jo vetëm për studentët por edhe për kuadrot e specializuar të fushës së Psikoatrisë dhe Psikologjisë, jo vetëm në praktikën e tyre të përditshme klinike, po mund të shërbejë edhe si një burim, e ritheksoj, i shkëlqyer references, sidomos pë rata që merren me tema studimore apo kërkime të tjera shkencore, që do t'i orientojë në përzgjedhjen e veprave më të mira profesionale.

Këtë lehtësi çdo lexues dhe studiues do ta ketë sot falë rezultatit të një pune shumë këmbëngulëse deri në skrupulozitet në studimin sistematik të botimeve profesionale nga autori, e cila e sistemuar në mënyrë ekzakte, për të gjithë burimet që ka përdorur, është e pasqyruar në literaturën përkatëse në fund të çdo kreu. Dëshiroj të ve në dukje se përfshirja në këtë tekst edhe i kritereve mbi kërkimin shkencor për disa nozologjitë më të rëndësishme psikopatologjike, e shton edhe më tepër vlerën e këtij teksti, siç shprehet në recensurë, Akademiku Nushi... ."e tejkalon qëllimin e një teksti të thjeshtë mësimor universitar".Gjithashtu duhet të përmend si një risi, kreun e fundit të librit, në të cilin gjenden emërtimet e sindromave psikiatrike dhe kulturore, të pasqyruara në dy nënkapituj të veçantë, të cilët janë shumë të nevojshëm për njohjen e termave tashmë të papërdorshëm, por që pavarsisht se mund të kenë vetëm rëndësi historike, ato kanë , ato kanë një rëndësi të madhe për qëllime studimore nga pikëpamja krahasimore, shumë nga të cilat nuk kanë qenë të njohura si p.sh hikikomori etj.Po të shihet me kujdes në literaturën burimorer, nuk mund të gjenden në asnjë tekst të vetëm të huaj, të gjithë nozologjitë që i trajton autori në mënyrë të përmbledhur në botimin e tij. Ky tekst është një burim i shkëlqyer informacioni, në të cilin autori ka shpalosur me sukses jo vetëm evidencën e bazuar shkencore më të mirë, por e ka transmetuar qartë dhe me profesionalizëm, duke e ndërthurur edhe me mendimin kundra për çështje të veçanta, që



mund të shërbejë pa dyshim edhe si burim informacioni shtesë për këdo studiues të fushës. Syrit të lexuesit të kualifikuar, nuk i shpëton përkujdesja e autorit edhe për detajet, që reflekton njohuri të organizuara mirë të një culture të gjërë të përgjithshme e profesionale të autorit.Mjafton të bëhet një sondazh në burimet bibliografike, citimet dhe referencat përkatëse, të cilat së bashku me indeksimin jashtëzakonisht të saktë të termave në fund të librit, tregojnë më së miri natyrën shkencore të punimit.Në morinë e fjalëve të merituara, kam kënaqësinë të uroj kolegun me fjalët e redaktorit shkencor, njëkohësisht recensent i këtij punimi, të nderuarit Akademik Pajazit Nushit:"Ju përgëzoj për këtë vepër që ke plotësuar një zbrazëti në literaturën psikologjike, psikopatologjike dhe psikiatrike.Botimi i tij do të hyj si datë e rëndësishme e historisë së tekstologjisë burimore në fushën e Psikopatologjisë".



recensë

Disa mendime për monografinë ***"Kapiteni Rifat Manjani, lulja e trimërisë"*** të autorëve Faik Xhani e Ramazan S. Ilnica

Krenari duke lexuar librin për Dëshmorin e Atdheut Rifat Manjani



Nga **BAFTJAR GAZIDEDE**
Mësues i Merituar

Para disa ditësh[1] morëm pjesë në promovimin e librit "Kapiteni Rifat Manjani, lulja e trimërisë" të autorëve Faik Xhani e Ramazan Ilnica. Libri është një monografi që, për mendimin tim, i ka munguar historiografisë shqiptare dhe është një kontribut serioz e me vlerë në evidentimin dhe ndriçimin e figurave të mëdha të luftëtarëve të Dibrës dhe të Shqipërisë.

Ma solli rasti që dorëshkrimin original ta lexoj akoma pa u botuar libri, i cili është vërtet një botim shumë i goditur dhe cilësor.

E konsideroj jo vetëm si privilegj, por në radhë të parë si detyrim që më jepet mundësia të shpreh mendimet e mia për vlerat e librit, por dhe krenarinë që më ngjalli figura e ndritur e dëshmorit dibran. Natyrisht vetë Dëshmori i Atdheut Rifat Manjani me veprimtarinë e tij për çlirimin e Atdheut, me luftën dhe heroizmin e tij e ka vendin e merituar në altarin e ndritur të të rënëve për lirinë e Shqipërisë. Rifat Manjani, me flijimin e jetës së tij i bën nder përgjithmonë edhe familjes, edhe Homeshit e Grykës së Vogël, edhe gjithë Dibrës, por është i nderuar dhe nga gjithë Shqipëria. Besoj se bëj mirë ta përsëris thënien lapidare të popullit: **"Kush bie për Atdhe, ai nuk ka vdekë , por ka le"**. Sepse Oda Dibrane, Konaku i saj, e ka pleqëruar dhe vënë në vlerësime të emërtuara me kujdes: djalë fisi, djalë fshati, djalë Dibre, por dhe Burrë Dheu. Duke lexuar librin, bindemi se Rifat Manjani ishte vërtet Burrë Dheu, sepse ai me jetën e veprën e tij i shërbeu më së miri Kombit të tij.

Pasi e lexova them me bindje se ky libër, kjo monografi, i ka shërbyer ndriçimit të plotë dhe në një përmasë të gjerë evidentimit të jetës dhe veprës të Dëshmorit të Atdheut Rifat Manjani duke e vënë në atë piedestal që e ka merituar që më 1 shkurt 1944 kur me shokët e tij shkroi Epopenë e Vrakës, aty ku ngrihet një lapidari madhështor kushtuar heroit të Popullit Vasil Shanto dhe Dëshmorëve të Atdheut Rifat Manjani dhe Reshit Rusi.

Autorët i falenderoj, së pari, që përzgjodhën 100-vjetorin e Pavarësisë për ta vendosur Rifat Manjanin në një radhë me veprimtarët më të shquar në dobi të Atdheut. Së dyti, autorët e kanë përmbushur me cilësi detyrën e tyre duke shkruar një monografi me vlera të vërteta historike dhe dokumentare. Vargjet e këngës lapidare ***"Vitet ikin tutje,/ Ju vini tëhu"*** janë bërë realitet nga dy studiuesit, të cilët kanë përballuar me shumë sukses vështirësitë për evidentimin e aktivitetit të dëshmorit, pasi Rifat Manjani e ka zhvilluar veprimtarinë larg Dibrës dhe familjes së tij. Së treti, vlerësojmë se ka qenë domosdoshmëri shkrimi i kësaj monografie, duke kontribuar në rishkrimin e plotë të historisë sonë larg ndikimeve kufizuese të ideologjive të çdo lloj ngjyre. Më lejoni që të them se kuptimi i rishkrimit të historisë në rastin e këtij libri është realizuar në thelbin e vet, në vërtetësinë historike pa asnjë ekuivok, ashtu siç dhe përmendi në intervistën e fundit Patriarku i Letrave Shqipe, akademiku Dritëro Agolli që e shpjegoi kështu **rishikimin** dhe **rishkrimin** e historisë: *"**Rishikimi i historisë... Dakord, duhet bërë, por jo të ndryshojë duke e redaktuar. Nuk duhen bërë ndryshime të së vërtetës, nuk redaktohet dokumenti historik. Nuk redaktohen dot ngjarjet që kanë ndodhur...**"*

Unë do të saktësoja: *Në të vërtetë ka pasur shpesh dhe ka shtrembërime të fakteve historike dhe që duhet të korrigjohen. Ne e dimë se si është politizuar edhe historia për qëllime të caktuara. Të vërtetat historike duhet të dalin në dritë dhe kjo është punë e historianëve e studiuesve, jo e politikanëve.*

Unë nuk marr përsipër të bëj rolin e kritikut të historiografisë, por po rreshtoj shkurt konsideratat, vlerësimet dhe mendimet e mia për monografinë:

1. Autorët kanë shfrytëzuar me mjeshtëri literaturën për të paraqitur sa më mirë traditat dhe tabanin atdhetar në të cilin u lind, u rrit dhe u formua si atdhetar Rifat Manjani. Natyrshëm del në monografi se ***dëshmori u pajis me virtytet më të mira të paraardhësve*** të trevës së Grykës së Vogël dhe mbarë Dibrës në luftrat trimërore për pavarësi, për liri dhe në mbrojtjen e truallit tonë kundër të gjithë armiqve të shumtë, si atyre otomanë, serbë, bullgarë, austro-hungarezë etj. Jo pa qëllim autorët kanë përmendur ngjarje dhe personalitete të atyre anëve që janë shquar për organizimin e drejtimin e popullit në mbrojtje të trojeve tona dhe që u bënë dhe kanë mbetur shembuj të ndritur të heroizmit popullor. Me këto tradita atdhetare dhe me frymëzimin e trimave e luftëtarëve u brumos dhe u edukua Rifat Manjani: me dashurinë për vatanin, me tiparet e spikatura të trimave që, pa iu tutur syri, dhanë jetën për liri e Atdhe.

Pra akti heroik i Dëshmorit të Atdheut nuk është fenomen i veçuar, por vazhdim dhe ngritje në një nivel të ri të traditave më të mira dibrane, burim krenarie për ne brez pas brezi. Në Luftën e Re , në Luftën Nacionalçlirimtare, në momentet më të vështira që kalonte kombi, Rifat Manjani diti të zgjedhë pa ekuivoke **rrugën e drejtë**: ***luftën pa kompromis dhe me të gjithë mënyrat kundër pushtuesve***, pa prit të presim dhe pa bërë llogari vetjake e familjare, por u përfshi në luftën sublime në dobi të Atdheut dhe lirisë së popullit tonë.

2. Rifat Manjani kishte ***vizion të qartë*** që në rrethanat e asj periudhe të shfrytëzonte me efikasitet dhe me çdo mënyrë qëllimin e madh final në dobi të bashkimit kombëtar. Ishte njeri i mësuar dhe pa komplekse duke e kuptuar drejt luftën e përbashkët të popujve ndaj armikut të përbashkët. Ai synoi dhe luftoi në kuadrin e luftës antifashiste për çlirimin e popujve nga bisha nazi-fashiste, pra që t'i luftonte këta agresorë kudo që mundej si dhe të mos harronte për asnjë çast ***çlirimin kombëtar*** dhe ***bashkimin e trojeve shqiptare***. Rifat Manjani qe një patriot i vërtetë, i cili nuk u josh kurrë nga armiqtë dhe tradhtarët dhe shërbëtorët e fashizmit dhe nazizmit. Ai , edhe pse shërbeu në repartet e ushtrisë italiane brenda dhe jashtë Shqipërisë, në plan të parë vuri interesat e atdheut dhe të popullit të tij. Edhe ky fakt del qartë në libër: ***Rifat Manjani pati qartësi të plotë gjatë gjithë jetës së tij, diti të orientohet drejt, të përkrahë dhe të mbështesë fuqishëm krahun demokrat përparimtar në ushtri e popull duke sakrifikuar shumë nga interesat vetjake.*** Figurën e tij e lartësojnë veprat e tij, sepse diti me zgjuarsi të kalojë në stadet e luftës duke mbajtur qëndrim të qartë e të prerë jo vetëm për vete, por dhe për shokët dhe të afërmit, te bashkëluftëtarët dhe te njerëzit e thjeshtë, duke fituar me meritë dashurinë, respektin dhe përkrahjen e ndihmën e tyre.

3. Rifat Manjani ishte ***antifashist i orëve të para***. Idetë e tij i kristalizoi në mjedisin shoqëror me ide të qarta si në Shqipëri ashtu dhe në vendin e pjellës së fashizmit, në Itali ku bëri studimet. Ai diti të dallojë koniukturat, mbajti qëndrim konseguent ndaj armiqve e shërbëtorëve të tyre dhe për ketë fitoi besimin e shokëve, të kolegëve dhe të vartësve dhe farefisit dhe miqve të tij. Në libër me shumë vërtetësi janë paraqitur qëndrimet e Rifat Manjanit në vigjilje të 7 prillit, në qëndrimet e veprimet burrërore, në pjesëmarrjen direkte si kuadër komandues në Brigadën I Proletare në Kolashin të Malit të Zi deri në përfshirjen përfundimisht me ndërgjegje të qartë në luftën çlirimtare në Veri të Shqipërisë në formacionet e Ushtrisë partizane shqiptare në Shqipëri e në Kosovë. Rifati luftoi shumë dhe i fitoi me veprën e tij vlerësimet e udhëheqjes së kohës së luftës duke bërë sakrifica të mëdha njerëzore dhe familjare. Nëse qe apo jo komunist, kjo nuk përbën aspekt vlerash, se vlerat e vërteta i ka vepra e tij që e lartësoi jo vetëm në sytë e popullit e bashkëluftëtarëve, por arriti që dhe armiku ta quajë të rrezikshëm dhe arriti që dhe në komunikatën e 2 shkurtit 1944 për Luftën e Vrakës, ku mes tjerash theksohet: *"... Në katundin Grilë forcat e gjindarmërisë së tri postave të rrethit në fjalë, të Vrakës, Rusit dhe t' Urës së Keqe kanë rrethue e janë ndeshë me nji çetë të përbame prej katër personash të armatosun komunista, ku me njizet minuta luftim që kanë ba kanë mbetun të vramë nga ana e partizanëve ish-kapiteni Rifat Manjani, i Zeqirit dhe i Nazes, lindun në fshatin Homesh (Zerqan) më 15. 10.1908... komunist rrezikshëm si dhe dy të tjerë..."* Na bën përshtypje që Vasil Shantos nuk i dihet mbiemri në telegramin përkatës, ndërsa Reshit Rusi identifikohet dhe sqarohet që, i plagosur rëndë, vdes në spitalin e shtetit Shkodër...

4. Rifat Manjani ishte një ***kuadër ushtarak i kompletuar*** dhe kjo ia rrit vlerat. Jo vetëm mbaroi me rezultate të shkëlqyera dhe me gradë më të lartë se kolegët e tij. Mbarimi i akademisë ushtarake dhe i kursi të lartë të artilerisë flasin për një përgatitje të lartë si oficer. Në dokumentet dhe kujtimet del qartë se niveli i tij vlerësohej edhe nga ushtarakët italianë. Janë ata që e ngarkuan me detyra të larta në Greqi, Ulqin etj. Edhe vlerësimi i lartë nga drejtuesit e Brigadës I Proletare Malazeze e tregon më së miri jo vetëm vlerësimin e tyre për kapitenin Rifat Manjani, por dhe besimin e tyre të plotë në besnikërinë si person i devotshëm.

Më ka bërë përshtypje shumë të madhe paraqitja e Rifat Manjanit përpara udhëheqjes partizane të Shkodrës nga Vasil Shanto dhe prandaj dua ta citoj: *"Ky oficer i ri është shumë i përgatitur është besnik e trim dhe shumë i gojës. Fjalët e tij i dëgjonin me shumë respekt shokët jugosllavë dhe malësorët shqiptarë. Kjo gjë i bënte shumë krenarë banorët shqiptarë në ato zona."* Autoriteti i tij i padiskutueshëm në formacionin partizan malazez dhe ndër banorët e luftëtarët shqiptarë është një tregues tjetër me vlerë për figurën e Rifat Manjanit.

5. Në çdo faqe të monografisë ndjehet atmosfera e kohës, por dhe ***shpalosen me realizëm dhe bukuri tiparet e trimit Rifat Manjani.*** Ne si lexues na trokasin fort në ndjenjat tona pasazhet reale të pasqyruara me një nivel të lartë letrar të rrëfimeve dhe përshkrimeve që ia rrisin vlerat librit për mendimin tim. Ka shumë momente që shprehen në mënyrë të figurshme të zgjedhur me stilin elegant të autorëve që e bën tërheqës leximin e librit. Nuk ka se si të mos ndjesh emocione të forta kur lexon kujtimet e bashkëkohësve e bashkëluftëtarëve të Rifat Manjanit.



Nderim: Populli ynë i ka përjetësuar djemtë e tij më të mirë edhe në rrëfimet e tij, por dhe në këngë e rapsodi duke edukuar brezat e rinj përmes odës dibrane.. Në libër edhe kënga e dëshmorit Rifat Manjani Kapidan, Lulja e trimnisë, shkruar nga Ramazan Ilnica si dhe balada prekëse "Flakadan Trimërie" e poetit dibran, zotit Mevlud Buci, mendoj që e kanë plotësuar më së miri imazhin e folklorit dibran që i përjetëson në këngë trimërie heronjtë e vet të nderuar. Vërtet kam ndjerë emocione të forta kur lexova dy këto krijime me vlerë dhe, me zemër dhe me mendje, i vlerësoj në mënyrën më të lartë krijuesit tanë që ia kanë "qëndisur" plot bukuri portretin e Dëshmorit të Atdheut, Rifat Manjani.

Kjo libër është kryesisht një kontribut me vlerë për dëshmorin Rifat Manjani, i cili i shndrit si diell rrugës atdhetare të dibranëve dhe gjithë shqiptarëve për shërbime e obligime për përparimin e shoqërisë dhe begatisë së Shqipërisë.

Përgëzoj dy autorët që kanë shkruar një monografi me vlera të spikatura si dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar në botimin e librit dhe tani e kuptoj dhe e miratoj me gjithë zemër fjalën e djalit të Dëshmorit të Atdheut, të zotit Zeqir Rifat Manjanit, të cilit ky libër *i ka dhënë kënaqësinë e realizimit të një obligimi të kahershëm që ka pasur gjatë gjithë jetës për të parë të botuar një libër për babanë e tij Rifat Manjani.*

Zeqir Rifat Manjani është shprehur bukur: *"Për mua dhe fëmijët e mi, me nipër dhe mbesa e farefis, këtë libër e kemi si një monument të pavdekshëm ndër vite"*.

Bashkë me të birin e dëshmorit, Zeqir Manjanin, gëzohemi të gjithë bashkë me të, krenohemi për veprën e ndritur të dëshmorit si dibranë e si shqiptarë **për Burra Dheu si Rifat Manjani!**

Le t'ju gjëmojë në shekuj brezave, kënga kushtuar Dëshmorit të Atdheut:

Burri i Dheut Rifat Manjani,
Trimi Dibrës drit' i bani!
Kapidan, lulja trimnisë
Yll i rrall' i burrërisë!...

1. Promovimi u zhvillua në Sallën e Akademisë së Shkencave më 16 shkurt 2013

Rruga e Arbërit nr. 84

portret



Prof.dr. VELI ZOGU,
një histori suksesi e shkollës dhe mjekësisë shqiptare

Nga **HYSEN LIKDISHA**

NË VEND TË HYRJES

10 shtator 1940. Në Zerqanin e natyrës së mrekullueshme, me pesë gurra uji të bollshëm e të pastërt si kristali, me emër të madh ndër vite në fushën e dijes dhe kulturës, lindi në kullën e Zogëve, në lagjen Tushaj, të këtij fshati, Veli Zogu, që pakkujt për të mos thënë askujt, mund t'i shkonte ndër mend që i sapolinduri do të bëhej përfaqësuesi më në zë i kësaj treve, që do të përligjte plotësisht emrin e madh të Zerqanit. Padyshim që Prof. Dr. Veli Zogu, me punën dhe veprën e tij në fushën e mjekësisë, jo vetëm që ka përligjur emrin e "Grykës së Madhe" (Zerqanit) që e lindi, por edhe e ka lartësuar edhe më shumë atë . Me punën dhe kontributin e tij human ndër vite në shërbim të sistemit shëndetësor, ai i ka dhënë emër, Zerqanit, Dibrës dhe mjeksisë shqiptare. Pa e zgjatur mjafton të themi një fakt që Prof. Dr. Veli Zogu, i ka kaluar të gjitha shkallët e sistemit shkollor në vendin tonë, me një vlerësim të vetëm, "shkëlqyeshëm", duke shënuar kështu një rekord unikal në lloin e vet, që rrallë, madje shumë rrallë, mund të përsëritet. Pa dashur të bëjmë filozofi, do thoja që historia kjo portë e madhe e jetës, gjithmonë mbetet e hapur për çdo njeri që kërkon të hyjë e të zërë vend në të, pavarësisht se si mund të jetë ai vend, i vogël apo i madh. Por, pa as më të voglën mëdyshje, do thoja që Prof. Dr. Veli Zogu, zuri një vend aspak të vogël, por një vend të madh plotësisht të merituar në të.

FËMIJËRIA DHE SHKOLLIMI

Veli Zogu, ishte fëmija i fundit në radhë i çiftit prindëror, Sadik e Sude Zogu, pas vëllait Saliut dhe dy motrave, Mines dhe Hazbies, pra "sugjari" siç dhe i thonë në gjuhën popullore këndej nga Dibra. Ndaj dhe ai gëzoi gjithë përkëdhelitë dhe dashurinë e prindërve të tij, veçanërisht babait Sadikut. pasi e ëma ndjesë pastë, ndërroi jetë kur ai ishte vetëm 12 vjeç. Sapo mbushi 6 vjeç, dha shenja të një interesi dhe dashurie të veçantë, për librat dhe shkollën, veç moshatarëve të tij. Duhet të ketë qenë një ditë e mesgushtit të 1946-tës, kur i ati, Sadiku, një burrë i urtë e i mençur e mjaft inteligjent nga natyra, që edhe timbri i butë i zërit e bënte të veçantë në të gjithë trevën e Grykës së Madhe (Zerqanit), me djalin e vogël përdore, Veliun, nis rrugën për ta regjistruar në shkollë. Kështu pa e ditur, por plot besim e shpresë, nis rrugëtimi për në tempullin e dijes, për vogëlushin Veli Zogu, një rrugëtim ky që nuk do ndalej kurrë më. Ka qenë ish drejtori i shkollës së Zerqanit, Idriz Biba, i cili në kontaktin e parë me vogëlushin 6 vjeçar, Veli Zogu, me siguri matematike zbuloi se fëmija gëzonte inteligjencë të nivelit të lartë. I ndodhur para këtij fakti, ai e regjistron atë në klasë të parë edhe pse ishte 6 vjeç dhe jo 7 që duhej sipas ligjit për të nisur mësimin e abetares me abc-në e bukur të gjuhës shqipe. Dhe talenti nuk zhgënjeu, pasi e përfundoi klasën e parë jo si moshatarët e tij, por me vlerësimin: "shkëlqyeshëm". Një vlerësim ky që e ndoqi atë, si asnjë tjetër, në të gjitha klasat e shkallët e shkollimit dhe kualifikimit pasuniversitar, e deri në marrjen e gradave shkencore, një rast i veçantë ky, në mos unikal. Me mbarimin e shkollës 7-vjeçare në vendlindjen e tij Zerqan, me rezultate të shkëlqyera, vijon shkollën e mesme pedagogjike në Peshkopi, ku mbaron vitin e parë të saj, me rezultate po të shkëlqyera. Ëndrra për tu bërë mjek, që flinte në koshiencën e tij, rindizet flakthi. Dëshira dhe vendosmëria e patundur për tu bërë mjek, tashmë tek 14 vjeçari adoleshent Veli Zogu, është plazmuar dukshëm, pa asnjë lloj ekuivoku. Përveçse ëndërrimit të moshës, kjo dëshirë kaq e madhe, duket se trashëgohet në genet e adoleshentit edhe nga prindërit, pasi i ati, Sadiku, zotëronte dhuntinë e mjekut popullor, që rregullonte duart dhe këmbët e thyera, për banorët në zonën e Grykës së Madhe (Zerqanit) dhe më gjërë. Për koinçidencë, pushteti vendor në Dibër, kishte kërkuar bursa për mjekësi, pasi rrethi kishte nevoja emergjente për kuadro në këtë fushë. Në këtë kuadër përfitoi edhe adoleshenti, Veli Zogu, të cilit i doli bursa për të vijuar Politikumin Mjekësor në Tiranë. Dëshira dhe talenti i tij në udhën e bukur të dijes edhe këtë herë nuk zhgënjyen. Ja çfarë shkruan për nxënësin Veli Zogu, ish drejtori i shkollës së ish Politeknikumit Mjekësor Tiranë, Zisa Cikuli, në dëftesën e klasës së parë, në rubrikën "shënime të drejtorisë": -" Asht i gjykueshëm dhe i zellshëm. Ka shkue shumë mirë me mësime dhe ka fitue stimën e profesorvet e të shokëvet. Prindërit të kujdesen që të mos i shmanget udhës që ka nisur, se vetëm në këtë mënyrë mund të bëhet i vlefshëm për popullin, për familjen dhe për vehte". Politeknikumin Mjekësor Tiranë, e mbaroi në 1958 me rezultatin "shkëlqyeshëm". Vera e këtij viti për 18 vjeçarin Veli Zogu, rezultoi tejet e "nxehtë", pasi nuk i jepet e drejta e studimit për në shkollën e lartë. Por, djali nga Zerqani i dijes e kulturës, me vullnetin dhe dëshirën e hekurt që e karakterizonte, për të vijuar pa u ndalur në rrugën e bukur e të vështirë të dijes, përsëri nuk "dorëzohet". Djali i brishtë, por me shpirt të madh, me energjinë pozitive e të pashterëshme që premtonte shumë për të ardhmen e tij, kërkon vetë të takohet me sekretarin e parë të rrethit të Dibrës, i cili për momentin ndodhej me pushime në Durrës. Kjo ndërhyrje e tij, bëri që ai të përfitojë bursën për vijimin e studimeve të larta në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës.

STUDENTI VELI ZOGU, NJË "YLL" I SHNDRITSHËM I FAKULTETIT TË MJEKËSISË NË U.T.

Studenti i Fakultetit të Mjekësisë në UT, Veli Zogu, ishte dhe do mbetet një yll i shndritshëm që rrallë shumë rrallë mund të përsëritet. Në pesë vitet e shkollimit të lartë, ai nuk njohu nota në vlerësimin e tij, por vetëm vlerësimin "shkëlqyeshëm", duke u bërë kështu një rast i veçantë për Fakultetin e Mjekësisë të UT-së. Profesoriati i këtij fakulteti, shquan tek studenti Veli Zogu, talentin e ardhshëm të mjekësisë shqiptare. Prof. Dr. Petrit Gaçe, duke parë talentin e spikatur të tij, që në vitin e tretë të studimeve, e merr studentin Veli Zogu si asisitent në të gjitha operimet që bënte. Kjo lidhje professor-student, bëhet solide, për të vijuar gjatë gjithë karierës së punës, duke u shtrirë gjithashtu jo vetëm në sferën profesionale, por edhe në atë shoqërore e familiare. Stimulimi që student në auditorët e Fakultetit të Mjekësisë, ishte mjaft sinjifikativ, që paralajmëronte të ardhmen e sigurtë të studentit Veli Zogu, për ngjitjen e tij në majat e shkencës mjekësore të vendit tonë.

MARRJA E DIPLOMËS PREJ ISH KRYEMINISTRIT MEHMET SHEHU

Veli Zogu, padyshim që do mbetet studenti legjendë ndër vite i Fakultetit të Mjekësisë në UT, pasi ka shënuar një rast krejt të veçantë, të paparë deri në atë kohë në këtë fakultet, për sa i takon mbrojtjes së diplomës e cila u transmetua edhe nëpërmjet Radio-Tiranës, medias më prestigjioze të kohës. Natyrisht që fenomeni Veli Zogu, bëri bujë edhe në Ministrinë e Arsimit, e cila e reklamoi një rast të tillë edhe në Këshillin e Ministrave të kohës. Vetë ish kryeministri i kohës, Mehmet Shehu, pasi njihet me këtë rast, vendos që të marrë pjesë në ceremoninë e organizuar për t'i dhënë diplomën Veli Zogut, si dhe për tia dhënë atë me dorën e tij, duke i dhënë kështu rëndësinë e duhur këtij rasti të papërsëritshëm. Gjatë dhënies së diplomës, në fjalën e tij ish kryeministri Mehmet Shehu, tha ndër të tjera se për mjekësinë shqiptare "lindi një Shirokë i dytë". Përshëndeti në Radio-Tirana edhe vetë mjeku i sapodiplomuar shkëlqyeshëm, Veli Zogu.

PUNA DHE KUALIFIKIMET

Nisur për nga rezultatet e shkëlqyera, ai fill pas diplomimit emërohet pedagog në Fakultetin e Mjeksisë (UT), ku dhe specializohet si kirurg i përgjithshëm në Tiranë. Pas dy vitesh punë, rrethi i Dibrës, kërkon që Veli Zogu të kthehet për të punuar në spitalin e Peshkopisë, pasi kishte shumë nevojë për të, si dhe ishte një porosi e dhënë nga udhëheqja e lartë që kuadrot të punojnë pranë rretheve të tyre. Por kjo nuk funksiononte për Veli Zogun, pasi ai ishte e ardhmja e mjekësisë shqiptare. Ndaj vetë një nga ish udhëheqësit e lartë të kohës, Hysni Kapo, ndërhyn për anullimin e vendimit për të kthyer në Dibër mjekun e talentuar Veli Zogu, pasi ai i duhej jo vetëm Dibrës, por gjithë Shqipërisë. Po këtë vit, pra më 1965 shkon për specializim si kirurg kardiovaskular në Kinën e largët. Gjatë specializimit në Kinë, befasoi profesorët kinezë me operacionet e vështira që kreu në klinikast e tyre, ku operon 85 pacientë, të gjitha këto operime të suksesshme pa asnjë rast vdekjeje. Por, këmbëngulja e Dibrës për ta tërhequr atë në spitalin e Peshkopisë, vijon të mbetet evidente, ku ndërthurej ndoshta edhe dëshira e autoriteteve lokale për tërheqjen e kirurgut të talentuar, por edhe ndonjë xhelozi ndërmjet kolegësh. Kështu në vitin 1967, kërkohet sërish nga rrethi i Dibrës. Edhe këtë radhë është dashur një tjetër ndërhyrje nga lart dhe konkretisht nga Simon Stefani, që ai të mos luajë nga Tirana. Ndërkohë pas Kinës, vijojnë specializimet për kirurg kardiovaskular në Itali dhe Francë, në klinika mjaft prestigjioze të këtyre shteteve, ku spikat dukshëm inteligjienca dhe talenti i pionierit të kirurgjisë kardiovaskulare të mjekësisë shqiptare Veli Zogu. Me një përkushtim e vullnet të jashtzakonshëm, vijon të punojë njëherësh si pedagog e kirurg në Spitalin e Tiranës. Që nga viti 1963, kur sapo kishte përfunduar shkollën e lartë ai ka dhënë mësim në Fakultetin e Mjekësisë në lëndën "Anatomi Normale", deri në vitin 1965. Nga viti 1965 deri në vitin 1992, ka vijuar të japë mësim në lëndën e "Kirurgji e Pergjithshme" . Ndërsa në vitet 1993-2008, në lëndën "Kirurgji Kardiovaskulare". Shef i sherbimit te kirurgjise kardiovaskulare ne vitet 1993-2004. Anëtar i komitetit të Shkencës e Teknikës në vitet 1982-1990. Anëtar i Këshillit Shkencor të Fakultetit të Mjekësisë në vitet 1983-2004. Anëtar i Këshillit Shkencor të Universitetit të Tiranës në vitet 1983-1990, etj. Drejtues mësimesh praktike si me studentët, po ashtu edhe me specializantët pasuniversitar nga fillimi i punës e deri sa doli në pension me dëshirën e tij. Veç dualizmit pedagog-kardiokirurg, hobi i doktorit ishte dhe mbeti libri, të cilin nuk e lëshoi për asnjë çast nga dora. Një erudit i vërtetë që zotëronte një kulturë të përgjithshme brilante, ku hobi i tij përveçse mjekësisë ishte edhe histori-gjeografia. Me zellin e përkushtimin për dijen, arrin të përvetësojë katër gjuhë të huaja si, rusisht, italisht, frëngjisht dhe anglisht, ku literatura mjekësore e bollshme në këta gjuhë e ndihmoi atë në rritjen profesionale të tij.

POSTE DREJTUESE. TITUJ E GRADA SHKENCORE

Natyrshëm që për mjekun e talentuar, Prof. Dr. Veli Zogu, nuk munguan as postet drejtuese në mjekësi, por as edhe titujt e gradat shkencore, duke bërë që ai të kapë majat e mjekësisë shqiptare. Kështu me zellin dhe vullnetin e pashtershëm, me një punë studimore intensive në fushën e mjekësisë, arrin që më 25 dhjetor 1981, të mbrojë marrjen e titullit "Kandidat i Shkencave Mjekësore". Ndërsa më 3 qershor 1983, merr titullin "Docent" dhe më 23 qershor 1989, titullin e lartë shkencor "Doktor i Shkencave". Me një zell e vullnet për tu admiruar, energjik e i pandalshëm, në punën studimore në fushën e mjekësisë, realizon punime shkencore ku përfshihen libra, artikuj shkencor dhe referate në simpozume e konferenca shkencore si brënda ashtu edhe jasht shtetit. Në total përmendim jo pak, por 120 punime shkencore, prej të cilave 4 libra mjekësorë, 60 artikuj shkencorë dhe 56 referate shkencore, të gjitha të vlerësuara brënda e jasht vendit. Kjo prodhimtari e lartë shkencore, bën që Dr. Veli Zogu, më 13 dhjetor 1994, të marrë titullin e lartë shkencor Profesor në fushën e mjekësisë. I heshtur, tejet modest, larg bujës e mburrjes, pa asnjë lloj përkrahje e mbështetje të kohës, por me iteligjiencë e aftësi të lartë profesionale, ai tërheq dukshëm vëmendjen jo vetëm të kolegëve, por edhe të nomenklaturës së lartë të shtetit. Kjo bëri që natyrshëm atij t'i ofrohen dhe poste të larta në mjekësi edhe pse një gjë e tillë nuk u bë kurrë pasion i tij. Kështu në vitin 1983 i ofrojnë postin e dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, që refuzohet prej tij, pasi kariera nuk ishte objeksion i tij dhe e pengonte shkencëtarin në punën e tij studimore-shkencore që kishte nisur. Detyrohet të pranojë postin e dekanit me vështirësi, vetëm kur kushtëzon ish pushtetarët e kohës që të shtojnë në organikë edhe një zv.dekan, që ai të ketë mundësi që të mos i ndahet përkushtimit të tij profesional në mbrojtje të shëndetit të njerëzve. Si kirurg i përgjithshëm ka kryer me cilësi të lartë pothuajse të gjitha llojet e operacioneve në të gjitha organet e trupit. Gjatë gjithë karierës së tij nuk e lëshoi bisturinë nga dora, që për hir të së vërtetës duhet thënë se e përdori atë me një mjeshtëri të lartë, si pakkush tjetër. Po kështu edhe në kirurgjinë kardiovaskulare ka kryer një numër shumë të madh operacionesh të komplikuara duke e renditur atë në radhën e gurthemelit të kësaj disipline të mjekësisë shqiptare. Talenti, vullneti, këmbëngulja, puna plot pasion e përkushtim, në shërbim të shëndetit të njerëzve anekand Shqipërisë, bënë që ai të vlerësohet e çmohet nga "ajka" e mjekësisë shqiptare Prof. Dr. të nderuar si, Petrit Gaçe, Rushen Golemi, Ali Ajlushani, Ylli Popa, Sali Berisha, Nestor Tereska, Anesti Kondili, Ali Refatllari, Arben Baboçi, Spiro Qirko, etj. Kështu në një operim të vështirë të një pacienti, të cilin ja kishte rekomanduar një i afërt i tij, që asnjë kirurg nuk e merrte përsipër pasi nuk jepte garanci, Prof. Dr. Veli Zogu shpërvesh mëngët dhe jep garanci për suksesin e tij. –"Mos e opero, i thanë kolegët se do të të mbesë në dorë". –Nuk kam çfarë bëj, përgjigjet profesori, pasi edhe kështu ky është i vdekur. Me talentin e jashtzakonshëm që e karakterizonte në përdorimin e bisturisë, i heq pacientit rreth 2/3 e stomakut duke ja lënë atë sa një kuti shkrepseje. Pas operimit, i cili zgjati plot 6 orë, kolegia e nderuar Rushen Golemi, që asistoi në këtë operim, e cilësoi Prof. Dr. Veli Zogun me shumë superlativë; "mjeku me duar të arta". Ndërsa një tjetër koleg dhe mik i tij, Prof. Dr. Ali Ajlushani, ish Ministër i Shëndetësisë, pasi ka asistuar në një operim tepër të vështirë që ka realizuar Dr. Veliu, është shprehur kështu për të: -" Zoti bën mrekullira, duart e mjekëve i shkojnë pas. Të lumtë, ishte një operim i përkryer". Prof. Dr. Veli Zogu, nuk ka punuar për asnjë moment në ish Klinikën e Udhëheqjes të kohës, por thirrej në raste të veçanta për konsulencë, duke mbetur kështu gjithmonë në shërbim të njerëzve të thjeshtë. Vitet '90-të në historinë e demokracisë shqiptare, Fakulteti i Mjekësisë, pjesë përbërëse e të cilit ishte edhe Prof. Dr.

Kontributi i dibranëve për arsim dhe i shkollës shqipe është evident edhe në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit më 1878 që krahas Abdyl Frashërit dhe shumë veprimtarëve të tjerë, një nga udhëheqësit e saj ishte edhe Iljaz Pashë Dibra

Veli Zogu, do kujtohet gjatë. Kjo për faktin se ishin pedagogët dhe studentët e tij, ndër të parët që formuluan peticionet ndaj regjimit, me kërkesa konkrete për demokratizimin e jetës së vendit e me orientimin drejt vlerave intelektuale perendimore. Edhe pse i lidhur pazgjidhshmërisht me Fakultetin e Mjekësisë dhe punën plot përkushtim në dobi të shëndetit të pacientëve nga e gjithë Shqipëria në Spitalin Nënë Tereza, Prof. Dr. Veli Zogu kontribuoi në proçeset demokratike duke u angazhuar direkt në to, me pranimin e kandidaturës për deputet të PD-së në Dibër, në zgjedhjet e 31 marsit të vitit 1991. Por,lidhja me profesionin e mjekut ishte aq e fortë, sa bëri që ai të mos shkëputet për asnjë çast nga klinika e kardiokirurgjisë, duke mbetur kështu gjithmonë në shërbim te jetëve njerëzore.

MODELI I MJEKUT DHE FAMILJARIT SHEMBULLOR

Prof.dr. Veli Zogu, është dhe do mbetet përgjithmonë modeli i njeriut të përsosur, jo vetëm në fushën profesionale, por edhe atë shoqërore e familiare. Larg çdo vesi si alkooli apo duhani, ishte dhe mbetet modeli i njeriut familiar të përsosur. Ai gëzon një familje të përsosur në çdo pikëpamje. Bashkëshortja Violeta, ka punuar mjeke në Spitalin e Tiranës, një grua kjo e nderuar dhe respektuar. Nga dy fëmijët e tij të mrekullueshëm, vajza Aida, ka ecur në gjurmët e tij, e cila që nga klasa e parë fillore e deri sa ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë, ka njohur vetëm notën 10-të. –"Babai, tregon Aida, nuk ishte njeriu që ndërhynte për favore, qoftë edhe për ne fëmijët e tij edhe pse gëzonte reputacion e mundësi efektive për një gjë të tillë. Kur isha në shkollë të lartë rrezikoja të prishja notën 10-të në lëndën e edukatës ushtarake. Babai nuk ndërhyri për favore tek pedagogu i ushtarakes, por i mori çelësin e depos ushtarake zëvëndës-dekanit, që unë të mësoja pjesët e pushkës që të vlerësohem me notën 10-të". Mbarimi "shkëlqyeshëm" i shkollës i dha asaj mundësi që të integrohet në mjekësinë amerikane, ku aktualisht punon në një nga klinikat e dëgjuara të Neë-Yokut. Ndërsa djali Iljani, ka mbaruar me rezultate shumë të mira për arkitekturë dhe ndodhet edhe ai në ShBA. Sistemimi i fëmijëve në SHBA, fillimisht detyroi mamanë Violetën, që të shkonte praën tyre. Ndërsa Profesori edhe pse në kushte të vështira, pasi mbeti i vetëm në Tiranë, falë përkushtimit ndaj profesionit, vijoi punën me stoicizëm deri në vitin 2008-të, kur dhe u detyrua të udhëtonte drejt Neë-Yorkut, për t'iu bashkuar familjes gjësë më të shtrenjtë të tij. Kur kërkoi të dilte në pension, në moshën 68 vjeçare, ju lutën që të vijonte punën: -"Për ty mund të bëhet çdo përjashtim, -i thanë". Por ai zemërthyer nuk pranoi të vijonte punën më gjatë, pasi ishte i detyruar për t'iu bashkuar familjes, për ta mbajtur atë ashtu të bashkuar e harmonike si ngahera. Kolegët Prof.dr. ndër emrat maja të mjekësisë shqiptare nga më të dëgjuarit në vendin tonë si ; Ajli Alushani, Tritan Shehu, Ali Refatllari, Rushen Golemi, Nina Kaja, Artan Godo, Arben Baboçi, etj, etj, të na falin një pjesë pasi nuk mund t'i përmendim të gjithë, kanë organizuar me iniciativë të tyren një ceremoni madhështore të hareshme në nderim të merituar për Prof.dr. Veli Zogun, me rastin e ndërprerjes së punës. Ai duhet thënë se është larguar vetëm fizikisht nga klinika e kardiokirurgjisë, pasi shpirtërisht vijon të mbetet pranë saj. Vitin e kaluar kur dhe erdhi nga Amerika, vizitën e parë nuk harroi tua bënte pikërisht kolegëve e tij që aq shumë e deshën dhe i deshi.

NË VEND TË MBYLLJES

Që kur mora përsipër të shkruaj këto radhë për Prof.dr. Veli Zogu, isha i ndërgjegjshëm se sado të përpiqesha për ta dhënë të plotë këtë figurë, kurrë nuk do t'ia arrija. Megjithë përpjekjet që bëra për ta plotësuar figurën e tij, e ndjej që kam lënë mangët shumë gjëra. Për këtë i kërkoj ndjesë Profesorit të nderuar. Për të qenë i sinqertë me lexuesit, shpresoj e besoj, që kam hapur një dritare sado të vogël, për të hedhur dritë në plotësimin e portretit të Prof.dr. Veli Zogu, për ata që mund dhe duhet të guxojnë në këtë drejtim, pasi çfarëdo që të shkruesh përsëri e përsëri do lësh e do mbetesh mangët në dhënien e portretit të plotë të kësaj figure.

Arsimi dhe shkollat shqipe në Dibër

Nga: **Mr.sc.RREZEHANA HYSA**

Dibra si qendër e rëndësishme e kulturës dhe arsimit shqiptar i dha Lëvizjes Kombëtare Shqiptare një numër të konsiderueshëm të patriotëve të shquar shqiptarë, të cilët me pushkë e me penë kontribuan për çështjen kombëtare para dhe pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë si:Vehbi bej Dibra,Said Najdeni,Josif Bageri,Iljas Pashë Dibra,Mersim Dema,etj.

Përpjekjet e para për arsim dhe hapjen e shkollës shqipe në Dibër i gjejmë qysh me hartimin e "Abetares" së Naum Veqilharxhit,më 1844,ndërsa më vonë edhe me "Abetaren" e Konstandin Kristoforidhit e botuar në Stamboll më 1867 me dialektin gegë dhe me alfabetin latin, për shpërndarjen e së cilës erdhi vetë Konstandin Kristoforidhi në atdhe, i cili krahas abetareve solli me vete edhe libra të tjerë të karakterit fetar por të përkthyer në gjuhën shqipe.Entuziazmin nga mikëpritja që i bënë atij popullata shqiptare në shumë qytete të Shqipërisë e veçanërisht në qytetin e Dibrës me rastin e promovimit dhe sjelljes së abetares dhe librave të tjerë shqip ai e shprehu në një letër të vitit 1871 dërguar dibranëve në shenjë mirënjohje.

Kontributi i dibranëve për arsim dhe i shkollës shqipe është evident edhe në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit më 1878 që krahas Abdyl Frashërit dhe shumë veprimtarëve të tjerë, një nga udhëheqësit e saj ishte edhe Iljaz Pashë Dibra,i cili e kryesoi Kuvendin e përgjithshëm të saj më 1 nëntor 1878. Në këtë Kuvend veç tjerash u miratua një Rezolutë në të cilën kërkohej krijimi i Vilajetit autonom shqiptar, hapja e shkollave kombëtare shqipe të financuara nga shteti, përfshirja e mësuesve shqiptarë në shkollat turke të kohës, inkuadrimi i gjuhës shqipe në shkollat turke në Shqipëri, kultura pedagogjike të përhapej me anë të revistave,gazetave dhe librave shqip, ndërsa një pjesë të detyrave edukativo-arsimore duhet tu besohet shoqërive kulturore dhe klubeve etj. Kërkesat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në formë Memorandumi iu dërguan Sulltanit në një delegacion prej 14 anëtarësh të kryesuar nga Iljaz pashë Dibra, personalitet me kulturë dhe ndikim të madh,i cili më vonë më 20 tetor 1880 kryesoi Kuvendin e dytë të Dibrës ku u paraqit si udhëheqës i moderuar.

Ndër personalitetet e shquara dibrane i cili kontriboi në hapjen e arsimit dhe shkollës shqipe në Dibër dhe më gjërë ishte edhe veprimtari i shquar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare Said Najdeni, bashkëkohës dhe bashkëveprimtar i vëllezërve Frashëri,Ismail Qemalit, Dervish Himës, Hamdi Ohrid, Seid Toptanit, Kristo Luarasi, Mersim Demës etj.i cili me eurudicionin e tij gjegjësisht njohës i shumë gjuhëve të huaj, qysh si student shkroi veprën"Fe-Refenja e muslimanëve" e cila përveç karakterit fetar mund të konsiderohet si fjalor i çmuar kombëtar.Vepra u botua me vështirësi në vitin 1900 në shtypshkronjën ,,Mbrothtësia,,të Kristo Luarasit në Sofje në të folmen e Dibrës dhe me pseudonimin Hoxhë Voka.Po në të njëjtin vit dhe po në të njëjtën shtypshkronjë gjegjësisht në shtypshkronjën e Kristo Luarasit më 1900 botoi edhe "Abetaren e gjuhës shqipe",në të folmen e gegënishtes me 16 faqe.Abetarja e Said Najdenit shquhet për vlerat didaktike,për strukturën morfologjike e leksikologjike dhe shërbeu si manual bazë për shumë tekste shkollore gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe më vonë.Ai bashkë me shumë bashkëkombas të tij në vitin 1888 hapën shkollën e parë laike shqipe në Dibër e cila u hap dhe mbyll disa herë deri në vitin 1893.

Përveç shkollës së Said Najdenit në Dibër kanë egzistuar edhe disa shkolla të tjera të vogla të formuara ilegalisht në të cilën mësimin e ndiqnin shumë shqiptarë. Kësisoj në fillim të vitit 1899 falë këtyre shkollave kishin mësuar të lexojnë dhe të shkruajnë më se 300 dibranë.Një kontribut për mbajtjen e këtyre shkollave dhe kontaktin me rrethet patriotike kombëtare shqiptare gjegjësisht në sjelljen e librave në gjuhën shqipe prej viseve të tjera në Dibër ka dhënë Shaqir Daci,Kadri Fishta,Selim Rusi etj.

Veprimtari dhe patrioti i shquar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare Mbreti i maleve Mersim Dema bashkë me Shaqir Dacin bashkëkohës i Said Najdenit më 14 mars 1894 në shtëpinë e tij në Homezh hapi shkollën e parë shqipe,që fatkeqësisht nuk dihet sa nxënës ka pasur shkolla por emrat të cilat përmenden janë:Jashar Zeneli nga Bllaca,Tofik Kurti nga Boçeva,Gani Meta nga Kovashica etj.Autoritetet osmane e sidomos prefekti turk,shkollën e parë shqipe në Homezh,gjegjësisht në shtëpinë e Mersim Demës,bëri përpjekje që ta mbyllte ndërsa Mersim Demën dhe Shaqir Dacin ti arrestonte mirëpo populli i prekur nga këto veprime të Menduh Pashës u mblodh në një Kuvend dhe në shenjë proteste dërguan një Memorandum te Sulltani në Stamboll që ta largonte nga funksioni Mendu Pashën nga Dibra brenda 24 orësh ose në të kundërtën do të përdorin forcën.Stambolli i trembur nga kërcënimet e dibranëve e largoi Mendu Pashën nga Dibra.Shkolla shqipe e Homezhit u hap dhe u mbyll disa herë deri në vitin 1912.

Në Kuvendin e Dibrës më 1899 veç tjerash është shtruar me forcë edhe problemi arsimit në gjuhën shqipe dhe hapjen e shkollave kombëtare shqipe,për të cilën u prononcua edhe vetë Konsulli austro-hungarez dhe ai rus menjëherë pas mbajtjes së Kuvendit. Kërkesa e dibranëve për mësim në gjuhën amtare e dalur nga Kuvendi i Dibrës në formë Memorandumi iu dorëzua Sulltanit në vitin 1899 ku ndër të tjera thuhej:"Meqenëse në qytetin e Dibrës flitet vetëm shqip dhe se fëmijët tanë nuk kanë pasur mundësi të mësonin legalisht gjuhën shqipe, zemrat e tyre janë mbushur me hidhërim të thellë.Prandaj kërkojmë lejimin dhe hapjen e shkollave shqipe në qytetin e Dibrës,ku së fundmi shpenzimet për mbarëvajtjen shkollës shqipe,dibranët janë të gatshëm ti paguanin vetë".Kërkesë e cila nuk u aprovua nga pala turke.

Pas hapjes së shkollës shqipe të Said Najdeni me inciativën e vetë dibranëve më 1901 u hapën menjëherë 7 shkolla shqipe në fshatrat e Dibrës së sipërme,Dibrës së poshtme dhe në rrethin e Matit.Andaj gazeta e mirënjohur "Drita" e Sofjes më 1901 shkruante:se në Dibër të madhe të vogël,Mat dhe Rekë ka shumë atdhetarë të cilët përpiqen për përhapjen e arsimit dhe gjuhës shqipe duke u nisur nga postulati: "se me gjuhë rruhet mëmëdheu dhe me shkolla mësohet kombi".

Në mars të vitit 1902 veprimtarët dibranë me vetëinciativë vendosën të hapnin 7 shkolla shqipe, 3 në Dibër të poshtme,2 në Dibër të sipërme,2 në Mat duke përfshirë edhe fshatrat ku numri i nxënesve ishte shumë i madh,biles aty kah viti 1905 pranë mejtepeve u hap edhe një konvikt. Në vazhdën e hapjes së shkollave shqipe në gusht të vitin 1910 në Dibër përveç tjerash u hap edhe Shkolla Normale e cila në vitin e parë kishte dy paralele me gjithsejt 115 nxënës ndërsa kuadri mësimor ishte kryesisht shqiptarë.

Veprimtari të mirrëfilltë në Dibër me rrethinë në kohën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe më vonë luajti Josif Bageri,bashkëveprimtarë i ngushtë me Dervish Himën, Said Najdeni dhe Jashar Erebarën etj. Në formimin e tij ndikuan fuqishëm patrioti Dhimitër Mole nga Korça të cilin Josif Bageri e takoi në Sofje dhe takimi në Stamboll me Naim Frashërin në vitin 1899 para se të vdiste ai,biles takimi me Naimin ishte një shtytje më e madhe drejt rrugës patriotike që kishte zgjedhur ai. Në kohën kur Josif Bageri bashkëvepronte në Sofje të Bullgarisë numri i shqiptarëve atje po rritej dita ditës,andaj patriotët shqiptarë më 1 janar 1893 pa dallime feje dhe krahine themeluan shoqërinë shqiptare të Sofjes me emrin "Dëshira" në të cilën Josif Bageri bashkëveproi për rreth 17 vjet.Fitoren e revolucionit xhonturk të verës së vitit 1908,që shqiptarëve u premtoi gjoja barazi me popujt të tjerë të cilët ishin në juridiksionin turk,Josif Bageri e priti me entuziazëm të madh saqë u kthye në atdhe gjegjësisht në fshatin e tij të lindjes në Nistrovë dhe në fund të shtatorit të vitit 1908 hapi shkollën në gjuhën shqipe.Edhe pse dëshira e tij për hapjen e shkollës shqipe ishte në qytetin e Dibrës,mirëpo autoritetet osmane e pengun një gjë të tillë andaj ai u detyrua që shkollën shqipe ta hapë në Nistrovë të Rekës së epërme.Josif Bageri edhe pse intelektual autodidakt në vitin 1909 arrin të jetë redaktor i gazetës "Shqypja e Shqypnisë"e cila botohej në Sofje dhe ushtroi një ndikin të madh në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.Gazeta në artikujt veç tjerash fliste edhe për rrezikun e asimilimit të një të ashtuquajtur konfederatë midis shkollës bullgare, greke dhe kishës othodokse për othodoksët shqiptarë të kësaj ane.Veç tjerash Josif Bageri është edhe autor i disa veprave dhe materialeve të tjerave propaganduese shqiptare.

REZYME

Lufta e shqiptarëve për arsim dhe shkollë shqipe sikur në shumë vende të tjera të Shqipërisë po ashtu edhe në Dibër u intestifikua edhe më shumë gjatë viteve 1908-1912 biles në këtë periudhë u shënua një arritje e dukshme e arsimit dhe shkollës shqipe për rrethanat dhe kushtet e atëhershme.Në këtë kohë në Dibër dhe rrethinë u hapën rreth 10 shkolla shqipe ,pa përshirë këtu shkollat dhe kurset e natës dhe mësimin e gjuhës shqipes në forma individuale dhe mësimin në shkollat turke të kohës. Gjatë kësaj periudhe në Vilajetin e Manastirit u formuan rreth 10 klube dhe shoqëri atdhetare pa përmendur disa organe shtypi në gjuhën shqipe që u botuan në Manastir dhe Shkup.Këto veprime i dhanë një shtytje të rëndësishme përhapjes së arsimit dhe gjuhës shqipe ,në prag të pavarësisë së Shqipërisë.

Lëvizja patriotike që u organizua në Dibër për arsim në vitet 1908-1912 ndihmoi në përgaditjen e një brezi mësimdhënës të cilët pas shpalljes së pavarësisë punuan në rrjetin e gjërë të shkollave që u hapën në tërë Dibrën. Në fillim të vitit 1912 nga Dibra u dërgua një delegacion në Manastir. Qëllimi i së cilëve ishte të kërkojë leje që të hapen shkolla shqipe dhe se pa miratimin e kërkesës për hapjen e shkollave shqipe nuk do të ktheheshin në Dibër.Pas shumë presion anëtarët e delegacionit shqiptarë nxorën leje për një shkollë shqipe nga pala turke.Shkollë e cila u hap në qytetin e Dibrës më 10 mars 1912 gjegjësisht disa muaj para shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Dibranët duke qenë arsimdashës këmbëngulën që pranë shkollës normale të qytetit të Dibrës të hapet një drejtim në gjuhën shqipe ku do të mësonin rreth 20 djem të cilët pas një periudhë 3 mujore do të shërbenin si mësonjës të gjuhës shqipe.Ky veprim i inspiroi shumë dibranë që ti hapin vendbanimet e tyre për ti shëndruar në shkolla.

Rruga e Arbërit nr. 84

Libri është pritur me shumë interes dhe e është vlerësuar si një kontribut shtesë polivlerash për Dibrën dhe Shqipërinë të Prof.dr. Kristo Frashërit. Ai i dhuroi Dibrës dhe dibranëve një dokument shumë të rëndësishëm si testament besnikërie, bujarie e atdhetarizmi.

recensë

Një kontribut polivlerash

Nga **FAIK XHANI**

Në kudrin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë doli në qarkullim libri "Historia e Dibrës" e botuar nga M&B dhe autor Prof. Dr. Kristo Frashëri. Nga dalja e këtij libri ka patur edhe qefmbetje, mosvlerësim si duhet, koncepte dhe vlerësime të ndryshme. Përgjithësisht nga lexuesi i thjeshtë dibran dhe shqiptar libri është pritur me shumë interes dhe krenari. Nga një pjesë intelektualësh dibranë, studiues e botues ka patur edhe ndonjë rezervë e zili si: "Pse duhet të na e bëjë historinë e Dibrës një japanxhi?" " Nuk na ka thënë ndonjë gjë te re profesori" etj.

Ndryshe ka reflektuar elita intelektuale dibrane dhe intelektualët e Shqipërisë. Ata e kanë pritur librin me shumë interes dhe e kanë vlerësuar si një kontribut shtesë polivlerash për Dibrën dhe Shqipërinë të Prof. Dr. Kristo Frashërit. Dhe vërtetë ashtu është. Ai i dhuroi Dibrës dhe dibranëve një dokument shumë të rëndësishëm si testament besnikrie, bujarie e atdhetarizmi. Me këtë botim Profesori i nderuar konfirmoi në mënyrën më të mirë rolin dhe kontributin që ka dhënë Dibra e dibranët në rrjedhat e kohërave e të historisë së Shqipërisë e të kombit shqiptar.

Në këtë botim Dibra shpaloset si trevë e lashtë, autoktone me zhvillim e progres në rritje, me civilizim e qytetrim mijëravjeçar, një trevë me veçori dalluese, kontribute të vyera atdhetarie, besnikërie e mençurie. Ajo vjen si një ndëshkuese e ashpër nga masakrat, barbarizmat dhe gjenoicidi i ushtrive pushtuese, por qëndrestare, sakrifikuese deri në sublimitet të jetës së bijëve të saj për mbrojtjen e trojeve arbërore.

Dibra në këtë libër konfirmohet në mënyrën më të mirë si vendlindja e heroit tonë legjendar Skënderbeut, si mbështetsja, besënikja dhe prapavia më e sigurtë në epopenë 25-vjeçare Skënderbegiane.

Dibra erdhi në 100-vjetorin e pavarësisë me testamentin e Prof.Dr. Kristo Frashërit "të besikërisë, bujarisë dhe atdhetarisë".

E gëzofshi historinë e ndritur dibrane!

Ky libër është një kontribut shtesë i Prof. Dr. Kristo Frashërit që i ndrit jo vetëm historisë së Dibrës e dibranëve, por gjithë Shqipërisë dhe shqiptarëve. Ai është një nga modelet më të mira të hartimit të një historiku të një treve siç është Dibra me viset e saja ku spikat vërtetësia, argumenti, analiza e thellë, reflektimi, deduktimi shkencor dhe përfundimi mesazhor.

Ky botim është dëshmia më e mirë e lidhjes dhe ndërveprimit të shkencave të arkeologjisë, të toponomistikës dhe historisë. Ai është përgatitur mbi bazën e analizës së gjetjeve arkeologjike, tipologjisë së tyre, toponomisë, metodës së krahasimit dhe deduksionit.

Autori niset nga e vërteta, nga hipoteza të shumta dhe falë përvojës së tij disavjeçare si dhe uridicionit shkencor argumenton e përligj ndodhitë, ngjarjet, betejat, protoganistët dhe deputuesit e kësaj historie. Me gjithë këtë në disa raste nuk pranon të bëjë aludime dhe nuk ka frikë të pohojë mungesën e ngjarjeve, vendeve, apo të kohës së ndodhjes së tyre. Ai nuk rreh gjoksin, por e lë shtegun hapur që këto errësira, ekojvoke, rrethana, vende e personazhe të gjurmohen e hulumtohen.

Meritë e Profesorit është edhe fakti që ai i pranon hipotezat e ndryshme, i shfaq ata me saktësi, u vë atyre argomenta të sakta dhe mbi këtë bazë pa ulur e pa fyer asnjë, dedukton në mënyrën më të plotë për faktin, ndodhinë, figurën, betejën etj. Ai vetëm pasi ka argumentuar me referenca të sakta, kryesisht dokumenta të autorëve shqiptar dhe të huaj, mbyll trajtesën duke i dhënë lexuesit por edhe atyre që pohojnë, mohojnë, që konkludojnë gabimisht e padrejtësisht , pasaktësisht ose qëllimisht, të VËRTETËN, para së cilës dorëzohet gjithkush. Të tilla evenimente e trajtime janë të shumta në këtë libër si: ajo për origjinën ilire të Dibrës, për Sinën e Qidhnën si vednlindja e Skënderbeut, për shërbesat e kontributin e tij si spahi e Subash, për rolin diplomatik të asaj kohe etj.

Autori i këtij libri, Prof. Dr. Kristo Frashëri nuk shkruan për t'i bërë qejfin dikujtë, për të ngrit Dibrën pa meritë apo ndonjë personazh të veçantë, për të plotësuar qoftë edhe dëshirën e vet, por stërmundohet shumë në vetvete derisa të sjelli për lexuesin argumentin shkencor apo dekumentin e shkruar. Vetëm mbi bazën e fakteve dhe argumentave përshfaq trajtimin e tij, bën intepertimin e ngjarjeve apo ndodhive dhe pastaj dedukton përfundimisht. Kjo përshfaqet më së miri në pasqyrimin e vlerave të dy Dibrave, asaj të Epërme dhe të Poshtëme. Secila paraqitet me fizionominë e saj, me veçoritë e saj dalluese, por edhe me përqasjet e ndërveprimet reciproke si pjesë të një trungu, trualli autokton me prejardhje ilire, ku njera shfaqet me element dallues më të ndriçuar të origjinës së vjetër, kurse tjetra si më sakrifikuesja si paraprita e të gjitha ekspeditave pushtuese, njëra më e lirë, më e pavarur, më shpërthyese e më e paasimiluar, kurse e Epërmja më punëtore, më e kamur, më e matur, por që të dyja krah njëra-tjetrës, veçanërisht kur e kanë lyp interesat e mëdha të vendit e të kombit.

Libri është i ndarë në 34 krenë ku secili ka një nëntitull kuptimplot, ka një shtojcë dekomentash prej 182 faqesh, treguesin e emrave, treguesin e vendeve dhe treguesin tematik. Ai rrok një periudhë kohore nga lashtësia e deri në mars të vitit 1939 dhe një volum lëndor prej 620 faqesh. Tematika e librit është e larmishme, e koncentruar, e periodizuar dhe e klasifikuar më së miri. Pikërisht përcaktimi i tematikës, periodizimi, klasifikimi, shtjellimi i saj sa më konçiz, ilustrimi dhe argumentimi me referenca, fakte, të dhëna arkeologjike, mënyra e intepertimit dhe deduktimit e bëjnë këtë libër një dekoment shumë të rëndësishëm me njohuri të plota, të gjëra, të sakta dhe shkencore për cilindo lexues vendas dhe të huaj.

Libri është tipik në llojin e tij polivlerash që i shërben jo vetëm Dibrës e dibranëve, por gjithë Shqipërisë e shqiptarëve. Duke u marrë me historinë e Dibrës profesori ynë i nderuar hedh dritë mbi shumë ngjarje, ndodhi, beteja, veprimtari dhe personazhe të cilat në momente të veçanta kanë determinuar edhe historinë e vendit dhe të kombit tonë.

Interes të veçantë dhe plot risi paraqesin për lexuesin pjesët me titujt "Dibra në Antikitet. Penestia dhe penestët", "Gropajt dhe Kastriotët (shek. XIV-XV), "Gjon Kastrioti ose Gjon Dibrani", "Dibranët gjatë epopesë skënderbegiane", "Treva dibrane gjatë pushtetit të Skënderbeut" etj. Në këta kapituj Prof. Dr. Kristo Frashëri fokusohet në humbjen e rolit të bashkësive fisnore dhe forcimin e rolit të bashkësive krahinore. Hedh dritë mbi gjendjen, popullatën, humbjen e rëndësisë



të udhëheqësve farefisnorë dhe daljen në skenë të sundimtarëve të rinj siç ishte Andrea Gropa në Dibrën e Epërme me qendër Ohrin dhe Pal Kastrioti në Dibrën e Poshtme. Ai sqaron dhe argumenton se familja Kastrioti u bë sundimtare jo vetëm në Dibrën e Poshtme, por në Dibër, Mat, Breg Mat, Mesie e deri në afërsi të Durrsit. U jep fund hamendësive për vendlindjen e Skënderbeut, ndriçon veprimtarinë e tij dhe rolin e dibranëve gjatë epopesë skënderbegiane dhe pushtetit të Skënderbeut.

Në tërë librin, por vecanërisht në pjesët me tituj: "Rezistenca kundër masave paratanzimatiste", " Rezistenca dibrane ndaj Tanzimatit, lufta e Gjoricës 1884", "Treva dibrane gjatë viteve të Lidhjes së Prizrenit", "Kongresi Kombëtar i Lidhjes Shqiptare në Dibër", "Besëlidhja e Dibrës", Rezistenca patriotike në Dibër në fillimet e shek. XX", "Dibra gjatë viteve 1912-1918", "Treva dibrane në lëvizjen demokratike të viteve 1920-1924, 1925-1928 si dhe gjatë viteve të monarkisë zogiste 1928-1939 pasqyrohet në detaje të holla roli i Dibrës dhe dibranëve jo vetëm për trevën, por edhe për fatet e vendit e të kombit tonë. Këtu Dibra dhe dibranët kanë dominuar historinë dhe roli e kontributi i tyre ka qenë vendimtar.

Në këtë libër jepen me hollsi bashkëveprimi, mbështetja dhe besnikëria e krerëve të Dibrës dhe dibranëve me krerët e viseve shqiptare të Shqipërisë së Veriut sidomos me Hasan Prishtinën, Haxhi Zekën, Isa Boletinin, Bajram Currin, por edhe me Abdyl Frashërin, Ismail Bej Vlorën, Sulejman Delvinën, Iliaz Vrionin etj.

Përfundimet e Prof. Dr. Kristo Frashërit për strukturën e shoqërisë së trevës dibrane, rrymave që kanë sunduar në të, mënyra e funksionimit dhe qeverisjes së kësaj treve, për të drejtëtn zakonore, skenat dhe prapaskenat e parisë së Dibrës, roli i dibranëve në shpalljen e pavarësisë, në revolucionin e qershorit, në lëvizjen revolucionare dhe demokratike në përgjithësi, në luftën për hapjen shkollës dhe mësimit të gjuhës shqipe, për rolin e organizatës "Bashkimi" etj. përbëjnë një pasuri shkencore që do t'ju ndrisi në jetë të jetës breznive dhe gjeneratave të reja të Shqipërisë.

Nga libri i Prof. Dr. Kristo Frashërit "Historia e Dibrës" përvetësojmë një linjë konstante të dibranve, qëndresën e fortë, papërkulshmërinë, luftën e paepur për mbrojtjen e trojeve kombëtare, për arsimim e civilizim, për demokraci e progres. Kjo konstante atdhetarie e mençurie përshfaqet gjatë gjithë rrjedhës historike. Ajo herë zbehet, herë arrin pika kulminante dhe asnjëherë nuk është shuar. Dibra ka qenë vazhdimisht e pranishmë në gjarjet kulmore të historisë së vendit dhe kombit tonë. Ajo ka qenë historikisht prezente me përfaqësuesit dhe forcat e veta me qëndresë, organizime, beteja dhe instuticionet më të larta të vendit tonë. Në libër ka një galeri personazhesh me kontribut të çmuar që nga lashtësia, në shpalljen e pavarësisë, kundërshtimin e qëndrimeve të Fuqive të Mëdha, jetës së parlamentarizmit shqiptar etj. Ku spikasin Iljaz pashë Dibra, Fuat Dibra, Ramiz Dibra, Haxhi Vehbi Agolli, imzot Nikoll Kaçorri, Elez Isufi, Isuf Xhelili, Selim Rusi, Hamdi Ohri, Shaqir Daci, Shaqir Qoku, Kadri Fishta, Ismail Strazimiri, Haki Stërmilli, Jashar Erebara, Ramiz Varvanica, Urfi Agolli, sheh Sulejman Zerqani, sheh Fejzë Bulqiza etj.

Libri përmbyllet me shtojcën "Dekumente dhe dëshmi historike mbi trevën Dibrane nga shekujt e kaluar". Kryesisht janë regjistrime, shënime udhëtimi dhe relacione spjeguese mbi trevën e Dibrës. Është një material shumë i pasur nga ku lexuesi armatoset me të dhëna dhe dije shkencore. Në veçanti në raportin e një zyrtari të huaj mbi mizoritë e kryera në Dibër lexuesi rënqethet dhe shokohet, nga ana tjetër krenohet për qëndresën brilante dhe kontributin e spikatur të dibranëve në luftën për liri e pavarësi si dhe ndërgjegjësohet e frymëzohet më së miri për shërbim e kontribut në dobi të progresit të vendit dhe përparimit të shoqërisë shqiptare. Janë këta dhe të tjera arsye, të cilat nuk kemi mundur t'i trajtojmë në këtë shkrim që e bëjnë librin "Historia e Dibrës" të Prof. Dr. Kristo Frashërit një dokument shumëvlerash që i shtohet fondit të artë të historisë së Shqipërisë dhe ze vendin e nderit në bibliotekat tona.

DJ për gëzimet tuaja familjare
me repertor të zgjedhur
me këngë dibrane

Jepi dasmës tënde aromë Dibre....
Tel. **066 60 12 616**

histori

Nderim për ata që i dolën zot Atdheut më 7 prill 1939 edhe pse të harruar sot

Nga **Prof.dr.AHMET KAMBERI**

Kur vihet në pyetje pavarësia dhe integriteti i atdheut vihet në provë edhe dashuria e dalëzotësia për të. Ka burra që i venë gjoksin, ka dhe të tjerë që i kthejnë shpinën. Por kur shpinën ia kthejnë komanduesit kjo është për të vajtuar dhe çdo përpjekje për përligjjen e veprimit të tyre u vlen vetëm atyre vetë. Vendet e zhvilluara, që kanë kaluar mjaft përvoja të tilla, të parëve u thotë "heronj" dhe të dytëve "tradhtarë". Këto dy fjalë të thjeshta në vendet e konsoliduara kanë të njëjtin kuptim për të gjithë. Në Shqipëri kuptimi i tyre ndryshon disi. Heronjtë e quajnë veprimin e tyre thjesht detyrim ndaj atdheut. Tradhtarët e quajnë veprimin e tyre "heroizëm", kështu edhe ithtarët e tyre. Ne, si popull, për fat të keq, nuk kemi përcaktuar ende kritere të qarta për përkufizimin e këtyre dy nocioneve, gjë që është pasqyruar edhe në historinë tonë më të re. Por po bëjmë fjalë për një ngjarje pak më të hershme.

Kur u mor vesh se Italia fashiste po sulmonte Shqipërinë, rreth 600 burra, vullnetarë, nga Gryka e Madhe dhe Bulqiza, midis të cilëve 15 burra nga Peladhia, të prirë nga Sheh Hajredini i Zerqanit u nisën për në Burrel për t'u furnizuar me armatim e për të shkuar në Durrës për të mbrojtur Atdheun nga pushtimi i Italisë fashiste (Riza Novaku. Kujtime, dorëshkrim, Zerqan, 6.8.1983, dhuruar Sami Kamberit më 24.03.1992). Mbreti, i cili në orën 18.00 të datës 6 prill kishte bërë thirrje dhe kishte shprehur besimin se populli i Shqipërisë do ta mbronte me vetëmohim Atdheun nga agresioni që po i kanosej, do t'i zgjidhte ndryshe punët për veten e tij.

Gjashtëqind vullnetarët e Grykës së Madhe e të Bulqizës, midis të cilëve 15 burrat e Peladhisë: Sulejman Sadik Kamberi, Mehmet Muharrem Deda, Xhemal Sali Kala, Nasip Xhaferr Pasha, Miftar Sadik Plaku, Isuf Miftar Hysa, Tush Jashar Hysa, Halil Bajram Rama, Veli Bajram Rama, Ramiz Hasan Pata, Zenel Huçja, Riza Hysen Kala, Shahin Sadik Kala, Muharrem Ali Gjura, Bajram Xhaferr Alla (emrat të renditur ashtu siç janë në fletoren e shënimeve historike të ish-Kryetarit të Këshillit Popullor të Peladhisë, të ndjerit Sadik Plaku), kur arritën në Burrel nuk gjetën askënd që t'i furnizonte ata me armatim. Por ata nuk u kthyen mbrapsht. Kush me një pushkë e një a 2 paketa fishekë, e kush pa asnjë armë, morën rrugën e Tiranës në drejtimin Burrel - Klos - Guri i Bardhë - Murriz. Por kur arritën te Hani i Murrizit ata ndeshën në gra e pleq që vinin nga Tirana e Durrësi për t'u kthyer në fshatrat e tyre në krahinën e Dibrës. Këta i vunë në dijeni vullnetarët se Italia e kishte marrë tashmë Durrësin dhe në çastet që po bisedohej, ndoshta kishte hyrë në Tiranë dhe se Mbreti kishte parë punën e vet. Të gjorët vullnetarë, të dëshpëruar e të zhgënjyer nga shteti e mbreti i tyre, por dhe të mbushur me urrejtje për pushtuesin e ri të vendit, u kthyen nga kishin ardhur, por jo për të ulur kokën. Por, njeri nga grykamëdhejst, Isak Metalia, nga Strikçani, do të binte heroikisht atje në Durrës përkrah Mujo Ulqinakut. Me këtë akt, ai sikur i thoshte grykamëdhenjsve e bulzakëve, "Mos u dëshpëroni, shokë e miq, po e laj unë me gjakun tim atë që ju penguan ju të tjerëve ta bënit". Kështu, Italia fashiste shkeli në Durrës, por që atë ditë ajo kishte hyrë në gjak me Grykën e Madhe, Buqizën, Dibrën e mbarë Shqipërinë. Shumë nga ata grykamedhenjs e bulzakë që marshuan deri te Hani i Murrizit, ose bijtë e tyre, shpejt do të rreshtoheshin më pas në formacionet partizane e të Ushtrisë Nacional Çlirimtare, e cila, së bashku me Aleatët e Mëdhenj e bënë Italinë fashiste të gjunjëzohej.

Sot kemi ardhur në një ditë kur nuk duam ta zëmë me gojë 7 prillin, ditën e pushtimit nga Italia fashiste, ashtu si edhe plot ngjarje të tjera të shënuara, të vulosura me gjak dëshmorësh të atdheut. Arsyet mund të jenë të shumta. Tani Italia është një vend mik i Shqipërisë dhe marrëdhëniet me të janë të ngrohta. Disa qindra mijë shqiptarë punojnë e jetojnë sot atje. Ithtarët e Mbretit duan të harrohet ajo ditë e turpshme për të. Të njëjtën gjë e duan edhe ata që marrin frymëzim nga historia e mbretërisë dhe e mbretërimit.

Italia e sotme nuk është Italia fashiste e djeshme - një vend agresiv. Italia sot është Italia demokratike, një vend mik. Populli shqiptar nuk ka arsye të ndjehet i turpëruar, se ai e priti me armë pushtuesin dhe të dhënat tregojnë se do ta kishte pritur vërtetë me një luftë shembullore, po të mos ishte tradhtuar nga Mbreti i tij. Këtë ai e dëshmoi 3 vjet më pas, jo vetëm me Luftën heroike Nacionalçlirimtare, por edhe me fisnikërinë e tij shembullore, kur ushtarët italianë, pas kapitullimit të Italisë fashiste, ndiqeshin si egërsira gjahu nga pushtuesit gjermanë, që zunë vendin e tyre. Por ishte pikërisht ky popull që e kishte pësuar prej tyre, që ishte vrarë, masakruar, djegur e përvëluar dhe që i kishte luftuar ata, i cili i mori nën mbrojtje si të kishin qenë miqtë e tij më të mirë. Një nga shembujt e panumërt të kësaj që po them është edhe shkruesi i këtyre radhëve që e ka përjetuar vetë një situatë të tillë.

Në lagjen time në Peladhi u strehuan 13 ushtarë italianë. Njeri prej tyre, Ivo e quanin, ishte strehuar në shtëpinë tonë. Ai hante e pinte në të njëjtën sofër me ne. Një tjetër, që ne e thërrisnim Pal (emri i tij mund të ishte Paolo) strehohej te Pashet. Ai duket se ishte shok me Ivon se shpesh rrinin bashkë. Njëmbëdhjetë ushtarë të tjerë italianë strehoheshin te Met Deda, nja 30 metra mbi shtëpinë tone. Ai u kishte liruar atyre odën e miqve dhe kasollen e barit. Më kujtohen dy ndodhi nga ajo kohë. Një here kur babai im kishte vrarë një lepur, i cili mua më dukej shumë i madh se mezi e mbaja, të cilin ai më tha t'ua jepja italianëve që banonin te Përdedet (familja e Met Dedës). E kujtoj edhe sot skenën e haresë e vallëzimit të tyre kur e panë që unë po shkoja t'u çoja atë kafshëz aq të "çmuar" për ta. Më dolën përpara, ma morën lepurin, më ngritën hopa, më thoshin fjalë që s'i merrja vesh, hidheshin e përdridheshin sa më morën mendtë dhe mbeta si i hutuar për një cope herë. Ndodhia tjetër ishte kur kali i Pasheve kishte thyer këmbën dhe u lejuan italianët ta thernin. Prej këtij mishi morën, natyrisht, edhe Ivoja me Palin. Ivoja e gatoi atë vetë dhe e shijova edhe unë atë lloj mishi.

Italianët qëndruan në shtëpitë tona deri pas Çlirimit të Shqipërisë, kur u mblodhën për t'u kthyer në vendin e tyre.

Nga ana tjetër, Shqipëria sot nuk është Shqipëria e viti 1939, një vend i prapambetur mesjetar, ku njerëzit, ndonëse besonin fort te i pari i tyre, luftonin për vendin e vet edhe atëherë kur tradhtoheshin prej tij. Shqipëria sot është një vend që përpiqet të ndërtojë një demokraci të qëndrueshme, gjysma e qytetarëve të saj kanë emigruar në vendet fqinje dhe gjysma tjetër këtu brenda grindet për të errësuar ose ndriçuar periudha ose momente të caktuara historike me synim triumfin e pikëpamjeve të tyre. Këto pikëpamje janë, jo në pak raste, aq të kundërta sa në kohën kur disa luftonin e derdhnin gjakun për atdheun e tyre dhe të tjerët bashkëpunonin me pushtuesin për ruajtjen e privilegjeve dhe shtimin e pasurisë së vet në dëm të vendit. Kjo mund të jetë edhe një nga arsyet kryesore përse ne u dashka të mos i përkujtojmë disa data dhe periudha historike, të cilat e nderojnë çdo shqiptar, pavarësisht nga çfarë mund të kenë bërë a ç'rol mund të kenë pasur dikur paraardhësit e vet. Sepse, si nderi ashtu dhe turpi, kur vjen puna për t'u ballafaquar me të tjerët, u përket të gjithë pjesëtarëve të një familjeje. Dhe Shqipëria është familja jonë e përbashkët. Kush përpiqet të bëhet Zot Shtëpie, duhet t'i thërrasë mendjes për këtë. "Kjoftë mallkue kush qet ngatrrime ndër këto vllazën shoq me shoq; kush e dan me flak'e shkrime ça natyra vetë përpoq", do të ligjëronte dikur liriku i madh Ndre Mjeda. Ky mallkim është i përjetshëm. Të mos e harrojmë!

Unë përulem sot me nderim para atyre 15 burrave të Peladhisë, 600 burrave të Grykës së Madhe e Bulqizës dhe mijëra të tjerëve anë e kënd Shqipërisë që më 7 Prill, me thirrjen e vetëdijes së tyre, u sulën drejt Durrësit për të mbrojtur Atdheun nga pushtimi prej Italisë fashiste, edhe pse shteti i Mbretit të tyre i preu në besë, u refuzoi udhëheqjen dhe çdo armatosje. Kush të dojë mund të bëjë kështu si unë.

Unë përulem sot me nderim para të gjithë atyre shqiptarëve të cilët edhe pse të dhunuar, të burgosur, të vrarë e të masakruar nga pushtuesit fashistë italianë, kur erdhi puna që armiqtë e tyre u bënë pre e pushtuesve të rinj, nazistëve gjermanë, të cilët iu zunë vendin, i morën ata nën mbrojtje, i strehuan në shtëpitë e tyre të varfra, ndanë me ta kafshatën e gojës së familjeve të tyre, u shpëtuan jetën. Dhe kur u bë e mundur i përcollën për andej nga kishin ardhur. Kush të dojë mund të bëjë kështu si unë.

JEPET ME QIRA

mjedis **300 m2,** pranë Kombinatit të Autotraktorëve.
E përshtatshme për çdo lloj aktiviteti.
Lartësia e katit 5 m. Mjedis edhe për zyra!
Linjë trefazore elektrike në dispozicion!
Rruga e shtruar me asfalt!
Të interesuarit të komunikojnë me tel:
069 20 68 603



DibraToursTravel

Vladimir MARKU

Tel: +355 **68 34 08 495**
Tel: +355 **68 65 06 061**

E-mail:
vladimirmarku.guide@gmail.com
Postal Address:
Arras, Peshkopia,
Dibër County, Albania

Cikël poetik nga Agron Sela

DIBRËS

Të sëmura enden,
Ende retë,
Valëve të Drinit të Zi;
Gjëmojnë mbi shtatin tënd,
Cingërimat e zagarëve të rinj.

ELEGJI PËR SHKUPIN

Rrjedha e Vardarit qan
O kështjellë e lashtë,
Se s'dëgjohet zëri yt.
Mbete, varosh i kalasë.

VOTRA

Me rrënjë mbaj ndezë zjarrin
Se pyjet me dru
Shiten copa-copa
Për skelete samarësh.

SKËNDERBEU

Më vjen me qeshë,
Kur njerëzit e letrave
Ngarendin
Të plehërojnë historinë
Me nji laps të madh.

MOISI GOLEMIT

Pa asnji pikë shi,
Sillen retë
Valëve të Drinit të Zi;
Mbi hijen tënde gjëmojnë,
Gjeneral Moisi.

PRANVERA E SËMURË

Lule të bukura, të qethura keq
Renditen të dalin në fotografi.
Moti i dehur vetëm leh
E mban natyrën bardh e zi.

Zogjtë këndojnë ditë për ditë
Nga era e stinës që fryn nga
Pranvera përton t'i çel sytë
Edhe pse dielli moti ka ra.

PEIZAZH I MBRAPSHT

Nga shkretëtira fryn era
E pluhurosur, lëkund;
Lulet e bukura dalëngadalë
Vyshken nëpër katund.

MODERNE

Cenzura e re,
As të vret e as të shtyp.
Të len të shqiresh përmbi re;
Me mashë elektronike
Ta shtrydh fjalën.

NË VENDIN E VOTIMIT

Kur hynë brenda,
I presin me buzëqeshje të ëmbla.
Dalin përjashta
Si limonë të shtrydhur
Nëpër sytë e fytyrave të tharta.



Të nesërmen,
Votuesit,
Si figurat e shahut
Mbas mbarimit të lojës,
Enden.

NË MORTORE

Mes ngjyrave të bukura të luleve
Dhe errësirës së teshave tona,
Nji vajz' e re në arkivol e shtrirë;
Pret lamtumirën e fundit.
Në sallën me ajr të kondicionuar,
Lotët dhe fjalët e mortorëve
Maten në luhatjet e peshores së dhimbjes.
Me të skuqjen shpirtërore,
Nji grua,
E shtrëngon trupin e saj
Duke i ulur perdet.

GJYSHET FODULLE

Mbrëmje festive,
Në ritmet e muzikës
Të rinjtë e të rejat vallëzojnë.
Veshjet e vajzave,
Si pranvera mbas dimrit,
Vallen e zbukurojnë.
Gjyshet ndër dhëmbë mallkojnë
Rrobaqepësit e kohës së tyre,
Se s'mundën rininë tua lulëzojnë.

ELEGJI PËR POETËT

U desh mendjeshkurtrit
Të pjellin enigmën e vargjeve tuaja,
Që kulshedra të pinte edhe pak gjak
Në tokën e përgjakur
Për të mbytur fjalën.

SEDËR

Unë nuk kam fjalë të kota
Që t'i kënaq veshët e rrugëve.
Moti, dielli i përrallave
Më ka perënduar.

SI PRANVERA

Shpesh, andrrave të mija
Ti vjen si pranvera;
Her' e brishtë si vjollcat e para,
Herë si rrëke që më rrëmben përpara,
Nëpër gjelbërimin e dashurisë.

PA TITULL

Vargjet për ti
Mu desh t'i shpërndaja
Në katër poezi
Si organet e nji vajze të vdekur
Në aksident automobilistik.

NË MES TË HIJEVE

Në dritën e hënës e pashë
Fytyrën tënde të akullt,
Që qasej mes hijeve të errësirës
Si dashnoret e luftës së ftohtë,
Për të ngrirë sinqeritetin.

HUTIM

Dje,
Me hovin tënd
Të vrullshëm,
Erdhe.

Vet',
Si shishe me shampanjë,
U derdhe
Për të më dehun.

Ike,
Si e arratisur
Në monizëm;
Vuajtjet e ferrit,
I ndjej unë.

NË PLATFORMËN E METROSË

Treni po kotet në stacionin e afërt.
Jam në ngut,
Dhe pres me ankth arritjen e tij,
Se ora minutat i nduk.

Në platformë, mëngjesi
mbështjellë në heshtje.
Nji bukuroshe - balerinë,
Me tik-taket e holla të këpucëve
I giligic qetësinë.

KONCERT JETE

Në mesin e valles,
Sytë tanë kuvendojnë.
Trupi yt i bukur vallëzon
Nën të rrahunat e zemrës
Për të më pushtuar.

CAK FLUTURIMI

Edhe pse era e pranverës
Të shtyn të fluturosh
Përtej hapësirës së mendimeve.
Në udhëkryq të dashurisë
Kur të plagosesh;
Do të jem aty,
Me fashat e zemrës
Do t'i lidh plagët.

histori njerëzore

Lotët e fëminisë i mblodhi deti...

Fragment nga libri "Adem Reka" shkruar nga Bardhyl Agasi

Për aktin heroik të Adem Rekës për të mbrojtur Bisën lundruese me dallgët e egërsuara, ato akte meteori 1966 në Durrës janë xhiruar filma e dokumentarë, janë shkruar libra, poezi e këngë.

Adem Elezaj (Reka) me origjinë nga fshati Zhirovnicë afër Rekës në Dibër që në fëmijërinë e tij u lidh me detin dhe me Durrësin, në kulturën dhe traditat durrsakë, por në familjen e tij u ruajtën dhe traditat më të mira dibrane.

Familja Reka, si shumë familje të tjera të ardhura në Durrës pas viteve 1930 ishte dhe mbetet një familje e respektuar edhe në ditët tona.

17 nëntori 1966, dita e ndarjes nga jeta e Adem Elezaj (Reka) ishte dhe dita e ndarjes nga gjiri i familjes së tij të dashur sidomos të katër fëmijëve të tij ende të pa rritur: Tatjana 13 vjeçe, Shpresa 8 vjeç, Skënderin 7 vjeç dhe Shpëtimi vetëm 2 vjeçar. Këto e shumë të tjera do mësoni në leximin e librit "Adem Reka" botuar më 1978, shkruar nga Bardhyl Agasi, autori i disa librave në poezi e prozë, një familje e hershme durrsake dhe vetë Bardhyl Agasi një durrsak që në xhiron e mbrëmjes në shëtitoren e Durrësit nuk shkon në shtëpi pa i thënë "natën e mirë" detit... / I.Dervishi



Familja e Elezajve gjithmonë ishte shquar për ndjenja të thella patriotike dhe për këtë ishte bërë e njohur jo vetëm në fshatin Zhirovnicë, ku ajo jetonte, por dhe në krejt krahinën e Rekës. Më vonë ajo mori mbiemrin e vetë krahinës dhe kështu shpjegohet që shumë familje të ardhura nga Kosova në Shqipëri morën mbiemrat e e krahinave të tyre. familja e Elezajve e ardhur nga Reka sapo erdhi në Shqipëri mori këtë mbiemër, ose më mirë ia dhanë këtë mbiemër ngaqë filluan t'i thërrisnin si familje e ardhur nga Reka, familja e rekës. I pari i kësaj familje të madhe ishte Abedin Elezaj, i njohur në krejt krahinën si njeri patriot jo vetëm me fjalë, por edhe në veprime. Ai kishte qenë aktivizuar në kryengritjet e popullit të Kosovës kundër turqve, në prag të pavarësisë. Abedin Elezaj e priti me zemërim të madh vendimin e fuqive të mëdha që një pjesë e tokave shqiptare të mbeteshin jashtë kufijve të saj, ku përfshihej edhe Kosova. Abedin Elezaj kishte një dyqan restorant të vogël, ku mblidheshin shumë shqiptarë, jo aq për të blerë e për të pirë, se sa për të zhvilluar biseda "të ndryshme", që kryesisht kishin karakter politik. Dhe ja, një ditë në dyqanin e vogël kishina ardhur përfaqësues të autoriteteve serbë, që mbanin në duar urdhrin e mbylljes së dyqanit.

Abedin Elezaj kishte katër djem, Qamilin, Shefqetin, Kadriun dhe Hamitin. Kështu familja e tij ushtronte një influencë të madhe te të tjerat, ndaj ajo, ndër të parat në të gjithë shqiptarët e atjeshëm ushtrohej jo vetëm një mbikëqyrje e kontroll i rreptë, pro edhe terrorizëm. Shumë shqiptarë dergjeshin dhe vdisnin nga torturat nëpër burgje, ngaqë guxonin të ngrinin zërin kundër padrejtësive që bëheshin ndaj tyre. me qindra e mijëra të tjerë ishin të detyruar të braktisnin trojet e tyre e të merrnin rrugën nga të mundnin, të ndjekur e të persekutuar.

Familja e Rekajve u vendos në qytetin e Durrësit, një nga qendrat më të rëndësishme të vendit. Me të hollat e mbledhura nga shitja e shtëpisë në Zhirovnicë dhe nga fitimet e vogla në dyqan, ata mundën të blenin një banesë dykatëshe, si dhe të siguronin një restorant të vogël në rrugën në të hyrë të qytetit, afër mullirit, ku ndodhet sot centrali elektrik.

Ndërsa Qamili me familjen e tij u nis në Turqi, mbasi një kushëri i gruas e kisthe ftuar si ortak në një ëmbëltore. Kështu Qamil Reka (Elezaj) u vendos në Izmir bashkë me gruan e tij, Shadijen dhe tre fëmijët, më e madhja Fitneti 5 vjeçe, Ademi 3 vjeç dhe Vaideja 6 muajshe. Megjithëse në fillim u duk sikur punët u shkonin mbarë, Shadija nuk po ambientohej dot me atë jetë të mbyllur në dhe të huaj. Ç'na u desh, - i thoshte të shoqit ditët e para – lamë Zhirovnicën tonë dhe erdhëm në këtë rrëmujë. Qamili për t'i hequr mërzitjen i tregonte ato pak të holla që fitonte. Por Shadija ndiente një farë trishtimi dhe i kalonte ditët e mërzitur vetëm duke gatuar dhe duke u marrë me të vegjlit. Atëherë Qamili filloi t'i sillte në shtëpi njerëz për vizitë, kryesisht shqiptarë. Në Izmir kishte shumë shqiptarë aq sa në çdo rrugë të tij do të dëgjoje patjetër ndonjë bisedë shqip. Kjo sikur po jepte efekt dhe Qamili gëzohej kur shihte Shadijen të bisedonte buzagaz me mysafirët.

Mbasi të fitojmë ca, shkojmë dhe ne në Shqipëri, në Durrës. Atje i kemi të gjithë njerëzit tanë – i tha ajo të shoqit një natë. Ai s'iu përgjigj, veçse ndjeu brenda gjoksit përcëllimin e një zjarri të madh. Ishte malli për tokën mëmë, për njerëzit e tij të dashur. Sa gëzim do të kishte ajo ditë e kthimit...

Një ditë në shtëpi trokiti dera fort. Shadija e trembur nga kjo trokitje e hapi derën me nxitim. Kishte ardhur një prej çunave shegertë, nga dyqani. Shadija duhej të shkonte menjëherë, mbasi Qamili ishte i sëmurë. E shkreta grua, harroi të hiqte dhe përparësen e punëve e u sul pas lajmësit. Kur shkoi në dyqan nuk gjeti njerëz të tjera brenda; diku pas banakut qëndronte i shtrirë Qamili dhe pranë tij qëndronte ortaku, kushëriri i saj, i cili i mbante kokën në mes të pëllëmbëve të trasha të duarve të tij.

- Qyqja unë – thërriti ajo e trembur kur pa të shoqin në atë gjendje. Mezi e çuan në shtëpi... Qamil Reka (Elezaj) në moshë rreth të tridhjetave u nda përgjithnjë nga gruaja e tij e dashur dhe tre fëmijët njomëzakë. Para se të vdiste i la këtë porosi të shoqes: "Kujdes fëmijët. Bëji njerëz të ndershëm dhe trima për jetën!". Shadije Reka u tregua një grua e fortë, me tiparet më të mira të një bashkëshorteje e të një nëne fëmijësh. Me ato pak të holla të mbledhura nga i shoqi, ajo mundi të organizonte ceremoninë e varrimit e të priste njerëzit për ngushëllim. Pas disa ditësh nga vdekja e të shoqit ajo u nis bashkë me tre fëmijët për në Stamboll, ku vendosi të jetonte përgjithmonë, pasi atje ishte një xhaxhai i saj i moshuar bashkë me të shoqen. Ajo nuk kishte varur asnjë farë shprese për të ardhmen e fëmijëve te ky xhaxha, pasi e njihte mirë kopracinë e tij, por shkoi afër tij për ta pasur si mbështetje e për të mos u lënë shteg thashethemeve rreth qëndrimit të saj. Xhaxhai në sajë të "detyrimit" që ndiente vinte shpesh në shtëpinë e Shadijes. Ai merrej me tregti dhe vende të të tjera të Ballkanit. Kishte qenë dhe në Shqipëri. Pra mund t'i dilte rasti të shkonte përsëri atje. Shadija i kërkoi që me t'i dalë rasti për hir të saj e të tre jetimëve të shkonte në Durrës e të merrte kontakt me gjyshin dhe xhaxhallarët e fëmijëve të saj. Ai i premtoi se do ta bënte një gjë të tillë, sapo t'i paraqitej mundësia. Një mbrëmje ai erdhi në shtëpinë e Shadijes bashkë me të shoqen. Ishte hera e parë që ai i sillte të vegjëlve ëmbëlsira. Ndërsa po bëhej një bisedë e zakonshme, ai "rastësisht" mori në prehër Ademin e vogël dhe pasi e puthi dy-tri herë në faqe iu drejtu Shadijes me kërkesën që të merrte një fëmijë, gjoja për ta lehtësuar nga barra e rëndë ekonomike. Ai pranonte të merrte cilindo prej të tre fëmijëve, por më mirë do të preferonte Ademin, pasi vajzat mund t'i duheshin më shumë nënës. Shadija ndjeu një turbullirë në kokë. Ai kërkonte t'i merrte Ademin e saj të dashur, djalin e vetëm që kishte, shpirtin e saj! Ajo nuk i ktheu asnjë përgjigje dhe bëri sikur nuk i kishte dëgjuar fjalët e thëna më parë, por xhaxhai kur pa se ajo heshti, e përsëriti kërkesën e tij. Ata nuk kishin asnjë fëmijë, po plakeshin dhe vdekja s'do të vononte t'i merrte. Pastaj emri i tij do të shuhej, do të harrohej e s'do të mbetej. A s'do të ishte fat që ky trashëgimtar të bëhej Ademi i vogël dhe pas vdekjes së tyre ai të bashkohej përsëri me nënën. Shadija tek e shihte këtë burrë të moshuar të fliste ashtu, i pushtuar nga një pasion i çuditshëm, ndjeu keqardhje, ndaj dhe vendosi që t'i kundërshtonte me një ton të butë. Xhaxhai pasi e kuptoi që çdo përpjekje e tij ishte e kotë, pasi Shadija kishte vendosur të mos lëshonte asnjë fëmijë prej duarve të saj, i tha se pas dy ditësh ai do të nisej për në Shqipëri dhe do të mundohej të gjente Abedin Elezajn, gjyshin e fëmijëve. Shadija u gëzua jashtë mase nga ky lajm i thënë papritur.



Abedini, sapo ishte takuar me xhaxhanë e ardhur nga Stambolli, kishte thërritur si një fëmijë nga gëzimi. Të falat që i çonte Shadija, nusja e të birit të vdekur, ia mbushën me gaz zemrën. Ai u interesua hollësisht mbi gjendjen e familjes së Qamilit të tij të shtrenjtë. Dëshirën e Shadijes për të ardhur në Shqipëri, ai e priti me gëzim dhe shfaqi gatishmërinë ta shpejtonte këtë. Xhaxhai nga Stambolli i tha se do të vinte përsëri pas tri ditësh për të marrë të hollat, për kthimin e Shadijes. Por ja që për plakun lindën shqetësime. Ku do të jetonte Shadija me të tre fëmijët? Në shtëpi dhe ata që banonin ishin shumë ngushtë, le pastaj të shtoheshin dhe katër të tjerë. Por shqetësimi më i madh ishte ai i zbatimit të zakonit të trashëguar brez pas brezi. Sipas këtij zakoni, kur një gruaje i vdiste burri ajo duhej të martohej medoemos me një prej vëllezërve të tij e pikëristh me atë, që do të ishte i pamartuar, por ai ishte dhe më i ri në moshë nga vetë nusja, nënë e tre fëmijëve. Si do të vendoset? Në rast se ai dilte kundër zakonit të të parëve ç'do të thoshin bashkëfshatarët e tij? Plakun nuk e zinte gjumi i natës. Ditën e tretë, kur erdhi xhaxhai i Shadijes, ai kishte vendosur çdo gjë. Abedin Elezaj i tha të ardhurit se kishte vendosur të merrte në Shqipëri vetëm dy fëmijët e parë të të birit, vajzën pesë vjde dhe djalin tre vjeç. Kurse nusja le të rrinte në Stamboll bashkë me vajzën gjashtë muajsh e me ndihmën e xhaxhait të martohej përsëri. Plaku i pagoi një shumë të hollash xhaxhait të nuses për rrëmbmin e dy fëmijëve, për shpenzimet e udhëtimit të tyre si dhe për të ndihmuar gruan e ve. Xhaxhai i Shadijes pranoi me kënaqësi dhe i premtoi se fëmijët do t'i sillte sa më shpejt që të ishte e mundur. Gjatë kësaj kohe Shadija me ankth priste kthimin e xhaxhait, lajmet që do t'i jepte ai. Gëzimi i saj qe i papërmbajtur kur ai i tha që vjehrri i priste krahëhapur dhe se ishte interesuar shumë mbi gjendjen e familjes së të birit. Ndërsa e shkreta grua numëronte ditët, për t'u nisur në Shqipëri, një mbrëmje në shtëpinë e saj vjen xhaxhai dhe i kërkon t'i lërë Fitnetin dhe Ademin për disa ditë. Kështu do t'i bënte shumë qejfin si atij, ashtu dhe Hajries së dëshiruar gjithë jetën për një fëmijë. Shadija, e gëzuar shumë për ngjarjet e mësuara si dhe nga kthesa shpirtërore e xhaxhait, ia dha dy fëmijët, të cilët kapeshin fort pas vepave të fustanit të saj duke qarë. E gjora nënë, i puthi, i mori me të mirë dhe i premtoi se do t'i merrte pas dy ditësh. E ku mund t'i shkonte mendja se ishte hera e fundit që i shikonte dy fëmijët e saj të dashur; se ata po i merrnin përgjithnjë për të mos i kthyer më kurrë.

Që të nesërmën në mëngjes, pa lindur mirë dielli, xhaxhai me dy fëmijët, ndodhej në liman. Kishte siguruar dhe biletat në agjencinë e vaporëve, pasi kishte biseduar më parë me kapitenin e një anijeje të vogël nga Ulqini. Gjithashtu i kishte dërguar dhe një telegram Abedinit në Durrës, ku i njoftonte se së shpejti do të ishte atje së bashku me fëmijët.

Gjyshi Abedin nuk kishte dalë në port mbasi nuk e dinte me saktësi kohën e mbërritjes. Fëmijët ecnin të kapur për dore nëpër rrugët e kalldrëmta të këtij qyteti krejt të ri e të panjohur për ta, që do të bëhej qyteti më i bukur dhe më i dashur i tyre. më së fundi ata kishin ndalur para një ndërtese të madhe. Portën ua hapi një djalë trupgjatë dhe i hollë, me flokë pak të rëna mbi ballë. Xhaxhai i tha të lajmëronte gjyshin se i kishin ardhur mysafirë. Pas pak duke u ngjitur nëpër shkallë fëmijët vështronin njëri-tjetrin me kureshtje, pa ditur se baballarët e tyre ishin vëllezër, se kishin të njëjtin gjysh e se që nga ajo ditë do të jetonin së bashku me vite të tëra.

Kështu u vendosën fëmijët Fitnete dhe Adem Reka në shtëpinë e gjyshit, duke u ndarë përgjithmonë nga nëna e tyre e dashur, të cilën sa e sa herë do ta kërkonin me lot në sy.

Shadije Reka kur mori vesh rrëmbimin e fëmijëve u bë si e çmendur. Ajo për disa muaj ndejti e sëmurë në shtrat, ku vinte e i ndihmonte e shoqja e xhaxhait, Hajria. E mbetur në mes të rrugëve, pa asnjë të ardhur, me një vajzë foshnjë, ajo u detyrua të martohej. Me dy fëmijët e saj në Shqipëri, pas shumë vitesh ajo do të lidhej vetëm me dy letra. Pastaj, për ndryshim adrese të Shadijes u ndërpre përgjithmonë korrespondenca. Në letrën e parë që shkruante ajo, shprehte lumturinë që dy fëmijët e saj të parë kishin krijuar familjet e tyre dhe jetonin me të gjitha të mirat në Shqipërinë e re, që "aq shumë e deshte babai i tyre i gjorë". Edhe në letrën e dytë ndihej gëzimi i nënës për fatin e lumtur të dy fëmijëve të saj më të rritur. Për jetën e saj ajo nuk jepte ndonjë të dhënë të hollësishme, veçse shkruante se "në përgjithësi jam mirë". Për fatin e saj të mëtejshëm Ademi dhe Fitneti nuk mësuan më, veçse një i njohur i Rekajve në Stamboll arriti të çonte një lajm të shkurtër për vdekjen e Shadije Rekës në një moshë jo aq të thyer.

Rruga e Arbërit nr. 84
kujtesë

Vdekja e tij si antikomunist bëri që për dekada të tëra t'a mbulonte pluhuri i haresës.

Pushkë e këngë në istikam

Nga **GAFUR ZOTO**

Vdekja e tij si antikomunist bëri që për dekada të tëra t'a mbulonte pluhuri i haresës. Ishte histori e gjallë jo vetëm në bëmat për Atdhe, por edhe në dëshmitë me të cilat i përcolli ngjarjet. U referua për shumë ngjarje e bëma, por Xhaferr Kaloshi i Sinës nuk u bë objekt dhe subjekt i auditoreve. Në vitin 1938, i ndjeri Munir Shehu do t'a kontaktonte, t'a pyeste,por jo për plagën e marrë në luftime me serbët. Do t'a pyeste për njerëz,ngjarje e bëma tjera. Historia duhet t'a korgjojë vehten e në këtë aspekt i vetëdijshëm për mungesën e gjatë, ndonse vonë, përpiqem që tua rikthej luftëtarëve të atyre ditëve tejet dramatike për fatet e vendit, bashkëluftëtarin, prijësin dhe heroin e tyre.

Atë që nuk e bëmë ne në vitet e diktaturës, shumë kohë më parë, e bënin njerëz të tjerë, të thjeshtë, pa shkollë,por me ndjenjë e vetëdije të lartë kombëtare. E bënin ata, që kishin luftuar me të në një llogore në luftën e Shkodrës kundër serbo-malazezëve. E bënin ata që kishin parë me sytë e tyre tek printe në ballin e luftës me pushkë e këngë. E bënin ata, që pas plagëve të marra në fushën e betejës kundër serbëve, do t'a mbartnin në krah prijësin e tyre duke e dërguar drejt fshatit të lindjes,Sinjë e Dibrës së Poshtme.

Kështu më 30 mars 1931 kryepleqtë: Selman Rexha (Fushë Alie), Man Losha (Kishavec), Halit Shini (Kastriot), Maliq Lleshi (Rreth Kale), Hasan Bajrami (Vakuf), Destan Tafa (Sohodoll), Vehap Shabani (Borovjan), Mehmet Aliu (Deshat), Abaz Rusi (Mustafe), Arif Torba (Shimçan), Nuredin Isufi (Bahute) dhe Gani Rushiti (Brezhdan) do u drejtoheshin autoriteteve të larta: "Neve, kryepleqsia e katundeve të poshtshënueme, dëshmojmë e vërtetojmë se z.Xhaferr Kaloshi asht familje e ndershme dhe besnike dhe prrej vitit 1913 deri në vitin e sivjetëm (1931 shën.im) ka punue për Atdhenë tonë tue ra nëpër luftna dhe sot gjindet prej në luftën Ballkanike i plagosun,pa mos pas kambën e majtë fare".

Por çfarë kërkonin ata? Kërkonin që shteti të ishte i ndjeshëm ndaj këtyre njerëzve patriot. Të ishte më pranë tyre. Kërkonin, siç edhe shkruanin "që organet kompetente t'i ofronin ndihmë për me përgatit nji kambë llastike (protezë shën.im)". Kjo jo si lëmoshë apo shpërblim. Njerëz të till kur nuk e kishin çuar në mëndje një gjë të tillë. Ata kishin luftuar vetëm me i dalë zot vatanit. Mëndja na vete më shumë se një dekadë më vonë. Më 7 qershor 1944 gazeta Bashkimi i Kombit nën art. "Një hoxhë martir" shkruante; "... Kur ishin paraqit rreth 10000 vet për shpërblime e rroga, nga Dibra rezultonte 3-4 vet... Malësorit i vjen mare me kërkue shpërblim e lavdrime, pasi ka kryer detyrën kundrejt vendit të tij". Më tej shkrimi vazhdon: "...edhe ka pas burra që kanë vlue në shpirt të tyne ndjenja e kulluet e nacionalizmit të vërtet shqipëtar,ka pas burra që kan shkri jet e pasuri për t'ju mbrujt idealit kombëtar të vetqeverimit". Vërtet Xhaferr Kaloshi nuk kërkonte shpërblime a pension,por një shoqëri e ka për detyrë të ofroi ndihmë për njerëz të till.

Siç duket apeli i bërë në adresë të autoriteteve të larta të vëndit, nuk ra në vesh të shurdhër. U dërgua në Itali ku iu vu një protezë. Xhaferri qëndroi atje për disa kohë. U kthye në vendlindje në prag të Luftës së Dytë Botrore.

Lutja flet shumë dhe është e vetmja dëshmi e kontributit të tijë në lëmin kombëtarë. Është e vetmja dëshmi pasi pas rënise së tij si antikomunist, askush s'u qas të siguronte sadopak të dhëna për këtë figurë. Ajo përveçse afirmon personalitetin e këtij luftëtari, me bëma të shquara për atdhe, ishte njëherësh dëshmi e respektit të njerëzve të thjesht për prijësin e tyre. Ajo ishte edhe një apel drejtuar ndërgjegjes kombëtare, pse njerëz të till meritojnë më shumë vëmendje.

Ata që luteshin sot për t'i vënë një protezë në këmbë këtij luftëtari ishin ish bashkëluftëtarë të tijë në qëndresën kundër serbo-malazezve në Shkodrër, nëntor 1912-prill1913. Këtu, përkrah shumë krerëve të tjerë, nën komandën e Jusuf bej Hysenagollit nga Dohoshishti, Xhaferr Kaloshi kishte shkruar faqe historie. Mehdi Kaloshi, të cilin pata rastin ta intervistojë në katundin Sinjë, më 1991, duke cituar Xhaferr Kaloshin tregon: " Në luftën e Shkodrës kundër serbo-malazezëve, Xhaferri ishte në një front me Llan e Sali Kaloshin, Selman Kadriun, Nel (Zenel) Shqutin, Dan Tafën e tjerë sinjarë... Xhaferri i binte shumë mirë fyellit. Kishte zë të bukur dhe këndonte këngë patriotike. Këndonte dhe luftonte në pozicione me dibran kundër serbo-malazezëve. Vetëm nga kënga e Tijë kuptohej se ku ishte fronti i Dibranëve". Më tej Mehdi Kaloshi vijon: "Xhaferri printe i pari me thirrjen: "A besa - besë burra bini mbarë, se ka dalë kaurri ashiqarë".Me thirrjen kush do me u ba shahit a gazi, luftëtarët që e ndiqnin pas, prej çefit me u ba shahit a gazi, për Atdhe, i kaluan pozicionet e armikut serbo-malazez duke luftuan trup me trup e vrarë shumë serb. Mehdi Kaloshi, duke cituar Xhaferrin,tregon: U llamë(ngopëm)duke vrarë serb". Dhe me të vërtetë siç do ta prananin autoritetet ushtarake serbo-malazeze humbjet në radhët e tyre ishin shumë të mëdha,7000 të vrarë e të plagosur duke ia kaluar edhe betejës së Kumanovës.

Në këto luftime një predhë e artilleries së armikut e goditi xhaferr Kaloshin në këmbën e majtë. Fillimisht iu ofrua ndihmë shëndetësore në spitalin e armatës turko-shqiptare, Shkodër e cila pas vrasjes së Hasn Riza Pashës komandohej nga Esat Pashë Toptani. Në kushtet e vështira të luftës,por edhe si pasojë e malarjes që bënte kërdinë, këmba e tij erdhi duke u përkeqësuar. Mehdi kaloshi tregon: "Llan Kaloshi, Sala, bashkë me sinjarët: Selman Kadriu,Nel (Zenel) Shquti, Dan Tafa e sinjarë të tjerë e sollën në shtëpi, në katundin Sinjë. Me gjithë kujdesin e treguar-vazhdon Mehdi Kaloshi, kamba i ra (humbi këmbën shën.im). Në shtator 1914 erdhi në Dibër Esat Pashë Toptani. Ai ishte njohur që në luftën e Shkodrës me bëmat e Xhaferr Kaloshit,ndaj dha porosi ta nisnin për kurim në Durrës. Zhvillimet e viteve 1914-1915 nuk e mundësuan një gjë të tillë.

Për heroizmin e dibranëve në këtë luftë është folur e shkruar shpesh. Dhe është bërë mirë. Por pa të drejtë Xhaferr Kaloshi është ndarë nga prijësit e luftëtarët e tjerë: Llan Kaloshi, Shaban Lusha, Selman Alia, Xheladin Seferi, Ali e Isuf Mena, Demë Përleka, Sulë Buci, Halil Doçi, Ismail Najka, nga më shumë se 1000 luftëtarë, ku sipas kujtimeve dhanë jetën në fushën e betejës 114 dibranë.

Xhaferr Kaloshi vinte nga një familje e shquar patriotike. i ndjeri Munir Shehu, i cili e kishte takuar Xhaferrin, në Sinjë, më 1938 shkruan se ai ishte 58 vjeç. Nga kalkulimet del se ishte i datëlindjes 1880. Kishte lindur pikërisht kur lakmitë e fqinjëve sllav ishin rritur ndaj Shqipërisë, ndaj dhe u gjend në ballë të luftrave kundër sllavëve.

> Edhe pse vonë, pas 100 vitesh, Xhaferr Kaloshi nuk ishte harruar, paksa me të sistemi diktatorial u soll më keq se serbi. Në luftë me serbët humbi këmbën, diktatura e ekzekutoi me vdekje. Gjithmonë ka vend që historia ta korrigjojë veten. Për këtë kurrë nuk është vonë.

Në odën e burrave mësoi edhe për bëmat e të atit, veçanërisht të gjyshit të tijë, Xhafer Kaloshi (i vjetri.shën.im). Ai në krye të bashkëfshatarëve nga Sinja e fshatrat e Cidhnës kishte marrë pjesë në luftën e Drinit të vitit 1844 kundër Hajredin Pashës. Lidhur këtë Munir Shehu shkruan: "...Të gjithë burrat dhe djemtë që ishin në gjëndje të mbanin armë, vrapuan në luftë,duke nxjerrë nga mezi i tyre udhëheqës të tjerë si...Xhaferr kaloshi (i vjetri shën.im) etje, emëra të pa dëgjuar deri në atë kohë dhe me sulm të befasishëm qysh ditën e parë çliruan gjithë Dibrën e Poshtme duke i strukur taboret turke vetëm në Dibër të Epër".

Po mbushen 100 vjet nga ato ngjarje të mëdha. Tabloja e tyre kërkon të jetë më e plotë. Ajo plotësohet kur të gjithë aktorët e atyre ditëve sa dramatike aq heroike për fatin e vendit, gjejnë vëndin e duhur. Edhe pse vonë, pas 100 vitesh, Xhaferr Kaloshi nuk ishte harruar, paksa me të sistemi diktatorial u soll më keq se serbi. Në luftë me serbët humbi këmbën, diktatura e ekzekutoi me vdekje. Gjithmonë ka vend që historia ta korregjoi vehten. Për këtë kurrë nuk është vonë.

Rruga e Arbërit

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të kini parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.

- Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 1500 fjalë (10000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.
- Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçiture dhe më emrin e fotografit.
- Materialet me karakter aktual dhe problematikën e ditës kanë përparësi botimi.
- Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.
- Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail <**rrugaearberit@gmail.com**>, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.
- Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.

Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <**rrugaearberit@gmail.com**>

Redaksia.



Të rënët nuk harrohen

Nga **DALI NOKA**

Bëhet fjalë për atë pjesë të shoqërisë shqiptare të viteve që sistemi komunist i vrau, i burgosi e i sugjeroi vetëm pse vinin nga geni i patriotizmit, atdhedashurisë e familjes.

I tillë ishte dhe i riu 30 vjeçar Murat Dida nga fshati Vakuf i Rrethit të Dibrës. I vetmi djalë i familjes, gen i cili kishte dhënë edhe dëshmor për mbrojtjen e vatanit. Ishin djemtë e kësaj familje, e cila kishte marrë pjesë në të gjitha betejat kundër pushtuesve.

Në luftën me serbët, ra heroikisht me grykën e Radikës trimi Ramadan Dida në luftën 1920 kundër serbëve. Familja e Murat Didës në vitet 1943-1944 u bë strehë e partizanëve. Për aftësitë e tij si djalë i formuar me një prejardhje të shkëlqyer patriotike e njerëzore u zgjodh në Këshillin Nacionalçlirimtar të fshatit Vakuf, që merrej me furnizimin me ushqime dhe strehimin e partizanëve.

Erdhi pranvera e vitit 1945. Lulet e hijeshuan sfondin e tokës plot gjelbërim. Por për familjen Dida në Vakuf do të binte zia. Shtatë motrat e Murat Didës do visheshin me të zeza në atë çast kur do të merrnin vesh lajmin e kobshëm për vrasjen makabre të vëllait të vetëm. Do shuhej një familje e njohur në Dibër, do ngelej nusja e ve. Murati do linte pas vetëm vajzën e vogël 1-vjeçare Hirien, e cila bashkë me shtatë motrat e Muratit, gjithë jetën do e kalonte në zi. E trishtueshme! Aty ku motrat përqafoheshin me dashurinë e motrave për vëllain e vetëm, do të gjenin vëllain të larë në gjak, e dhoma si të buronte gjaku nga toka. Por ai gjak ishte gjak shqiptari e rridhte në dej shqiptari!

Motrat si qyqet në mal thirrnin ore vëlla! Kush të vrau ty. Thirrjet e motrave për vëllain nuk mbaruan deri në vdekje.

Një pjesë e motrave të Murat Didës nga lotët që rridhnin si uji i burimit humbën dhe dritën e syve, për dritën e syrit të tyre. Kulla trekatëshe do të shuhej bashkë me shpresën. Kjo kullë u rrënua nga dora e njeriut.

Sot as rrënohet nuk duken, makabër! Pa mëdyshje sistemi socialist ishte si qeni që kafshonte të zotin, vajzën, motrat dhe far e fisin, nipërit e mbesat do i shoqëronte një hije e zezë për 45 vjet. Po kush do të ishte dora gjakatare e asaj që me plot entuziazëm, me bukën në gojë, të kësaj familje dhe e pamëshirshme i tërhoqi këmbëzën automatikut e plot 32 plumba do binin mbi trupin e Murat Didës. Trimi mbeti në këmbë, dora e komisares do druhej për ta shtrirë për tokë. Murat Dida u ekzekutua pa gjyq, në një lëndinë aty në mes të fshatit. Për këtë veprim makabër kishin mbledhur gjithë fshatin, për të parë këtë krim të paparë ndonjëherë.

I moshuari Selman Dida i tronditur nga ky vendim, kërkoj leje, u ngrit në këmbë, por këmbët nuk e mbanin e tha: Ju lutemi bre bij ta falni Muratin se asht nji pijede (Një djalë në familje). Por përgjigja ishte e prerë:

Uluni apo të vini dhe ju këtu. Plaku i urtë me dhimbje të madhe, me një zë të fuqishëm i tha se unë po vij në vend të Muratit vetëm atë mos e pushkatoni. Komisarja i tha prerë se Murat Dida do të marrë dënimin kapital, është vendim i prerë. Selman Dida mbetet simbol i humanizmit dhe i traditës së lashtë që ka karakterizuar dibranët në të gjitha kohërat.

Po kush ishte kjo vajzë 18-20 vjeçare që ishte strehuar për disa ditë në familjen Dida. Ishte nga jugu i vendit, Komisarja e batalionit "Hakmarrja", emërtim ky i pakuptueshëm. Mbasi lufta kishte mbaruar u mësua se kjo ishte Vera Pojani nga Fieri. Thonë se është e ëma e politikanit Spartak Ngjela.



Në foto: Murat Dida

Siç tregonin njerëz e asaj kohe se, mbasi kryen aktin makabër, më në krye komisaren, ushtarët u larguan mes fshatit me këngë në gojë. Pak fjalë mbetën në kujtesë: Luje, Luje këmbën, se Dibrës ja bëmë gjëmën. Kishte nga ata partizanë me shpirt njeriu që në fshehtë nga komisarja mbanin në dorë shaminë duke fshirë lotët për njeriun që e njihnin mirë. Ata me lotët e tyre shprehnin pafajësinë e Murad Didës, kujtonin pritjen e humanizmin e kësaj familje, kujtonin figurën e këtij djali të rrallë.

Gjithë fshati derdhi lot për Murat Didën e veçanërisht bashkëmoshatarët e tij. Njëri nga këta Hysen Begu, një burrë i mençur e me temperament të rrallë do të shprehej se sot është ndarë nga ne një nga figurat më pozitive të fshatit e të krahinës, na vjen shumë keq që u nda nga jeta në këtë moshë të re, ai i duhej këtij fshati e gjithë krahinës së Muhurrit.

Na vjen keq se Murati ishte i pafajshëm, e kam njohur mirë se bashkë punonim gjithë jetën e veçanërisht kohët e fundit, bile i thashë largohu, por ai tha se nuk ndjej ndonjë faj.

Ishte një pranverë e zezë ajo e vitit 1945 jo vetëm për familjen Dida, por për fshatin Vakuf e shumë familje në fshatra të tjerë. Brenda asaj ditë të zezë u ekzekutuan djemtë më të mirë nga familje të njohura si: Hamit Kukeli në Fushë-Alie, Hazis Pira në Kishavec, Xhemal Kaloshin ë Kandër etj. Pra ishte një reprezalje që sipas tyre do të tmerronte të tjerët dhe ndoshta realizonte planin e tyre.

Sistemi komunist e nisi që gjatë luftës e deri në vitin 1990 në vendin tonë të dashur dhe erdhi pranvera e vërtetë. Sistemi komunist eliminoi të gjithë elitën e këtij vendi të vuajtur nga të huajt e për 45 vjet nga tanët. Shqiptar që vrau shqiptarët, atë elitë që e nisi luftën me një ide: për Shtet Demokratik ku të mëshiroheshin të drejtat e liritë themelore të njeriut. Pas lufte kjo elitë u eliminua herë pas here deri në vitin 1990.

I them Murat Didës e të gjithë atyre që patën fatin e tij: Ngrihuni o trima e shihni atë që patët ëndërruar, se tani u Murat, nuk i thotë kush armike vajzës tuaj, nipave e mbesave, të afërmve tuaj.

Jetuam të trishtuar për 45 vjet nga lufta e ashpër e klasve që e ka patur për zemër kaq shumë diktatura komuniste. Le të shërbejnë këto pas rreshta që sa do pak të lehtësojë dhimbjen e atyre që jetojnë; veçanërisht Hiries.

Ju cilësuan armiq
Ju cilësuan tradhtarë
Por në gjakun tuaj
Vlonte gjak shqiptar

Prehuni të qetë o trima, se keni rënë për të mos u harruar kurrë.

NGUSHËLLIM

Redaksia i shpreh ngushëllimet
Vera Laçit dhe Bilbil Dukës, për humbjen tragjike
të djalit të tyre, Deni Duka!
U prehtë në Paqe!

U bë dhendër në istikam

Nga **Destan RAMA**

Ahmet Loka u lind ne fshatin Sopot të Grykës së Madhe, Komuna Zerqan, rreth vitit 1824. Babai i tij Limani falë krahëve të tij te fuqishëm punonte çdo ditë për të rritur femijët. Me atë pak tokë e bagëti që kishte mezi siguronte bukën për familjen.

Ahmeti, me fantazinë fëmijërore që kishte, ëndërronte që të bëhej dikushi në të ardhmen, ndonëse nuk shihte gjëkundi dritë jeshile.

Gëzohej pa masë kur luante lojëra popullore tradicionale me bashkëmoshatarët, si: kala dibrançe, shkop e cingla, pulamshefas, etj. Këto i shihte si e vetmja mundësi argëtimi në fshat. Dallohej për shkathtësi, guxim, e mençuri .

Kishte dëgjuar për shkollën që bëhej në vendet e tjera përreth nesh. Edhe ai kishte dëshire të shkollohej, të mësonte gjuhën, gjeografinë, historinë e vendit dhe të fshatit të tij. Por kjo qe e pamundur. Ahmeti vinte me trup i bështëm , me një pamje simpatike e serioze. Flokët e zinj i vareshin ballit si ujëvaret e malit.

Me mendjen dhe karakterin e tij u brumos dashuria per Sopotin, për atë fshat që vinte me relievin e tij sope - sope, që po ta shihje nga lart ngjante me valët e detit. Këto valë përplaseshin butë-butë me fundin e malit Shkozë, që i rrinte fshatit si kurorë mbi krye. Me këto tipare të karakterit u rrit dhe u edukua djali i ri.

Vitet ikën, ashtu siç te ikën rëra nën këmbë, në vaun e Drinit të Zi. Djali u bë 20 vjeç.

Atë natë tetori 1844 në shtëpinë e Liman Lokës bëhej dasmë. Martohej djali i parë i tij, Ahmet Loka. Ishin therë shumë berra dhe hallva matej me malet. Gëzimi dhe hareja kishin pllakosur zemrat dhe gjithe vuxhutin e dasmorëve. Dum- dumet e lodrave jehonin në të katër anët e Grykës së Madhe dhe vinin e përplaseshin me malin e Shkozës.

-Mirë se erdhët të dashur miq e dashamirë!

Gëzofshi edhe Ju në shtëpitë tuaja, - u dëgjua zëri i ëmbël e melodioz i të zotit të shtëpisë, Liman Loka.

Të trashëgohet djali, - u dëgjua si në kor zëri mallëngjyes i dasmorëve.

Dasma mori flakë... Kulmi.

Po përnjeherësh dëgjohet sinjali i alarmit. Ai u shpërnda si rrufeja dhe hyri në çdo shtëpi grykamadhëse. Armiku në brigjet e lumit Drin, në prag të derës.

Vetëm të pamundurit të qëndrojnë këtu. Ushqimet e dasmës me kazanë të transportohen në istikam, -jehoj zëri burrëror i Liman Lokës. Bashkë me luftëtarët doli edhe dhëndëri. Ai me mall iu drejtua nuses dhe i tha:

Lamtumirë, moj nusja ime,
Fli e qetë në meditime.
Dhomë e ngrohtë me ledhatime,
Më fton të mbroj me jetë tokën time.
Istikami dheu i ngrohtë,
Për mua më i bukuri në botë.
Sonte gëzim te madh unë kam,
Bëhem dhëndër në istikam.
Aty luftoi, aty mbeti, bashkë me Canë,
Hallall buka e gjiri që t'kam dhanë,
Tha ne mes lotëve e mjera nanë,
U bëtë fli për atdhe, për vatanë.

Thirrje për sponsorizim

Shtëpia Botuese "M&B" ka në proces botimi disa libra me vlera të mëdha historike, kulturore dhe kombëtare, për Dibrën dhe më gjerë. Individë ose biznesmenë që dëshirojnë të bëhen bashkëkontribues në këto projekte, mund të shprehin interesin e tyre në emaili:

mbbotime@gmail.com

Faleminderit!

botime të reja



Kristo Frashëri
"HISTORIA E DIBRËS"
Histori
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-82-0
Çmimi: 1500 lekë



Xhafer Martini
"GJENERALI ME SHAJAK"
Monografi
Botimet "Dita 2000"
ISBN: 978-99956-92-78-0
Çmimi: 1000 lekë



Agron Tufa
FRAGMENTET E GJESE
Poezi
Shtëpia Botuese OM - Prishtinë
ISBN: 978-9951-632-02-7
Çmimi: 5.5 Euro



Shaban Sinani
NDAJFOLJET PËREMRORE NË GJUHËN SHQIPE
Punim historik krahasues
Botimet Naimi
ISBN: 978-9928-109-44-6
Çmimi: 800 lekë



Bashkim Rama
BALLKANI PAS RËNIES SË MURIT TË BERLINIT – VETËVENDOSJA "VERSUS" TËRËSIA TERRITORIALE
Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-03-7
Çmimi: 1250 lekë



Arbër Sh.Cami
KALATË SHQIPTARE
Album me foto
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-97-4
Çmimi: 500 lekë



Elliot Moglica
BURRI I MADH HASAN MOGLICA
Biografi

ISBN: 978-0-9868069-2-6
Çmimi: 12 E, 18 CAD, 20 USD



Naim Berisha
E DREJTA, E PADREJTA DHE KADIU
Fabula
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-85-1
Çmimi: 300 lekë



Naim Berisha
PENGU I NËNDHESHËM
Poezi
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-84-4
Çmimi: 400 lekë

Këto libra mund t'i gjeni pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.

Librin HISTORIA E DIBRËS të Kristo Frashërit mund ta gjeni:

Në PESHKOPI: **Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.** Në DIBËR TË MADHE: **Rexhep Torte. e-mail <diars@t-home.mk>**

Në DURRËS: **Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353**

Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603 / 068 65 08 441 / 067 30 73 265 *E-mail*: <mbbotime@gmail.com>

cyan magenta yellow black